


# MID'HAT FRASHËRI

BIBLIOTEKA

949.65

F 84

Çështje e Epirit



TRITËK ESSESH


---

MID'HAT FRASHËRI  
(Lumo Skëndo)

ÇËSHJA

Ë

ËPIRIT



Triptik essesh

**Të drejtat e botimit janë  
ekskluzivisht të shoqatës  
"Lumo Skëndo"**

Tiranë 1998

---

---

"La Population de l'Epire",  
(Popullsia e Epirit), 1915, Sofje.  
"L'affaire de l'Epire"  
(Çështja e Epirit), 1919, Gjenevë.  
"Les albanais chez Eux e a l'etranger"  
(Shqiptarët në vendlindje dhe  
në mërgim), 1919, Lozanë.

**Përktheu nga origjinali:**  
**ALEKO GJERGO**

**Redaktor, recezent:**

*MANJOLA TËRSHANA*  
*SYRJA XHELO*  
*ÇERÇIZ LOLOÇI*

**BOTIMI I LIBRIT U MUNDËSUA NGA**  
**SHOQATA ATDHETARE " LUMO SKËNDO"**

---

---

EUGEN SHEHU

# Shërbestari i kombit

*Me një ndjenjë të thellë keqardhjeje, kushdo prej nesh sot, ndjek dramën e mynyrshme të largimit prej trojeve etnikë, të dashur stërgjyshore, të mijra e mijra shqiptarëve. Nëse në veri e verilindje kjo hemoragji e dhimbshme njerëzore shkaktohet si rrjedhojë e dhunës së instituciona-lizuar të fqinjëve, në brendësi të Shqipërisë, në hapësirat plot diell e det të lakmuara për çdo evropian, vëllezërit e mi të gjuhës e gjakut i largohen të tmerruar varfërisë, krimit të organizuar, dilemës tronditëse ndaj të nesërmes.*

*Për më tej, kur shih se ky këb gjithëkombëtar i ngjan atij*



---

tuneli pa dritë (fondi i të cilit mund të jetë qindra kilometra drite larg), dhimbja bëhet më e theksime dhe gjithkush dyzohet midis realitetit dhe fatit historik. Trillet e këtij fundshekulli, të duket se plazmohen nën një shtysë thujse kozmike, drejt një enigme etnike në agun e mijëvjeçarit të tretë që po troket.

Sidoqoftë unë mendoj se aktualisht ne shqiptarët po i largohemi vetvetes nëpërmjet dy rrugëve që nuk dihen as ku ndahen dhe as ku takohen me njera tjetrën.

E para, është ajo që përmëndëm më lart.

E dyta, ndofta më pak e pranuar, është largimi i shqiptarëve prej historisë së tyre. Në ndenjën e masakruar nacionaliste të bashkëkombasve të mi, ngjan se përherë e më shumë po afrohet ideja se në një Evropë të bashkuar e moderne, etnitë mund të shërbejnë vetëm si sfond dhe asgjë më tepër.

Largimi prej historisë, përpos të tjerave, është largim prej vlerave shumë dimensionale, të shtresuara në shekuj, cilat do qofshin ato. Historia është memoria pa të cilën një komb vështirë të jetojë gjatë. Për më tepër, kur bëhet fjalë për ne shqiptarët, për pozicionin tonë gjeografik, për atë çka shekujt e shikuar na "dhanë leksione", moslargimi prej historisë merr vlerat e një parakushti për mbijetesë.

Parë në këtë kënd, të tri esse-të historike që po i jepen sot lexuesit shqiptar, shkruar 80 vjet më parë prej të madhit Mid'hat Frashëri mendoj se janë mesazhi më i plotë që bashkëkombasit e mijë vjetëve të mos i largohen të kalurës së tyre si terri dritës por edhe ta respektojnë e krenohen me të.

"Popullsia e Epirit", "Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim" si edhe "Çështja e Epirit", të botuara së bashku, i ngjajnë

një mozaiku jo vetëm të bukur e të shkëlqyer në pamje të parë. Ashtu si në afresket e lashtë të mjeshtërve tanë, po të depërtosh në domethënien dhe vlerat e tyre, këto esse historike, duke na mahnitur me të vërtetat ngjethëse, të trondisin. Njëherazi ato përpigën të zbulojnë të fshehtat e mekanizmit gllabëronjës së fqinjit jugor.

Një shtysë miklonjëse, për të shkëputur pluhurin gjumndjellës të kohës, për të rinxjerrë në pah ngjarjet përmes vlerave të këtyre perlave të historiografisë shqiptare, të fusin në "grackën" e meditimeve të thella. Por siguria prej shkencëtari e Mid'hat Frashërit, të befason. Ajo kurdoherë të merr për dore, vetja të ngjan si një vizitor i lumtur në një qytet antik ku si ciceron të shërben zëri i butë i birit të Frashërlinjve.

"Popullsia e Epirit", (*La Population de l'Empire*) është botuar në Sofjen e vitit të largët 1915 nën kujdesin e drejtpërdrejtë të atdhetarëve tanë që drejtonin librarinë "Pavarësia e Shqipërisë". Shqipëria ka mundur të shpallë pavarësinë në vjeshtën e vitit 1912, ka bërë përpjekje për krijimin e një shteti të lirë, është copëtuar etnikisht prej Londrës së vitit 1913 dhe gjëndet tanimë në shtjellat më kërcënuese të rrjedhave të luftës ballkanike.

Tepër i ndërgjegjshëm për atë çka duhej t'i tregonte Evropës, i pajisur me një intuitë perfekte mbi shkallën e njohjes që kjo fuqi indiferente kishte për Ballkanin, Mid'hati ynë, që në faqet e para të kësaj esse-je ngre zërin duke thënë:

"...Lexuesi nuk duhet të harrojë se ndodhet në pjesën lindore të Evropës ku gjithshka ka qënë kaq e ngatërruar, kaq e fllusifikuar, kaq e gjymtuar dhe e mbushur me mashtrim..."<sup>1</sup>)

...Për hir të së vërtetës, duhet thënë se kolonitë greke janë formuar në shekujt VII-VIII (para Krishtit) tek ngulimet "barbare".

## Shërbestari i kombit

Madje vetë Straboni ka pranuar se kur kolonistët grekë u vendosën në Korkyrë, qenë detyruar të ndeshen në qëndresën burrërore të ilirëve të cilët ishin zotruesit e ishullit. Zgjerimi i zotërimeve të kolonistëve grekë nuk do të mund të kalonte në heshtje, ndaj njihen disa beteja midis fqinjëve ballkanikë që nuk i lidhte mes tyre as gjaku, as gjuhja, as historia përveçse një rastësi e mynyrshme gjeografike.

Gjithsesi koha helenistike do të sillte një klimë të re në marrëdhëniet e "Barbarëve" me grekët. Qytetet e mëdhenj, ilirë, thrakë dhe epirotë hapën portat e tyre jo vetëm për kulturën helene por edhe ndaj qytetërimit e civilizimit grek. Erërat e reja politike dhe ekonomike dukej se nuk përfillnin shumë kufijtë etnikë.

Ndërkohë në qytetet greke ndihej ritmi i jetës së "barbarëve". "Në të dyja rastet, ky element na del i pranishëm nëpërmjet burimeve epigrafike dhe numismatike në përbërjen e popullsisë së këtyre qyteteve, sigurisht në një masë modeste dhe asnjëherë mbizotëruese. Le të kujtojmë këtu epitafet e nekropoleve të Dyrrahut dhe Apollonisë dhe monedhat e këtyre qyteteve ku ilirët na dëshimohen si banorë të tyre, madje si të tillë, që ndonjëherë mbajnë edhe postet e prytanit (kryetarit të qytetit) ose të magistratit që kujdeset për financën dhe prerjen e monedhave.

E njëjta gjë vërtetohet edhe në ato qytete të botës "barbare" ku mbishkrimet na sjellin emra qytetarësh grekë... 2).

Nata osmane do të ishte tepër e gjatë për ne shqiptarët. Ajo do të lidhte errësirë pandërprerë në maqthiin tonë etnik duke iu trembur përpos trimërisë edhe mënçurisë së pasardhësve të ilirëve.

Sipas ligjeve të Kuranit, në krejt domenet e saj, Turqia njihet vetëm mysli-manët. Të tjerët (pra jo myslymanët) etiketoheshin si të pafe ose të quajtur ndryshe (qafin) I nisur prej interesave të ditës,

Sulltan Mehmeti i dytë ngarkoi peshkopin e Kostandinopojës të institucionalizonte (kuptohet sipas dëshirë së tij...) besimin shpirtëror të "qafirëve" duke shkelur brutalisht mbi historinë e lashtë të tyre dhe të trojeve ku ata jetonin. Të krishterët e Epirit, bijtë dhe nipërit e atyre që luftuan kundër asimilimit helenik, u vunë tani përballë dallgëve e stuhive të reja qëndra e të cilave ishte patriarkana greke.

"Qeveria otomane mbështeste të gjitha përpjekjet e Patriarkatit për të regjistruar si grekë të gjithë qafirët. Pifti në kishë, mësuesi dhe kujdestarja në shkollë, bënë ç'ishte e mundur për rrenjosjen e kësaj ndjenje të rreme kombëtare për shkatërrimin dhe paragjykimin e karakterit të vërtetë etnik të popullit" 3).

Konstitucioni moral i kombit do të mbetet pa dyshim një tempull brenda të cilit Lumoja ynë do të depëronte mjeshtërisht. Brënda këtij tempulli ai do të futej edhe si vëzhgues i saktë dhe i thellë, edhe si një zbulues i një personaliteti të vështirë por gjithsesi dinjitoz në krahasim të evropianëve siç janë vlerat shpirtërore të shqiptarëve.

Duke evidentuar faktin se edhe në mes të Athinës shqiptarët mburren me gjakun dhe racën e tyre të pastër, autori u tregon të huajve se kriteri i kombësisë nuk janë (as shkollat, as kishat por pikërisht ai zjarr që digjet së brendshmi për atdheun dhe gjakun e të parëve. Kushtrim i të parëve, edhe pse diku përkohësisht ngrëgon, edhe pse dikur vjen së toku me klithmat e erës, askurrë s'mund të humbasë në vetëdijen nacionale të shqiptarëve.

Jo më kot, në mbyllje të kësaj esse-je, Mid' hat Frashëri boton një sërë kërkesash ultimative të qindra ortodoksve shqiptarë brenda dhe jashtë kufijve etnikë të cilët kërkojnë të mos shkëputen për asnjë çast prej trungut të lashtë ilir. Thirrjet e tyre, të kombinuara me



## Shërbestari i kombit

---

sakrificat sublime të një plejade të shkëlqyer rilindësish, i dhanë sidoqoftë një vizion më të plotë shpresave të afërme dhe të largme të popullsisë epirote.

“L'affaire de l'Épire”, (Çështja e Epirit) do të shihete dritën e botimit në Gjenevë, në vitin 1919. Grekët që jetonin prej kohësh në këtë qytet, kishin arritur të ndërtonin prej kohësh një makinë propagandistike buçitëse pikërisht ndaj atij kombi që përpiqej për të kërkuar të drejtat e tyre legjitime.

Përballë këtij institucioni mashtrimesh, Mid'hati ynë, ky shërbestar i kombit, nuk do të tutej aspak. Intuitivisht ai e kishi kuptuar se Evropa e ftohtë parapëlqente faktet dhe dokumentat, më tepër se patetizmin paranojak.

“Epiri” është përdorur si term që në kohët e lashta. Me këtë emër janë nënkuptuar kurdoherë viset e trevat prej Maleve të Vetëtimës në Himarë e deri në gjirin e Ambrakisë në Jug. Vetë gjeografi grek Athanasio Psalidhi shkruan në fillim të shekullit XIX se

“...Shqipëria (Iliria e atëhershme dhe Epiri) kufizohet nga ana lindore me Maqedoninë e Poshtme dhe Thesalinë, nga ana veriore me Bosjen dhe Serbinë. Nga ana perëndimore me detin Jon dhe në brendësi me gjirin e Ambrakisë” 4).

Luftërat e zhvilluara në Epir, deri në shekullin e 14-të, nuk mundën të ndryshojnë kushedi se çfarë në përbërjen etnike të tij. Kalimi i pushteteve sa në një dorë në tjetrën, i ngjante një teatri të madh ku mbretërit duartrokiteshin apo vriteshin ndërsa aktorët e thjeshtë mbeteshin po ata. Inkursionet turke në fundshekullin e 14-të, të ngjajnë se kanë zgjuar një interes të madh për Epirin duke ndriçuar kësisoj edhe errësirën e mbjellë në shekujt paraardhës.

## Eugen Shehu

---

A. Lutrell e përmend në këtë kohë Epirin si "Despotat i Shqiptarëve" 5). Më pas do të ishin Lazzarini, Cluverius, Vissova, Martono, Hertzberg, Belon dy Mans, Laurenberg e dhjetra të tjerë që e klasifikojnë Epirin si Shqipëri dhe banorët e saj pasardhës të ilirëve që ndryshojnë prej grekëve nga gjuha dhe gjaku. Inkursionet shkatërruese otomane në shekujt që pasuan, së bashku me përpjekjet për helenizim të kishës e shkollës greke, nuk do të mund të sillnin ndryshime të ndjeshme në pikëpamje të etnicitetit të këtyre trevave të pastra shqiptare.

Vonë, në fillimin e këtij shekulli, mesa duket nisi të luhej drama më e madhe në skenat natyrale të Epirit të lashtë. Përballë një nacionalizmi të ethshëm grek, shqiptarët (dhe sidomos populli i Çamërisë) u ndodhën të pafuqishëm për të vepruar qoftë ushtarakisht, qoftë në rrugë diplomatike. Dhunimi i kufijve natyrore të vitit 1913 hapi plagë të tilla ku edhe sot ndihet rënkimi i gjakut tonë të shprishur.

Traktati i Lozanës i vitit 1919 lidhur me nacionalitetet, u dhia shikas grekëve për një spastrim të thellë etnik në Çamëri.

... "Mashtrimi i grekëve kishte për qëllim që t'i paraqiste si turq shumë mysli-manë shqiptarë dhe t'i dërgonte me anije në thellësitë e Azisë së vogël duke i bërë objekt shkëmbimi. Kjo është njësoj sikur të syrgjynosësh irlandezët në Poloni, duke u nisur nga fakti se edhe irlandezët, edhe polakët janë katolikë e prandaj qenkan të një kombësie" 6).

Ndërkohë në Çështjen e Epirit, Mid' hat Frashëri nuk nguron aspak të sjellë ngjarje e fakte reale të kësaj (dihune satanikë) ardhur prej fqinjit tonë jugor. Raporti ngjethës i gjeneralit Devër adresuar

## Shërbestari i kombit

Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, do të rrinte kësisoj krejt denjësisht në krah të tragjediëve klasike greke.

Në kryqëzatat e tyre drejt masakrës psikologjike, fizike dhe propagandistike, grekët u përpoqën të paraqisnin luftën dhe përpjekjet heroike të shqiptarëve të krishterë për mbrojtjen e kufijve të tyre si vepër të frymëzuar prej italianëve apo bullgarëve.

Mid'hati ynë i ndjeshëm, përballë kësaj gjëndjeje ankthi ku ndodhej jugu i Shqipërisë, nuk nguronte të shpallte publikisht se:

"...Kështu luhej komedia: Grekët luanin rolin e tyre dhe Evropa bënte sikur nuk kuptonte ose, më keq akoma, lëshonte klithma admirimi për poshtërsitë greke" 7).

"Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim" (Les albanais chez Eux e a l'etranger), botuar në Gjenevë më 1919, e publikuar në shqip së bashku me dy esse-të e mësipërme, mendoj se përbën një lidhje organike të mendimit të Mid'hat Frashërit për çështjen epirote. Të trija së bashku plotësojnë mjeshhtërisht njera tjetrën duke u përpjekur të hedhin dritë mbi xhunglën e teorive spekulative të historisë dhe të racës shqiptare.

I thelluar në psikologjinë dhe mentalitetin e popullit të vet, Lumua ynë, do të vizatojë me një ekspresivitet kategorik, veset dhe virtytet e shqiptarëve në tokën e tyre dhe jashtë saj. Por jo vetëm vizaton. Ai i shërben kombit të vet sidomos kur mban qëndrim ndaj moralit të popullit. Nderimi ndaj këtij morali, nderimi ndaj racës e zakoneve të bukura shqiptare, do të jetë i pranishëm në çdo radhë të shkruar nga dora e tij.

Është e natyrshme se ndjenja ngulmuese e Mid'hat Frashërit për të zbuluar sa më thellë universin e shpirtit të bashkëkombasve, rrjedh nga dëshira e tij për të ndikuar, për t'u treguar të tjerëve, të huajve, se ne genet shqiptarë, përpos trimëria, gjallojnë edhe tipare të

## Eugen Shehu

---

tjera të një shpirti të madh e të bukur. Duke i kujtuar Evropës së ringjallja e Greqisë i detyrohet shumë kapëdanëve shqiptarë, ai krejt hapur ftonte kanceleritë moderne të vinin në vend nderin e kombit tonë.

Shqiptarëve, në vendlindje dhe në mërgim, Lumua u bëri një vlerësim tepër real, gati transparent. Ai i mbylli radhiët e kësaj esse-je kaq të thullë në mendime dukë thirrur me zë të lartë që për shqiptarët duhet të lindë epoka e luftës për ardhmërinë e tyre e jo të kombeve të tjerë. Në këtë thirrje do të gjente një dimension tjetër, emancipimi ynë kombëtar.

Padyshim, ajo çka të bën përshlypje menjëherë në trajtimin e Epirit, është aftësia e Mid'hat Frashërit në hulumtimin e fakteve dhe burimeve të tyre. Më tepër se kureshtje intelektuale, më jepet të mendoj se ky është synimi i një atdhetari të mençur. Në rrethi shtatëdhjetë faqe për Epirin, Mid'hati sjell po shtatëdhjetë informacione nga historianë e gjeografë, të njohur, burime të pamohuara prej vetë grekëve.

Si një ndër krijuesit e esseistikës historike, ky do të mpleks natyrshëm çastet kulmore të jetës së popullit të vet me fatet e Ballkanit dhe indiferencën evropiane. Në këtë mpleksje, mendimi i tij i pjekur, do të arrinte kurdoherë të gjente udhët e shpresës.

Në gjurmimet ngulmuese për Epirin, Lumua ynë, ky shërbëtar i kombit deri në fund të jetës së tij, përdori për herë të parë regjistrat kadastrale turk. Këta kanë qënë tepër të saktë, pasi një perandori shumëkombëshe, që mbahej në këmbë nëpërmjet luftërave shtypëse, ishte mjaft e përpiktë në regjistrimin e



## Shërbestari i kombit

popullsisë si për vjeljen e taksave ashtu edhe për marrjen e ushtarëve. Publikimi i të dhënave për krahina të tëra të Epirit nga ana e Mid'hatit, përpos të tjerave nxorri në pah falsifikimin demografik zyrtar grek.

Ky fakt nuk mund të jetë kaq i thjeshtë sa duket. Po të kemi parasysh se në ato vite shumë shtete të Evropës i kishin pranuar si të qënësishme statistikat demografike greke, do të mund të imagjinosh se çfarë përmbysjeje sollën publikimet e Mid'hatit për Epirin. Madje këto publikime u pranuan si të vërteta edhe përtej kontinentit. Në "Dokumenta të Uashingtonit për Shqipërinë" ka përshkrime identike me ato të Lumo Skëndos në botimet e Gjenevës.

Botimi i çështjes së Epirit, në Gjenevë dhe pikërisht në frëngjisht është tepër domethënës. Gjuha frënge, duke qënë më e folura në Evropë, tregoi përpara kombeve të qytetëruar "martirizimin" e një populli që rronte prej shekujsh në trojet e veta. Frëngjishtja e pasur në kolorit dhe elegante e Mid'hatit, bëri që personalitete shkencorë të rretheve përparimtare "t'i afroheshin" Epirit duke rënë në mendime rreth klithmës së tij për egzistencë. Mjaft miq të Lumos, profesorë e akademikë të shquar, u bënë propagandues të zellshëm të çështjes së Epirit në konferenca të ndryshme shkencore.

Sa më shumë njihej Shqipëria në ato vite aq më tepër lartohet personaliteti i Mid'hatit. Sa për aktualitetin e kësaj vepre, mendoj se sot çdo shqiptar i ndershëm vlen të krenohet. Të tjerë, kushdo qofshin, që flasin për nacionalizëm folklorik le

## Eugen Shehu

---

*të skuqen.*

*Tek e mbramja, do të desha të falenderoja botuesit e këtij libri për dy arsye.*

*E para: pse po ecin në udhë të mbarë, në udhën e botimit të korpusit të plotë të veprave të Mid'hatit, këtij historiani, diplomati, hartografi, mendimtari dhe nacionalisti të anatemuar prej 55 vjetësh.*

*Së dyti, ky libër i botuar sot është një thirrje për Kosovën. Skenaret për helenizimin e Epirit, vetëm se bashkohën e nuk kanë një pikë ku të ndahen me ato serbe. Dhuna dhe terrori shtetëror i ushtruar prej makinës serbe të luftës ndaj një populli paqedashës, liria e Kosovës e nxjerrë në ankand metropoleve të Evropës, soditja e ftohtë dhe pafuqishmëria për ndihmë e shtetit amë, janë kaq të afërta me realitetin tragjik të Epirit në fundshekullin që jetojmë. Një paralele e hequr në histori, natyrisht zgjon mendime të thella në vetëdijen tonë nacionale.*

*Por a do të vazhdojmë të soditim ne shqiptarët mënxyra të tilla ? Le t'i drejtohem rilindësve! Të mos harrojmë Lumon tonë.*

*Shqipëria ka sot nevojë më shumë se kurrë për shërbetarë.*

**Bernë, maj 1998.**

**SHËNIME**

- 1). **"Popullsia e Epirit"**, Mid'hat Frashëri, esse, 1915, Sofje.
- 2). **"Epiri etnik"**, Selim Islami në "Studime Historike", nr.1-4, Viti 1992, f. 8.
- 3). **"Popullsia e Epirit"**, Mid'hat Frashëri, esse, 1915, Sofje.
- 4). **"Përshkrim gjeografik i Epirit"**, Athanasio Psalidhis f. 49-50.
- 5). **"Vonitza in Epirus and its Lords"**, A.Lutrell, 1306, f.137.
- 6). **"Shqipëria-kopështi shkëmbor i Evropës"**, F.Konica, Vepra, f.524, Botimi Tiranë 1993.
- 7). **"Çështja e Epirit"**, Mid'hat Frashëri, 1919, Gjenevë.

---

---

**POPULLSIA  
E  
EPIRIT**

**SOFIE**

**SHTYPSHKRONJA  
E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË  
1915**



---

**D**o të na dukej krejt e kotë dhe pa vlerë që të flisnim për kombësinë e Epirit. Mendojmë se të shkruash një artikull të tillë, është sikur të provosh vërtetësinë e dritës së diellit apo të nxehtësisë së zjarrit. Por paturpësia e grekëve nuk paska kufij dhe padituria e publikut qenka kaq e madhe, sa që ajo që po thuhet dhe po përsëritet çdo ditë rrezikon të besohet dhe të merret si e vërtetë. Në fakt, rallë mund të gjesh, një në një mijë njerëz, që të kenë dëshirë të studiojnë dhe të thellohen në një çështje; shumica mjaftohen me ato çka i rrëfejnë të tjerët dhe i gëlltisnin idetë pa i përtypur.

Duke përshkruar egërsitë e grekëve në Epir, kemi thënë se në të gjitha provincat e Korçës dhe të Gjirokastrës nuk ka grekë, përveç banorëve të nja pesë a gjashtë fshatrave në Jug të Delvinës, në kufirin e përcaktuar nga Komisioni Ndërko-mbëtar i kufijve jugorë të Shqipërisë. Ne kemi deklaruar se nuk ka patur asnjë grek në provincën e Korçës dhe këmbëngulim në këtë fjalë: ASNJË.

Kështu nuk do të përpiqemi aspak të provojmë mendimin tonë me anë të thënive të autorëve dhe udhëtarëve të huaj; ne vetëm do t'u kërkojmë kundërshtarëve tanë grekë që të na japin provat e pretendimeve të tyre.

Lexuesve inteligjentë dhe të sinqertë ne do t'u rekomandonim që të hedhnin një sy shkarazi mbi hartat etnografike të Lejean, Shafarik, Kiepert, të lexojnë cilindo libër udhëtimesh, me kusht që ai të mos jetë vepër e ndonjë njeriu dashakeq; të kalojnë nëpër duar të gjitha shënimet e udhëtarëve që kanë vizituar trevat e Korçës dhe të Gjirokastrës dhe do të shohin vetë se çfarë mendon popullsia

## MID'HAT FRASHËRI

e tyre. Për më tepër, vetë grekët e kanë pranuar gjithmonë karakterin shqiptar të banorëve të Korçës dhe të Gjirokastrës. Vetëm gjatë luftës Ballkanike, ata kanë shfaqur një ringjallje të shovinizmit dhe të fanatizmit të verbër.

Ne themi se rajonet e Korçës dhe të Gjirokastrës janë shqiptare. Me këtë nënkuptojmë se banorët e tyre flasin gjuhën shqipe, ndjehen tërësisht shqiptarë dhe kanë në damarët e tyre gjak të racës shqiptare. Në këtë mënyrë e kuptojmë ne konceptin shkencor të etnografisë së një populli.

Tani kur grekët pretendojnë se këto rajone janë të banuara prej bashkëkombasve të tyre, atyre iu pëlqen të nisen nga disa iluzione dhe koncepte të gabuara.

Në fillim grekëve iu pëlqen të ngatërrojnë kishën me kombësinë. Është një gabim ndaj të cilit ne kemi tërhequr shpesh vëmendjen e lexuesit tonë, por që grekët nuk e kanë marrë asnjëherë parasysh sepse ai është shumë i dashur për ta.

Pra, kur një grek përdor këtë fjalë, (kombësinë), ai më shpesh nënkupton ritin ortodoks, kishën greke. Fantazia e tij nuk njeh asnjë kufi kur futet në këtë qorrso-kak. Atëhere, ai është i zoti të bëjë montime nga heleno-shqiptar në heleno-turk, duke dashur të tregojë me këtë një shqiptar të krishterë të ritit ortodoks dhe një tjetër të besimit musliman. Vetëm se në vend që të përdori termat "ortodoks" e "musliman" që tregojnë përkatësisht besimet, ai përdor fjalët "helen" e "turk" që tregojnë racat, kombësitë. Dhe kështu, me këtë logjikë së prapthi, një njeri që ndryshon fenë Ipso Facto do të kishte ndërruar njëkohësisht edhe racën.

Por logjika greke nuk ndalet aspak këtu. Ata kanë gjithashtu edhe shprehje të tjera të çuditshme si alvanofonë-helenë, vllahofonë-helenë, bullgarofonë-helenë - duke dashur të nënkuptojnë me këto helenë që flasin shqip, vllahisht dhe bullgarisht.

Është një letërsi tepër zbavitëse ajo e broshurave dhe e librave propagandistike të fabrikuara nga shoqata Helenizimi i Athinës, Kazazis e Cie; aty do të gjesh të gjitha këto marrëzi të grumbulluara në mënyrën më të habitshme.

Nganjëherë, përsa i përket afërsisë me shqiptarët, grekët kanë një shpërthim emocional dhe nisin të tregojnë historime një seriozitet grotesk. Flasin për Pellazgët e vjetër, Ilirët, Dorianët e ku di unë se çfarë dhe arrijnë në konkluzionin se grekët dhe shqiptarët janë dy raca motra, dy popuj vëllezër. Vëllezër, sigurisht sipas gjenezës biblike, pra atëhere jemi vëllezër edhe me Zulu-të dhe Samojedët. Por le t'i kthehemi "argumentave" të fqinjëve tanë jugorë.

Jo rrallëherë në statistikat e botuara nga grekët mund të shohësh shifra të nxjerra nga statistika zyrtare të Turqisë (salname: të vilajeteve). Kjo mënyrë dokumentimi u vjen mjaft mirë për shtat politikanëve të Athinës, sepse në çështjet e kombësive dhe të komuniteteve fetare turqit nuk janë aspak më të saktë se grekët; mentaliteti i tyre dhe mënyrat administrative janë të mbështjella me një çoroditje të pashembullt.

Kujtojmë në fillim se Turqia ka në bazë të administrimit të vet ligjet e nxjerra nga Kanuni. Sipas këtyre principeve, Turqia ka njohur vetëm dy klasa njerëzish:

## MID'HAT FRASHËRI

---

muslimanët dhe jo-muslimanët; këta të fundit të quajtur “qafirë” (të pafe), “raja” dhe “zimmi”. Me këto përcaktime janë poshtëruar të gjitha racat jo-muslimane të tokës, përveç çifutëve të quajtur gjithmonë me emrin që u jep atyre Kurani (Jehudi, xehud).

Kur turqit u zëvendësuan nga perandoria e Bizantit, Mehmeti II që padyshim shumë i lumtur kur gjeti një peshkop në Kostandinopojë që pranoi të marrë përsipër administrimin e klasës së papastër të qafirëve.

Kështu patriarku mori juridiksionin shpirtëror dhe laik të të gjithë të krishterëve të ritit ortodoks, të cilët ishin të regjistruar nga burokracia otomane vetëm me emrin “roum” ( domethënë romakë); ata të perandorisë së Poshtme shënoheshin me termin Diari-i-roum, ndërsa grekët thirreshin Romios, romakë.

Të veshur me këtë fuqi supreme që i bënte me të vërtetë ekumenikë, patriarkët në vend të proselitizmit fetar nisën të bëjnë proselitizmin kombëtar. Ky zell i madh i klerit ortodoks është lehtësisht i kuptueshëm nëse kujtojmë se administrimi i kishave, manastireve dhe shkollave ( më shumë fetare se sa laike) ishte në duart e patriarkatit. Dhe kështu ai që ishte kleri ortodoks u bë një kler krejtësisht grek dhe helen, siç i pëlqente ta quante veten.

Ka patur një moment ku të gjithë të krishterët ortodoksë të Turqisë Evropiane u quajtën grekë. Në fillim ishte më tepër një zell fetar, por nuk vonuan të shfaqen edhe idetë kombëtare e politike, sidomos gjatë këtyre 150 vjetëve të fundit.

Atëhere patriarkati u bë qendra e helenizmit dhe e



## Popullsia e Epirit

politikës helenike. Shkollat u shtuan, propaganda e letrave dhe e gjuhës greke mori një shtrirje të gjerë; sigurisht lindën edhe shkollat për vajza me qëllim që të ndërhyhej akoma më shumë në familje deri te djepi i fëmijës.

Dhe të gjithë shqiptarët, bullgarët, rumunët dhe vllahët u quajtën Rourmë (grekë) si të gjithë qafirët. Prifti në kishë, mësuesi dhe kujdestarja në shkollë bënin ç'ishte e mundur për rrënjosjen e kësaj ndjenje të rreme kombetare, për shkatërrimin dhe paragjykimin e karakterit të vërtetë etnik të popujve dhe kombësive.

Ja pra, cilat janë arsyet që grekët janë të dashuruar me të dhënat zyrtare turke mbi popullsinë e Epirit dhe të Maqedonisë. Në Salname (vjetarët) e vilajeteve të gjithë muslimanët janë të emërtuar ISLAM, ndërsa ortodoksët ROUM, d.m.th grekë që frekuentojnë kishën greke dhe varen nga juridiksioni fetar i Patriarkanës së Fanarit. Vetëm në vitin 1872 idhtarët e kishës bullgare u quajtën zyrtarisht bullgarë nga autoritetet otomane.

Ortodoksët shqiptarë, duke mos patur një kishë autoqefale dhe duke qenë të varur ndaj juridiksionit të Patriarkatit të Fanarit, kanë figuruar gjithmonë si Rourmë në regjistrat turq.

Një tjetër argument i përdorur nga grekët është ai i shkollave. Sidomos në këto vitet e fundit ky argument është përdorur dhe konsideruar prej tyre si një armë tepër e fuqishme në duart e veta.

Grekët nuk kanë munguar kurrë të publikojnë numrin e shkollave, të mësuesve dhe të nxënësve. Në çdo vend tjetër, përveç Turqisë, këto të dhëna do të kishin patur

## MID'HAT FRASHËRI

---

një vlerë mjaft të madhe; ato do të kishin qenë një udhërrëfyes për të përcaktuar karakterin e vërtetë etnik dhe aspiratat e vërteta të një populli. Por ajo që kemi thënë më lart mjafton për të kufizuar këtë argument në vlerën e tij të saktë. Dhe ja përse:

1. Drejtimi i shkollave është në duart e komuniteteve, të cilët janë grupuar rreth kreut fetar: pra shkollat dhe komuniteti përbëjnë një trup të vetëm me kishën dhe qeveria turke i njihte këto institucione vetëm nëpërmjet kreut fetar i cili ishte ngarkuar me administrimin.

2. Komunitetet kishin në dispozicion të tyre fonde të mëdha, donacione e trashëgimi, të gjitha të shënuara në emër të komunitetit si entitet fetar; atëherë kuptohet se sa i madh ishte roli shtypës i këtyre shumave të mëdha që ndodheshin në duart e e klerit dhe të komuniteteve.

3. Kleri ka në duart e tij edhe një forcë tjetër, atë të komunikimit me jashtë dhe të persekutimeve fetare. Këto armë mbështeten nga qeveria, e cila është një konservatore e thellë që sheh me frikë çdo inovacion.

Pra, a kërkonte ju të dërgoni djalin në një shkollë të padëshiruar nga kleri, nga i cili fatkeqësisht ju jeni i varur? Ju menjëherë shpalleni heretik, syrgjynoseni nga gjiri i kishës, prifti ju mohon shërbimet e zakonshme, kaq të shtrenjta për shpirtrat e besimtarëve. Ai refuzon t'i pagëzojë fëmijën e porsalindur të familjes së mallkuar, t'ju vërë kurorë çifteve të reja në martesë, madje ju refuzon edhe një copë tokë në varreza.

Me qindra raste të tilla janë provuar në Shqipëri dhe shpesh herë njerëzit janë detyruar të ndërmarrin një udhëtim

## Popullsia e Epirit

---

të gjatë për të pagëzuar fëmijët ose për të celebruar një martesë.

Këtyre armëve shpirtërore i shtoni edhe disa të tjera më të fuqishme dhe më therëse: terrorizmin e bandave të andartëve për llogari të klerit grek e të komuniteteve fetare dhe ju do të kuptoni më mirë nëse egzistenca dhe numri i aq e kaq shkollave mund të konsiderohet si kriteri i karakterit etnik të një populli. Kjo nuk i ka shpëtuar pa vënë re autorëve seriozë që kanë studiuar çështjet e Ballkanit. Engelhardt thotë tekstualisht:

“Përsa i përket shkollës si shenjë dalluese e kombësisë, kjo cilësi nuk mund t’i atribuohet atyre në Maqedoni ku kleri grek e ka patur prej shekujsh monopolin, domethënë drejtimin ekskluziv të institucionit të arsimit publik 1).

Statistikat zyrtare të Turqisë dhe numri i shkollave greke, janë argumentet më të fortë të shovenëve fqinj, arma e tyre e preferuar por që ne e pamë së toku se sa vlen ajo.

\*

\*

\*

\*

\*

Por le të shohim se çfarë thonë këto statistika të famshme, aq të dashura për grekët:

Qysh në ditët e para të Janarit 1913 qeveria helenike paraqiti në Konferencën e Ambasadorëve në Londër një memorie mbi kufijtë e Epirit, të cilës i bashkëngjitej një tabelë statistikore, e nxjerrë edhe ajo nga të dhënat otomane të vitit 1908 2).

Sipas kësaj memorieje të famshme kazaja e

## MID'HAT FRASHËRI

Korçës-numëronte 69.609 banorë, nga të cilët 35.438 janë grekë dhe 34.171 muslimanë. Nga këta 35.438 grekë, 33.894 ishin shqipfolës dhe 1.544 vllëfolës. Pra  $33.894 + 1.544 = 35.438$ . Me fjalë të tjera në kazanë e Korçës ka 34.171 shqiptarë muslimanë dhe 33.894 shqiptarë otrodoksë, plus 1.544 vllëhë osë shqiptaro-vllëhë 3).

Gjithmonë sipas kësaj promemorieje të famshme që siç u tha më lart është një kryevepër absurditeti llafollogjik, kazaja e Starovës e lakmuar nga Grekët përmban 13.409 banorë ndër të cilët 10.104 muslimanë dhe 3.305 grekë, që të gjithë shqipfolës. Pra, asnjë grek.

Kazaja e Kolonjës me 14.701 banorë numëron 9.664 muslimanë dhe 5.057 grekë, që të gjithë shqipfolës. Pra, asnjë grek.

Të tri kazatë e sipërpërmenduar bënin pjesë në Vilajetin e Manastirit. Ja tani shifrat për vilajetin e Janinës:

Përmeti me 17.986 banorë numëron 9.265 muslimanë dhe 8.721 grekë nga të cilët 8.721 shqipfolës dhe 1.600 vllahofonë. Pra, asnjë grek.

Pjesa e kazasë së Tepelenës, e reklamuar nga grekët, numëron rreth 10.241 banorë, nga të cilët 5.855 muslimanë dhe 4.386 grekë që të gjithë shqipfolës.

Himara me një popullsi të përgjithshme prej 11.968 banorësh numëron 7.218 grekë dhe 4.750 muslimanë, nga të parët 3.865 janë greqishtfolës dhe 3.353 shqipfolës. Pra vetëm 3.865 grekë.

Kazaja e Delvinës prej 21.836 banorësh numëron 16.386 grekë dhe 5.350 muslimanë; nga shifra e parë 12.231 janë greqishtfolës dhe 4.155 shqipfolës.

## Popullsia e Epirit

---

(Do të shohim më poshtë cili është karakteri i vërtetë etnik i atyre që pretendohet se janë grekë).

Kazaja e Gjirokastrës në një total prej 42.126 banorësh, numëron 21.094 grekë dhe 21.032 muslimanë.

Pra, në një popullsi të përgjithshme prej 201.876 banorësh që përfshihen në tetë kazatë e sipërpërmendura, vetëm 29.274 banorë janë grekofonë domethënë që flasin greqisht; të tjerët, e pranuar kjo edhe nga vetë grekët, janë shqiptarë qoftë të besimit musliman qoftë të besimit të krishterë. Raporti i grekofonëve me atë të shqiptarëve është afërsisht 14 përqind.

Ja pra se ku i bazojnë grekët pretendimet e tyre për ta konsideruar grek Jugun e Shqipërisë, ose Epirin e Veriut siç e quajnë ata.

Por kur grekët gjenden me shpatulla mbas murit dhe kur e shohin se janë të detyruar të pranojnë absurditetin, atëhere ata kapen mbas një argumenti tjetër.

Nga konsideratat fetare dhe shkollore ata kalojnë në konsiderata psikologjike dhe të përgjigjen: Të kesh në damarë gjak të këtillë ose të atillë, të flasësh këtë apo atë gjuhë nuk do të thotë asgjë; gjithshka, kryesorja është ndërgjegjia kombëtare, njeriu i përket racës për të cilën ai deklarohe. Dhe epirotët janë grekë nga ndjenjat!

Kjo është një tjetër logjikë. Të përpiqemi të analizojmë këtë argument të ri të grekëve.

Në fillim duhet që lexuesi perëndimor të ketë parasysh se nuk kemi të bëjmë me një komb evropian, se nuk ndodhemi përpara një grupimi të tillë etnik si francezët, anglezët, italianët, gjermanët, racat e të cilëve u janë dashur

## MID'HAT FRASHËRI

---

---

shekuj e shekuj që të zhvillohen, të afirmohen, të ndërgjegjësohen. Lexuesi nuk duhet të harrojë se ndodhet në pjesën Lindore të Europës ku gjithshka ka qenë kaq e ngatërruar, kaq e fallsifikuar, kaq e gjymtuar dhe e mbushur me mashtrim.

Ndërgjegjja kombëtare! Por a nuk është kjo ndërgjegje kombëtare. për të cilën Pukëvili njëqind vjet më parë thoshte se nuk egzistonte te grekët përpara pavarësisë së tyre? 4).

Për cilën ndërgjegje duhet të flasim? A kemi harruar se ka më shumë se tri të katërtat e shekullit kur rumunët konsideroheshin sllavë, ndërsa fisnikët e tyre mbaheshin për grekë? 5).

Ata që kanë studiuar sadopak racat e Maqedonisë e dinë fort mirë se çfarë rrëmujë është atje: fshatra që sot quhen greke nesër deklarohen bullgare, pasnesër deklarohen rumune dhe më vonë serbe.

Asgjë e përcaktuar, asgjë e qëndrueshme përsa i përket kombësisë së këtyre njerëzve, të nënshtruar ndaj një çoroditjeje tepër fantastike, sepse është kisha, prifti, shkolla, janë bandat që diktojnë në ndërgjegjen e tyre. Jo rrallë dëgjon të thuhet: az sem gerc, no ne znam gertski (unë jam grek, por nuk di greqisht). Dhe ky bullgar i mirë që sot e quan veten grek, nesër do të besojë se është serb dhe ndoshta një ditë do ta kuptojë se është bullgar 6).

Nuk do të harrojmë fjalët e famshme të princit të parë të Bullgarisë, Aleksandër de Battenqerg: Kemi bërë Bullgarinë, tani na duhet të bëjmë bullgarët.

Pra meqënëse ndërgjegjja kombëtare nuk shpreh asgjë të saktë dhe në rastin kur kjo ndërgjegje është e sofistikuar

## Popullsia e Epirit

nga ndikimi i kishës dhe i propagandës, detyrohem i të marrim si kriter të karakterit etnik gjuhën dhe gjakun e një populli, sepse vetëm atëhere do të jemi në rrugë të drejtë.

Do të ishte mirë që antropologët të ndërmerrnin studime antropologjike mbi popullsinë e Epirit dhe jemi të bindur qysh tani se këto studime shkencore do të jenë mbështetëse të tezës sonë. Në fakt, ndryshimi ndërmjet kaffës së një shqiptari dhe të një greku është aq i madh sa mjafton të shohësh një epirot ndërmjet njëmijë grekësh për ta dalluar atë menjëherë.

Duke patur njohuri mbi disa studime shkencore, le të shohim të dhënat e nxjerra nga konsideratat etnografike të udhëtarëve që kanë njohur dhe studiuar vendin tonë.

Kemi thënë më lart se kazaja e Himarës, Akrokerauni i lashtë që gjendet në jug të Vlorës, në breg të detit, me një popullsi të përgjithshme prej 11.968 banorësh ka 3.865 grekë. Por a janë ata grekë autentikë? Mos vallë ka këtu ndonjë gabim dhe këta njerëz e fshehin karakterin e tyre të vërtetë etnik?

Në fakt bëhet fjalë për banorët e tri fshatrave të Himarës: Drimada, Palasa, Himara që janë treva dygjuhshe, domethënë ku flitet njëkohësisht edhe shqip edhe greqisht. Koloneli anglez William Martin Leake që ka qëndruar në Shqipëri si konsull britanik pranë Ali pashait të Janinës thotë për himaritet si më poshtë:

“Greqishtja flitet nga të gjithë njerëzit, ndërsa italishtja nga ata që kanë udhëtuar jashtë, por femrat njohin vetëm gjuhën shqipe” 7).

Vini re: femrat në Himarë flasin vetëm shqip ndërsa

## MID'HAT FRASHËRI

---

burrat që kanë udhëtuar jashtë dhe kanë parë botë me sy mund të njohin çdo lloj gjuhe tjetër: greqisht, italisht, arabisht ose kinezçe.

Për më tepër himariotët në shërbim të mbretërisë së Napolit formonin një batalion të quajtur: Reali cacciatori albanesi 8). Pra ata nuk quheshin aspak grekë dhe, qysh prej njëqind vjetësh, askujt nuk i ka shkuar nëpër mend t'i quajë me këtë emër.

Ajo çfarë kemi thënë dhe provuar për Himarën, vlen gjithashtu edhe për dy kazatë e tjera Delvinën e Gjirokastrën, pjesë të cilave pretendohet nga politikanët e Athinës se janë territore greke.

Por mendoj të mos kufizohemi në studimin e popullsisë së rajoneve që përfshihen në kufijtë e përcaktuar nga konferenca e Londrës për Shqipërinë e pavarur. Për ne Epiri është krejt Jugu i Shqipërisë që shtrihet në kufijtë e tij të vërtetë, domethënë deri në gjirin e Artës dhe në kepin e Prevezës. Epiri kufizohet dhe ndahet prej Greqisë nga malet e Pindit dhe gjiri i Ambrakisë.

Kjo pjesë e Epirit përfshin tri sanxhaqe: i Janinës, i Prevezës dhe i Igumenicës, të cilët sipas statistikave të famshme greke, aq të dashura për grekët, numërojnë: Sanxhaku i Janinës ka 128.148 banorë nga të cilët 10.706 muslimanë, 4.024 shqipfolës, 11.230 vllahfolës- si rrjedhojë 102.188 grekë dhe 25.960 jo-grekë. Sanxhaku i Prevezës ka 36.540 banorë nga të cilët 2.736 muslimanë dhe 1.100 shqipfolës. Sanxhaku i Igumenicës ka 74.844 banorë nga të cilët 34.406 muslimanë, 11.662 shqipfolës dhe 100 vllahfolës. Kështu pra, të tri sanxhakët bashkë numërojnë një popullsi



## Popullsia e Epirit

---

të përgjithshme prej 249.532 banorësh, ndër të cilët 64.594 shqiptarë dhe 11.330 vlllehë.

Nuk dëshirojmë të hyjmë në diskutim për numrin e vlllehëve në Epir, nuk na takon ne të bëjmë një përshkrim dhe numërim të fshatrave vlllehe përgjatë vargmaleve të Pindit ose për karakterin e vërtetë etnik të rajoneve të Zagories, Pogonit etj.

Lexuesi që dëshiron të dijë më shumë le të lexojë publikimet nga vetë vlllehët. Ai do të gjejë në to të dhëna tepër të hollësishme mbi çështjen e racës dhe një tjetër konfirmim mbi çfarë kemi thënë në fillim të këtij studimi mbi klerin grek dhe tiraninë e tij të patolerueshme.

Ndërsa nga ana tjetër ne duhet të jemi më të qartë për elementin shqiptar, të cilin grekët e Athinës dëshirojnë ta quajnë një minoritet në sanxhakun e Janinës dhe Prevezës. Shembulli i Himarës do të jetë përsëri i vlefshëm për ne.

Në jug të Shqipërisë ndodhet një krahinë që quhet Suli, ndërmjet Janinës dhe Prevezës, të cilën konferenca e Ambasadorëve në Londër e njohu si krahinë greke. Sot çdo grek i ndershëm do t'ju thotë se banorët e kësaj zone janë grekë dhe do të arsyetojnë se janë pikërisht suliotët ata që i kanë dhënë Greqisë kapitenët dhe heronjtë më të mëdhenj gjatë luftës për pavarësi. Bindja e grekëve në këtë pikë është absolute.

Por ka disa dhjetra vjet që grekët e kanë njohur vetë kombësinë shqiptare të suliotëve. Historiani grek Papa Rigopulos e pranonte me ndershmëri këtë tezë dhe po kështu pohohet edhe në fjalorin grek të historisë e

## MID'HAT FRASHËRI

---

gjeografisë nga autorët Vutira, Vretos dhe Vafiadhis.

Oficeri francez Adolf Serfber që me emrin Ibrahim Monsur Efendi ka qenë për një kohë të gjatë pranë Ali pashait të Janinës, duke folur për suliotët këmbëngul për gjakun e tyre shqiptar të cilët një pjesë e mirë njerëzore në Europë i marrin për grekë vetëm duke u nisur nga lufta e Ali Pashës. Për më tepër, suliotët në shërbim të qeverisë franceze në vitet 1807-1814 a nuk kishin formuar një regjiment të quajtur regjimenti shqiptar?

Për problemin e Epirit ne do të përpiqemi t'i japim lexuesit një ide më të gjerë mbi përpjekjet që bën propaganda athinase dhe fanariote me qëllimin e greqizimit të shqiptarëve.

Autori i këtij libri ka vizituar gjashtë vjet më parë tetë fshatra të pjesës jugore të Sulit, në rajonin e quajtur Laka Lelova. Në njërin nga këto fshatra, në Papadate, kam takuar një djalë rreth 10 vjeç, të cilit kur i fola shqip m'u përgjigj se nuk e dinte këtë gjuhë. Unë këmbëngula disa herë që ai të fliste shqip dhe më në fund mësova prej tij se mësuesi i shkollës, ai dhaskal i mjerë, i ndalonte fëmijët të flisnin në gjuhën amtare, madje i kërcënonte se do të bënin një herezi se do të shkishëroheshin... dhe se do të provonin në shpinë kamzhikun.

\*  
\*       \*  
\*

Nga sa thamë më lart shihet se çfarë tregojnë statistikat greke dhe ku bazohen pretendimet e fqinjëve tanë jugorë. Ndoshta mund të mendohet se grekët kanë të drejta historike mbi Epirin, një e kaluar që lidh Epirin me Greqinë, një traditë

që bashkon fatin e Shqipërisë së Jugut me atë të Greqisë.

Sigurisht, në rast se ka pretendime dhe të drejta historike, nga më absurdet janë ato të grekëve ndaj Epirit sepse Shqipëria e Jugut e quajtur Epir nuk ka qenë asnjëherë greke.

A nuk është historiani grek Tuqidiidi që thotë dhe e përsërit pa pushim se epirotët janë barbarë (domethënë jo-grekë), se ata flasin një gjuhë të pakuptueshme nga grekët? A nuk është Herodoti që i konsideron epirotët dhe maqedona-sit si të huaj? A nuk thonë të njëjtën gjë Straboni e Plutarku dhe a nuk është Demosteni thumbues që lëshon shigjetat e tij më të mprehta kundër barbarit Filip të Maqedonisë?

Gjeografi francez Malte-Brun e përmbledh shumë bukur të kaluarën e Epirit kur thotë:

“Epiri, të cilin të gjithë autorët grekë e përjashtojnë nga Greqia, është përshkruar ashtu si edhe Iliria dhe Maqedonia nga Straboni. Kantonet e tij kryesore kanë qenë në Kaoni, Thesproti dhe Molosë. Straboni dhe Plutarku na tregojnë se epirotët flisnin një gjuhë të veçantë dhe se kjo gjuhë ishte e njëjtë me maqedonishten. Duket se e folura moderne e shqiptarëve rrjedh prej saj” 8).

Pra gjatë gjithë Antikitetit, Epiri ruan një figurë të veçantë nga ajo e Greqisë. A mos vallë kjo ka ndryshuar gjatë Mesjetës? Dëshmitarët e historisë vërtetojnë se Epiri ka mbetur gjithmonë jo-grek dhe do të na vinte keq nëse grekët do të tregohen aq naivë sa të konsideronin dominimin bizantin si një dominim grek që të mund të sajnin ndonjë lloj të drejte mbi Epirin.

## MID'HAT FRASHËRI

---

Qysh nga ardhja e turqve në Europë, Epiri ka qenë konsideruar si një pjesë e Greqisë apo e Shqipërisë?

Tek një autor me origjinë greke Teodore Spandugino Cantacuzino, në një histori mbi origjinën e Turqisë (9), ne lexojmë pjesët e mëposhtme:

“Perandori Cantasuzene zgjodhi në Janinë një njeri nga shtëpia Spata dhe e bëri nën-dheshpot dhe guvernator së bashu me një Musak Topia nga të cilët njëri qëndroi në Janinë që ishte kryeqyteti i mbretërisë së Shqipërisë” 10).

Pak më poshtë lexojmë:

“Janina, e cila ishte një vend i fortë, ka qenë kryeqyteti i gjithë Shqipërisë” \*).

Dhe përsëri disa rreshta më poshtë:

“Amurati, që ishte në gatishmëri, pa pritur më gjatë, hyri në Shqipëri dhe pushtoi Artën” 11).

Pra, jo vetëm Janina por edhe Arta konsiderohej si territor shqiptar. Për më tepër Sansovino në faqen 302 na tregon se në kohën e ardhjes së turqve e gjithë Maqedonia quhej Shqipëri sepse banorët e saj flisnin shqip duke u shtrirë nga Thesalia deri në Dalmaci, kufizuar në Lindje nga lumi Strimon dhe shtatë liqenet e tij të mrekullueshëm.

Domethënë qysh nga koha e ardhjes së turqve. Epiri shqiptar nuk ishte aspak grek përkundrazi mund të thuash se një pjesë e madhe e Greqisë ishte shqiptare dhe se turqve iu desh të luftonin në Greqi jo kundër princëve vendas por kundër princëve shqiptarë 12).

Mbas pushtimit turk dhe gjatë shekujve modernë a ka pësuar ndryshime fizionomia etnografike e Epirit? Nuk e besojmë. Turqit e kanë konsideruar gjithmonë Epirin si një

tokë shqiptare dhe historianët e tyre e përshkruajnë këtë rajon me emrin arnautllëk (Shqipëri) kurdoherë kur flitet për Himarën, Delvinën, Pargën, Janinën ose Prevezën.

E tillë është konsideruar ajo edhe nga misionarët katolikë të Romës, për të cilët Epiri formonte vazhdimësinë jugore të Shqipërisë.

Një dokument interesant i ruajtur në arkivat e “Propaganda Fide” të Romës, që daton më 1703 dhe është dërguar nga peshkopi i Antivarit Mgr Vincenzo Zmaviewich, një slloven i lindur në Perasto, përcakton kufijtë e Shqipërisë që shtrihen nga Antivari dhe Dulcigno deri në gjirin e Artës në Jug (italisht në tekst).

“Shqipëria... e vënë nën zgjedhë nga turqit, e kufizuar me Maqedoninë dhe Epirin si dhe me një pjesë të mirë të skajit Dalmacisë, zë sot gjithë atë pjesë bregdetare që ndodhet ndërmjet Postroviçit, kufiri i fundit i republikës Venete dhe gjirit Ambrakisë, i quajtur liqeni Arta duke përfshirë me emrin Shqipëri jo vetëm qytetin Tivari dhe Ulqini, pranë Dalmacisë, por edhe gjithë Epirin që shtrihet nga Vlora deri në Arta si dhe pjesa më e madhe e Maqedonisë 13).

Pra, Epiri përshkruhet vetëm si pjesë, si një provincë e Shqipërisë, si Toscana në Pulia në Itali, si Gaskonje ose Provence në Francë.

Për dijetarët modernë kjo çështje qëndron vetëm kështu dhe jo ndryshe. Në botimin e tretë të vitit 1778 në Gjenevë të Enciklopedisë nga Didero dhe Dalember, në artikullin “Shqipëria”, ky vend përshkruhet i kufizuar:

“... në perëndim nga gjiri i Venecias, në veri nga

## MID'HAT FRASHËRI

Dalmacia dhe Bosnja, në lindje nga Maqedonia dhe një pjesë e Thesalisë, ndërsa në jug nga Achaie ose Livadie. Me emrin Shqipëri kuptohet Iliria e vjetër dhe Epiri i Greqisë...”

Gjatë gjysmë-pavarësisë së Ali Pashës, Epiri ka qenë konsideruar vetëm si një pjesë integrale e Shqipërisë dhe francezi Mark Bruere des Rivaux's'ka bërë gjë tjetër veçse ka thënë një të vërtetë të thjeshtë kur i spjegonte Ali Pashës së Janinës se “me Epir kuptohet e gjithë hapësira e banuar prej arnautëve ose shqiptarëve me përjashtim të Maqedonisë ku ishte vendosur pashallëku i Shkodrës” 14).

Mbas luftës ruso-turke të vitit 1877, atëhere kur projekteohej copëtimi i Turqisë, në një seancë të kongresit të Berlinit u propozua me shumë “bujari” nga Franca që t'i jepej Greqisë një pjesë e Shqipërisë së Jugut që shkonte nga Preveza deri në luginën e lumit Kalamas.

Ky ishte një territor shqiptar por në atë kohë mendohej vetëm për shtete tashmë të pavarur dhe ishte e natyrshme që të mohohej egzistenca e një kombësie tjetër aty. Shqiptarët u revoltuan kundër një dhunimi të tillë të të drejtave të tyre kombëtare. Ata protestuan kundër kësaj padrejtësie dhe e famshmjia Lidhja e Prizrenit, që shtrihej nga Shkodra deri në Prevezë, mori pjesë aktive në këtë çështje duke dërguar një mision në kancelaritë e Fuqive të Mëdha. Përkundrejt këtij manifestimi krejt të ligjshëm dhe me gjithë demostrimet dhe qëndrimet qesharake të Greqisë, gjyqi evropian e dha verdiktin e vet dhe nuk pranoi t'i jepej Greqisë një pjesë e Shqipërisë.

Kjo sigurisht ishte triumfi i drejtësisë ndaj padrejtësisë.

## Popullsia e Epirit

Nuk ka mësim më të mirë dhe më interesant se sa të lexosh korrespondencën zyrtare të asaj kohe ku përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha (anglezët, italianët dhe francezët) u detyruan të njohin vërtetësinë e fakteve dhe sugjeruan se duhet ndrequr një gabim i tillë i shkaktuar nga dashamirësia e tepruar ndaj Greqisë zhurmëmadhe 15).

\*

\* \* \*

\*

Kemi parë se sa të pabazuara janë pretendimet etnografike dhe historike të Greqisë ndaj Epirit shqiptar dhe e përsërisim akoma edhe një herë se historikisht grekët nuk mund të kenë asnjë të drejtë mbi Shqipërinë jugore. Ata nuk kanë qenë kurrë zotër të këtij rajoni dhe se përkundrazi të drejtat e shqiptarëve ndaj fqinjit jugor janë ndoshta shumë më serioze.

Po ashtu etnografikisht numri i grekëve ose të greqizuarve në Shqipëri, është tepër i vogël, ndërkohë që elementi shqiptar në Greqi arrin një shifër mjaft të rëndësishme 16).

Kemi parë gjithashtu se eksperiencia e shkollave nuk mund të merret si kriter i kombësisë dhe se ndërgjegjja kombëtare është në të shumtën e rasteve e tjetërsuar nga ndikimi tiranik i kishës greke.

Grekët që janë mjaft të zgjuar, me gjithë shovinizmin e tyre, e kuptojnë fort mirë këtë edhe kur përpiqen të sjellin një argument tjetër. Ata kapen mbas kësaj teze: kriteri i kombësisë nuk është as historik, as etnografik, as gjuhësor por është ndërgjegjja e popullit, dëshira e tij për t'u deklaruar

## MID'HAT FRASHËRI

---

i tillë apo i këtillë, është manifestimi spontan i zemrës dhe i shpirtit.

Tani, banorët e Epirit, të paktën të krishterët, e quajnë veten grekë, ndjehen grekë, kanë ndjekur dhe ndjekin shkollat greke ndërkohë që shpirti shqiptar nuk "shfaqet" në asnjë formë tek ata. A nuk është manifestimi spontan i ndjenjave filo-helenike ai që duhet të përcaktojë kriterin e kombësisë?

Spontan! Sigurisht fjala tingëllon mjaft ironike sepse do të ishte një spontanitet i çuditshëm ai që shfaqet me forcën e dëbimit nga komuniteti, me mallkime, me bandat e armatosura dhe me terrorin moral e fizik.

Ndoshta lexuesi i huaj për këto çështje, mund të ndikohet nga llafollogjia greke. Dhe ndoshta mund t'i besojë.

Por a është e vërtetë se banorët e krishterë të Shqipërisë jugore e ndjejnë veten grekë dhe se ata nuk kanë asnjë ndjenjë e ndërgjegje për kombësinë e tyre të vërtetë? A është e saktë se ata janë njerëz që ndryshojnë fe e kombësi dhe në rast se është kështu, përse i duhet dhënë kaq shumë rëndësi disa renegatëve të racës e të atdheut? A është e vërtetë se shqiptarët nuk kanë patur kurrë një ndjenjë të vërtetë të racës së tyre?

Na vjen keq që gjithmonë jemi të detyruar të përgënjeshtrojmë grekët dhe do të kishim dashur që ata të kishin të paktën një herë të drejtë. Por jemi të detyruar përsëri që të shohim se sa vlen ky argument i fundit i tyre.

Banorët e Epirit, qofshin të krishterë apo muslimanë, e kanë mjaft të zhvilluar ndjenjën e racës së tyre. Madje, edhe filo-helenët më të tërbuar, mburren dhe krenohen me këtë cilësi, për gjakun e tyre shqiptar të cilin e konsiderojnë



## Popullsia e Epirit

---

më superior dhe më të pastër se ai grek.

“Unë jam shqiptar dhe jo grek”, thonë shqiptarët në mes të Athinës, qofshin me origjinë nga Epiri apo nga Megara.

Kurrë të krishterët shqiptarë, me përjashtim të disa të shiturve të qeveria greke ose të helmuar nga propaganda megallomane greke, nuk kanë shfaqur ndonjë prirje ndaj Greqisë dhe në asnjë rast nuk u janë përgjigjur thirrjeve të grekëve.

Bandat greke e kanë bredhur kudo vendin, por ata nuk kanë gjetur kurrë mbështetje dhe si pasojë nuk kanë mundur të ushtrojnë ndikimin e tyre përveçse në disa rrethina të kufizuara të Thesalisë. Shqipëria jugore nuk ia ka vënë kurrë veshin thënieve të tyre. Përkundrazi Lidhja shqiptare e vitit 1878 numëronte shumë anëtarë të krishterë në degët e saj të Epirit.

Por dështimi i pësuar nga grekët mbas luftës ruso-turke, fakti që nuk mundën të shtien në dorë pjesën jugore të Shqipërisë, i detyroi që të përqëndrojnë të gjitha forcat dhe mjetet në këtë pjesë të Shqipërisë. Veprimtaria e ushtruar nga propaganda e Athinës gjatë këtyre 35 vjetëve të fundit ka qenë e shfrenuar dhe qeveria turke me verbërinë e saj kokëfortë dhe urrejtjen ndaj shqiptarëve, e ka mbështetur këtë mynxyrë fuqimisht duke qënë pra turq e grekë së bashku e në një mendje kundër regjimit kombëtar shqiptar. Porta e lartë dhe Jilldizi i lanë dorë të lirë Patriarkanës së Fanarit.

Me dhjetra-shkolla shqiptare të hapura në Kolonjë (në jugperëndim të Korçës) më 1893, mundën të mbijetojnë

## MID'HAT FRASHËRI

---

fshehurazi vetëm pesë vjet dhe e vetmja shkollë që pati një farë kohëzgjatje, ajo e Korçës, themeluar më 1886 u mbyll nga autoritetet turke më 1902.

Intoleranca turke e bënte shumë të vështirë, për të mos thënë të pamundur, çdo aksion në Shqipëri, por megjithatë shqiptarët nuk u dëshpëruan aspak. Shoqata shqiptare, themeluar më 1879 në Kostandinopojë, u transferua më 1881 në Bukuresht ndërkohë që shoqata të tjera lindën në Egjipt dhe në qytete të tjera të banuara me shqiptarë.

Këta shqiptarë të Rumanisë dhe të Egjiptit nuk ishin gjë tjetër veçse të krishterë ortodoks me prejardhje nga pjesa jugore e Shqipërisë, epirotë, të cilët, zotërinjtë e Athinës i quanin grekë. Veprimtaria dhe shërbimi që këto koloni i kanë bërë çështjes shqiptare, janë jashtëzakonisht të mëdha. Këta shqiptarë të krishterë kanë meritën e publikimit të librave shqip, të lulëzimit të letërsisë shqipe. Këto shoqata janë zhvilluar dhe përhapur në vazhdimësi.

Shumë shpejt lindën edhe asosacione të reja në Kostancë, Sofje dhe sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Nëse ka spontanitet, ai sigurisht gjendet në veprimtarinë e këtyre shqiptarëve të krishterë të cilët luftonin kundër tiranive të kombinuara të patriarkatit grek dhe autoriteteve turke duke përhapur propagandën kombëtare të rrethuar nga rrëziqe të panumërta 17).

Kjo propagandë ishte shumë herë më e zbehtë se sa propaganda greke e mbrojtur dhe e veshur me të gjitha imunitetet, e pajisur me fonde të pashtershme dhe me një përvojë shekullore. Kështu nuk ka asgjë të habitshme dhe të

## Popullsia e Epirit

jashtëzakonshme që numri i veprimeve të kryera nga përpjekjet e shqiptarëve, është shumë më i vogël se ai i propagandës zyrtare e jozyrtare greke. Besoj se kjo është tepër e kuptueshme.

Ndërkaq, kur tirania turke u dobësua, kur njerëzit një ditë besuan se kushtetuta e vitit 1908 i jepte liritë dhe garancitë çdo kombi të Perandorisë- atëhere u shfaq një ripërtëritje e fuqishme e shqiptarëve. Në pak kohë dhe si me magji lindën një numër i pafund klubesh, gazetash, shkollash e shtypshkronjash.

Për fat të keq kjo liri zgjati sa hap e mbyll sytë. Dy vjet më vonë, në fillim të vitit 1910, xhonturqit treguan se ishin tiranë më të këqinj se paraardhësit e tyre. Por këto dy vjet mjaftuan për t'i dhënë një drejtim zhvillimit të çështjes shqiptare dhe çdokush që dëshiron ta studiojë problemin shqiptar duhet të ketë mirë parasysh përpjekjet e mëdha të kryera gjatë asaj kohe të shkurtër.

Ndërmjet klubeve të shumtë të hapur në Shqipëri, (rreth pesëdhjetë), një numër i madh prej tyre u themeluan në Epir: në Janinë, në Korçë, në Gjirokastrë, Delvinë, Përmet, Frashër, Leskovik, Prevezë, Loros, Filat, Mazarek, Konispol, Pogon etj.

Këto ishin klube që frekuentoheshin si nga muslimanët ashtu edhe nga të krishterët, nga ata të krishterë që sot mundohen t'i quajnë grekë.

Ndërmjet gazetave shqiptare ka patur dy në Korçë dhe një në Janinë, të shtypura që të trija në shtypshkronjat e tyre; me dhjetra mijëra kopje gazetash u shpërndanë nëpër Shqipëri të shtypura në Manastir, Selanik, Kostandinopojë,

## MID'HAT FRASHËRI

---

Shkup, Shkodër, Elbasan, ShBA. Nuk vonuan të hapen edhe shkollat: çdo klub kishte edhe një shkollë nate, ndërsa shkolla të tjera të rregullta u çelën në kryeqendrat dhe fshatrat e trevave të Korçës dhe të Gjirokastrës deri në Negovan (Follorinë).

Nisën të shfaqen shoqatat letrare në Korçë dhe në Janinë (18) si dhe një shoqatë muzikore në Korçë me një orkestër frymore të mirë. Kolonitë shqiptare në SHBA (kolonë që jetuan vetëm disa vjet atje dhe pastaj u rikthyen në shtëpitë dhe vatrat e tyre) u organizuan shumë mirë duke themeluar shoqatën federative "Vatra", shoqatë që grumbullon sot rreth vete dyzet degë duke çelur në të njëjtën kohë edhe një gazetë të përjavshme shumë të mirë, (sot e përditshme).

Përpjekjet e bëra në qendër, ne veri dhe në lindje të Shqipërisë nuk ishin të vogla: gazetat përpigëshin të përhapnin mendimin intelektual, shtypshkronjat prodhonin një ushqim me vlerë dhe mjaft të bollshëm me libra të dobishëm, klubet dhe shoqatat letrare e shkollore përgatisnin me durim një të ardhme më të mirë. Një shkollë e mirë normale e themeluar në Elbasan më 1909 ishte shpresa e jonë për organizimin e mëtejshëm të shkollave fillore. Por rëndësi patën për vëllazërimin e patriotëve dhe intelektualëve edhe dy kongreset e mbledhuara përkatësisht në Manastir dhe Elbasan.

Përfitimi nga liria e dhënë prej autoriteteve turke, nuk ishte veçse një gjysmë-lirie. Duhej çliruar gjithashtu edhe nga thonjtë e klerit grek, duhej dalë nga ai qerthull poshtërues i Fanarit, agjenti më i fuqishëm i helenizmit.

Kështu qysh në ditët e para të kushtetutës së famshme xhonturke, u krijua në Korçë një Lidhje Ortodokse me një

## Popullsia e Epirit

organ të përjavshëm me të njëjtin emër. Lidhja kërkonte emancipimin e kishës shqiptare ose të paktën të drejtën zyrtare për të predikuar në gjuhën shqipe një pjesë të liturgjisë. Tashmë, kjo lëvizje kishte filluar në Amerikë ku shqiptarët epirotë kishin dy kisha të tyre dhe dy priftërinj që përkthyen librat e parë të meshës.

E gjithë kjo lëvizje: klube, shkolla, shoqata letrare dhe muzikore, lidhje fetare po shkonte si jo më mirë. Por zhvillimi dhe përparimi i tyre i madh, do të shkaktonte turbullirë tek të tjerët. Xhonturqit u treguan njëqind herë më reaksionarë dhe tiranë se sa padroni i tyre Sulltan Hamiti. Ata e panë me sy të keq përparimin paqësor të shqiptarëve. Ndërkohë qëndresa energjike dhe burrëria e shqiptarëve, u dha atyre një pretekst për një kryqëzatë të vërtetë turke kundër racës shqiptare.

Ekspedita të dërguara njera pas tjetrës kishin marrë urdhër që të mbysnin çdo shenjë të rilindjes dhe të rizgjimit shqiptar. Carmatosja nuk ishte veçse një pretekst, në të vërtetë duheshin ndëshkuar nacionalistët bashkimas (sipas emrit të klubit të tyre "Bashkimi"), duheshin mbyllur shkollat, të ndaloheshin gazetatat dhe t'i dorëzoheshin inkuzicionit musliman veprat e nacionalizmit. Shkishërime, gjyqe kadilerësh kundër alfabetit latin, djegje në turrën e druve, asgjë nuk lanë mangut turkomëdhenjtë e rinj që udhëhiqeshin më shumë nga një mëri e verbër vetiake se sa nga arsyet e shtetit. Por ata që ngazëlloheshin gjatë kësaj kohe qenë agjentët e helenizmit dhe pothuaj të gjithë priftërinjtë e patriarkët, që duke harruar divergjencat e mëdha me turqit, u kthyen menjëherë në spiunë të autoriteteve turke.

## MID'HAT FRASHËRI

---

Në këtë luftë me xhonturqit, kanë qenë pikërisht shqiptarët e jugut të Shqipërisë, epirotët, ata që luajtën rolin më të madh e më të rëndësishëm duke zhvilluar mitingje proteste, qëndresë me armë në dorë ose propagandë dhe luftë paqësore. Ishin gjithashtu epirotët ataqë shpallën me një zë të lartë vullnetin dhe dëshirat e tyre, ishin ata që ranë viktimat të idealit kombëtar gjë që dëshmohet nga gjashtë djem të rinj të vrarë në një përpjekje në Korçë pesë prej të cilëve ishin të krishterë ortodoksë, epirotë dhe njeri prej tyre ishte biri i atij që katër vjet më parë ishte vrarë nga plumbi i një vrasësi politik grek në Selanik.

Dhe janë, padyshim, këta shqiptarë të jugut që janë quajtur grekë nga politikanët dhe publicistët e Pireut dhe të Athinës.

### Shtojcë

Do të riprodhojmë më poshtë disa telegrame të dërguara nga atdhetarë të kolonive shqiptare të Rumanisë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Sofies. Po e përsërisim edhe një herë se këto koloni janë veçse përfaqësues të Shqipërisë së Jugut, domethënë të Epirit dhe përveç atyre të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të gjithë të tjerat janë të banuara prej të krishterëve të ritit ortodoks.

### TELEGRAME PROTESTE NGA BUKURESHTI

**S.Excel Eduard Grej, Londër.**

Me mijëra shqiptarë më banim në Rumani, të mbledhur në një miting të madh në Bukuresht, shprehim me

## **Popullsia e Epirit**

---

respekt shpresën tonë se Britania e Madhe, besnike e traditave të saj fisnike dhe liberale, do të japë mbështetjen e vet të fuqishme për realizimin e shtetit shqiptar, me kufij të përcaktuar drejtë. Ne nuk do të pranojmë që të realizohen pretendimet e shteteve ballkanike që synojnë territore shqiptare. Ne i lutemi me respekt Shkëlqesisë Suaj që të marrë në konsideratë ankesat tona dhe të denjojë të na sigurojë ndihmën e çmuar.

**Kryetari i mitingut**

**Dr. Temo.**

**23 Dhjetor 1912.**

**Shkëlqesisë së Tij Sir Eduard Grej,**

**Sekretar Shteti**

**Kryetar i Konferencës së Ambasadorëve  
të Fuqive të Mëdha.**

**Londër.**

Ne të nëshkruarit shqiptarë me prejardhje nga Korça, në emër të tremijë bashkëatdhetarëve të tjerë me banim në Rumani, përfaqësues të sinqertë të ndjenjave të vërteta të shqiptarëve të lokalitetit tonë të lindjes, me respekt të thellë i lutemi Shkëlqesisë Suaj që të merrni në konsideratë këtë protestë energjike kundër pretendimeve të padrejta të Greqisë për të aneksuar qytetin tonë.

Korça është e mirëfilltë shqiptare. Gjuha dhe zakonet janë shqiptare. Atje ndodhen shkolla shqiptare dhe tipografi që prodhojnë gazeta në gjuhën tonë.

Në qytetin tonë janë mbajtur mitingje madhështore për të mbrojtur të drejtat tona kombëtare. Atje ka lindur

## **MID'HAT FRASHËRI**

---

iniciativa e Kongresit të Manastirit më 1908 ku është afirmuar solidariteti i të gjithë shqiptarëve.

Gjithashtu atje ka egzistuar shoqata e parë e kulturës intelektuale për të çelur dhe mbajtur shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Me respekt i lutemi Shkëlqesisë Suaj të marrë në konsideratë ankesat tona. që në bazë të drejtësisë, krahina jonë të jetë pjesë e shtetit shqiptar, që po krijohet nga dashamirësia e Fuqive të Mëdha, në mënyrë që ne të mund të vazhdojmë në të ardhmen përpjekjet që kemi filluar 30 vjet më parë për emancipimin kulturor.

Ju shprehim Shkëlqesi shpresën Tonë që të vendoset siç është e drejta dhe ne do të ruajmë një mirënjohje të përvetshme.

**Vazhdojnë 53 firma  
13 janar 1913.**

**Sir Eduard Grej,  
Londër.**

Ne të nënshkruarit shqiptarë me banim në Bukuresht, që së bashku me të gjithë popullin shqiptar kemi parë vazhdimisht tek kombi anglez kampionin tradicional të mbrojtjes së lirive të shtypura, i lutemi Shkëlqesisë Suaj të mirëpresë shprehjen e mirënjohjes sonë të thellë për mbrojtjen fisnike që ju i keni bërë të drejtave të kombit shqiptar në fjalimin e mbajtur në dhomën e komuneve.

**Vazhdojnë 45 firma**



## **Popullsia e Epirit**

---

10 Prill 1913.

Sir Eduard Grej,  
Londër.

Ne të nëshkruarit shqiptarë të lindur në qytetin e Korçës dhe rrethinat e saj, në emër të kolonive shqiptare të Rumanisë. me respekt të thellë i lutemi Shkëlqesisë Suaj që të marrë në konsideratë protestat tona kundër veprimeve të grekëve, që me terror dhunojnë ndërgjegjen kombëtare dhe ndjenjat e vëllezërve tanë.

I lutemi Shkëlqesisë Suaj në emër të drejtësisë dhe të drejtave të kombeve që të ndërhyri pranë Konferencës me qëllim që Korça, djepi i emancipimit tonë kombëtar dhe qendra kryesore e kulturës intelektuale shqiptare, ashtu si edhe rajoni shqiptar i Camërisë, të mbeten të pandara nga Shqipëria.

**Vazhdojnë 131 firma  
16 Qershor 1913.**

### **Kabinetit të Gjashtë Fuqive**

Ndihemi tepër të dëshpëruar pasi që çdo ditë nga Shqipëria marrim vesh mbi krimet e tmerrshme të çdo forme, të kryera nga ushtria greke dhe bandat e organizuara nga qeveria e Athinës ndaj popullit tonë në territoret e pushtuara nga trupat greke.

Në emër të humanizmit dhe të qytetërimit i lutemi me respekt Shkëlqesisë Suaj që të bëjë ç'është e mundur për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje të patolerushme dhe që

# MID'HAT FRASHËRI

---

---

rajonet që do t'i rikthehen Shqipërisë të zbrazen prej hordhive sa më shpejt që të jetë e mundur.

**Në emër të kolonive shqiptare të Rumanisë  
KOMITETI  
13 Shtator 1913.**

## TELEGRAM NGA VLORA

**Shkëlqesisë së Tij, sir Eduard Grej,  
Kryetar i Konferencës së  
Ambasadorëve  
Londër.**

Delegatët e Korçës, të mbledhur në një komision në Vlorë, kanë vendosur t'i bëjnë të ditur Konferencës së Ambasadorëve në Londër sa vijon:

Ndërmjet 150.000 banorëve, muslimanë ashtu edhe të krishterë, të sanxhakut të Korçës, nuk ka asnjë grek të vetëm, dhe megjithë propagandën shkollore dhe ekleziastike të bërë me kaq mundim nga patriarkati grek, këta banorë kanë ruajtur gjithmonë ndërgjegjen e tyre kombëtare shqiptare. Nën regjimin turk, kur kombësia e shqiptarëve qe e mohuar dhe nacionalistët qenë të persekutuar, Korça ka patur të parat shkolla shqipe si në kryeqendër ashtu edhe në rrethinat dhe qyteti ka qenë gjithmonë qendra drejt së cilës bashkoheshin aspiratat kombëtare, me shkollat, gazetatat, shoqatat e saj, si dhe me Lidhjen e saj Ortodokse, e cila kishte për qëllim njohjen zyrtare të komunitetit Shqiptar ortodoks dhe emancipimin kundër ndikimit të klerit grek.

Kombësia e pastër shqiptare e sanxhakut të Korçës është dëshmuar nga shumë raporte të përfaqësuesve të huaj, dhe ndërmjet të tjerash edhe prej një oficeri suedez, i ngarkuar me organizimin e xhandarmërisë në Maqedoni. Nëse veprimtaria kombëtare shqiptare në Korçë ka qenë shumë aktive, ajo e bijve të saj jashtë vendit ka qenë akoma më e gjallë.

Mëse 50.000 shqiptarë nga Korça me banim jashtë Shqipërisë, kanë bashkuar forcat dhe vullnetin e tyre për çështjen kombëtare, duke krijuar shoqata, shtypshkronja, komitete dhe gazeta shqiptare.

Korça, në këto katër vjetët e fundit, ka konfirmuar aspiratat e saj kombëtare me anën e një mitingu prej 12.000 vetësh kundër regjimeve të poshtra të xhonturqve, demonstrim krejt i ndryshëm nga i ashtuquajturit miting i organizuar nga grekët me ndihmën e bajonetave.

Të gjithë konsujt e Fuqive të huaja kanë qenë dëshmitarë të këtyre manifestimeve spontane kombëtare, si dhe për gjakun e derdhur nga rinia shqiptare e krishterë për çështjen kombëtare.

Në mbrojtje të të drejtave tona legjitime, ne protestojmë përpara përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha kundër pretendimeve të grekëve përse i përket sanxhakut të Korçës, dhe shpresojmë se zëri i 150.000 shqiptarëve do të gjejë një jehonë në ndërgjegjen e drejtësisë evropiane, me besimin se delegatët e fuqive të mëdha nuk do të ratifikojnë aktin e padenjës të sakrifikimit të një populli, duke e vënë atë nën një zgjedhë të huaj.

Në emër të Komisionit

Stavri Karoli

## MID'HAT FRASHËRI

---

15 Maj 1913.

### TELEGRAME NGA SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

**Shkëlqesisë së Tij  
zotit Eduard Grej,  
Sekretar i Jashtëm, Londër:**

Nacionalistët shqiptarë të të gjithë besimeve dhe nga të gjitha pjesët e Shqipërisë të mbledhur në Kuvend në Boston, me respekt shprehim shpresën që Anglia, besnike e traditave të saja të lavdishme, nuk do të mbështesë planet e Ballkanit për plaçkitjen dhe ndarjen e Shqipërisë duke parandaluar në këtë mënyrë gjakderdhjen e kryengritjes së ardhshme shqiptare kundër pushtuesve dinakë.

**Shqiptarët e Bostonit.  
17 Nëntor 1912.**

**Madhërisë së Tij Perandorit,  
Berlin.**

Nacionalistët shqiptarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të mbledhur në Boston nga të gjitha trevat e vendit i ofrojnë Madhërisë së Tij falenderimet e tyre dhe respekt për mbrojtjen e gjerë të Kombit Shqiptar.

Populli shqiptar do t'i jetë gjithmonë mirënjohës Gjermanisë.

Rroftë Madhëria e Tij!  
Rroftë Gjermania!

**Shqiptarët e Bostonit.**

## **Popullsia e Epirit**

---

17 Nëntor 1912.

**Shenjtërisë së Tij,  
Papës së Vatikanit,  
Romë.**

At i Shenjtë!

Shqiptarët e Amerikës, që i përkasin besimeve të ndryshme, mbajtën në Boston një Kuvend ku u vendos t'ju lutemi Shenjtërisë Suaj, si autoriteti më i lartë moral në botë, që të përdorni influencën Tuaj për të parandaluar plaçkitjen dhe copëtimin e Shqipërisë. Një vend si ky i yni i ka dhënë Kishës: Shën Xheromin, Papa Klementi XI, dhe kampionin e famshëm të Krishtërit Gjergj Kastriot Skënderbeg. Serbët dhe grekët, të cilët tani duan të ndajnë Shqipërinë, janë pinjollët e atyre që e detyruan pjesën më të madhe të popullit shqiptar të braktisë Kishën e Shenjtë të Romës. Nisur nga bekimi Juaj për Shqipërinë, ne thërrasim Rroftë Shenjtëria Juaj!

**Shqiptarët e Bostonit.  
17 Nëntor 1912.**

**Shkëlqesisë së Tij Zotit Eduard Grej,  
Sekretar i Jashtëm, Londër.**

Në mbledhjen e gjerë mbajtur në Boston, dje, nga shqiptarët e Vëllazërisë së Korçës "Arsimi" nën kujdesin e Federatës panshqiptare të Amerikës "Vatra", mijëra kristianë nga Korça miratuan unanimisht rezolutat duke protestuar kundër masakrimit të burrave dhe grave në Korçë dhe rrethinat nga ushtarët grekë si edhe kundër shkatërrimit të rreth tetë fshatrave rreth Devollit. Ne me respekt i lutemi

## MID'HAT FRASHËRI

---

Konferencës së Ambasadorëve që të ndalojë këtë kasaphanë dhe pagëzimin e detyrueshëm të fëmijëve të vëllezërve tanë muhamedanë. Ne gjithashtu mendojmë se Korça dhe rrethinat duhet të përfshihen brenda kufijëve të Shqipërisë autonome për hir të paqësimit dhe parandalimit të gjakderdhjes.

**Shqiptarët e Bostonit**

**Kryetari: Kristo Kirka**

**2 Shkurt 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Disa qindra shqiptarë nga qyteti i Dardhës, pranë Korçës, banues këtu, i lutën Konferencës së Ambasadorëve që Dardha të përfshihet në Shqipëri, në kufizimin e propozuar të kufijve të saj, kështu që kufijtë e lashtë të Shqipërisë të ruhen sa më shumë të jetë e mundur.

**Londsale, R.I. Klubi i të rinjve shqiptarë të Dardhës.**

**6 Mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Një mijë shqiptarë kristianë dhe muhamedanë të Bideford-it dhe Sakos në qarkun e Jorkut dhe shtetin e Mejn-it, ish banues të Korçës dhe Janinës në Shqipëri, në mënyrë shumë të respektuar filluan protestat e tyre kundër barbarive të kryera mbi popullatën e Shqipërisë, burrave, grave dhe fëmijëve, nga ana e ushtarëve serbë dhe grekë në luftën e Ballkanit. Ne me gjithë zemër aprovojmë pavarësinë e kombit shqiptar.

**Komiteti Shqiptar.**

**6 mars 1913.**

## **Popullsia e Epirit**

---

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Shqiptarët nga Xhejmstaun, Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një takim të gjerë, unanimisht protestojmë para Konferencës së Ambasadorëve në Londër kundër tjetërsimit të Korçës prej Greqisë dhe do të luftojmë kundër telegrameve të gënjeshtërtë dhe çorientuese të disa shqiptarëve të helenizuar.

Ne ju kërkojmë juve mbështetje që Korça të përfshihet në një Shqipëri të pavarur, për hir të pqësimit dhe parandalimit të gjakderdhjes së mëtejshme.

**Gust Lepsesty, Kryetari.**

**11 Mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Disa qindra shqiptarë nga Korça dhe Kolonja, në një takim të mbajtur sot në Levistoun, Meine, miratuan unanimisht rezolutën për t'i kërkuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër që Korça jonë e pastër etnikisht dhe e gjithë Kolonja të përfshihen në brendësi të kufijve të Shqipërisë së pavarur për hir të paqësimit.

**Kryetari: Const.Xhon.**

**14 Mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Në një takim të gjerë mbajtur në Lin, Masaçusit, nga disa qindra shqiptarë të Lynu-Peapody, Mass., nga Korça, Përmeti, Leskoviku dhe Gjirokastra, me shumë respekt i

## MID'HAT FRASHËRI

---

---

luten Konferencës së Ambasadorëve në Londër që katër krahinat e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës të përfshihen në kufinj të Shqipërisë së Pavarur për hir të paqësimit dhe duke parandaluar gjakderdhjen e mëtejshme.

Shqipëria për Shqiptarët dhe jo për të tjerët.

**Kryetari: Sokrat Naum Benja.**

**14 mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej,**

**Londër.**

Shkëlqesia Juaj,

Qytetarët shqiptarë nga qyteti i Korçës, por tanimë banues në Werster, Mass, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një takim publik të mbajtur këtu, më 16 Mars, ju kërkojmë vendosmërisht Shkëlqesisë Suaj dhe Konferencës së Ambasadorëve që të lejojë qytetin e Korçës të qëndrojë nën Shqipëri të Pavarur.

Gjithashtu të mos përfillë telegramet e mëparshme për të qënë ajo nën sundimin Grek, sepse ato janë dërguar nga persona nën kontrollin grek.

**Kryetari: Pandi Lilo.**

**21 Mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej,**

**Londër.**

Ne, shqiptarët e Hempshairit të ri qëndror nga Korça dhe Janina, në një takim të gjerë të mbledhur në Konkord me shumë respekt i kërkojmë Konferencës së Ambasadorëve në Londër të ruajë integritetin e krahinave të Shkodrës, Kosovës,



## **Popullsia e Epirit**

---

Manastirit dhe Janinës si pjesë të Shqipërisë së Pavarur. Ne besojmë që kjo do të sigurojë një paqësim të shpejtë dhe parandalimin e gjakderdhjes në vitet që do të vijnë.

Shqipëria për shqiptarët dhe jo për të tjerët.

**Sotir Kostandini, Qerim Panariti.**

**25 Mars 1913.**

**Zotit Eduard Grej,**

**Londër.**

Në një takim të gjerë të mbajtur në Atlantik Siti, Nju Jork nga qindra shqiptarë prej të gjitha trevave të Shqipërisë, me shumë respekt i kërkojmë Konferencës së Ambasadorëve në Londër, që Janina, Korça, Kosova dhe Shkodra të përfshihen në kufjtë e Shqipërisë së Pavarur, për hir të paqësisimit dhe parandalimit të gjakderdhjes së mëtejshme.

**Kryetari: A.Anastasiadhi.**

**8 Prill 1913.**

**Zotit Eduard Grej,**

**Londër.**

Në një takim të mbajtur në Mançester, Nju Hempshair, qindra shqiptarë nga Korça dhe afërsitë e saja unanimisht votuan në shenjë proteste kundër metodave të përdorura nga qeveria greke e cila i detyron shqiptarët në shtëpitë e tyre për të regjistruar preferencat ndaj sundimit grek dhe më tej kundër çdo ndikimi të huaj cilidoqoftë në Shqipëri. Shqiptarët janë inteligjentë në mënyrë të mjaftueshme për të qeverisur vehten pa ndihmën e Grekëve. Ata e meritojnë dhe dëshirojnë një vend të lirë dhe të pavarur.

## MID'HAT FRASHËRI

---

Shqipëria për shqiptarët dhe shqiptarët për Shqipërinë është motoja jonë.

**Klubi Edukativ Shqiptar  
"Zgjimi".**

**25 Prill 1913.**

**Zotit Eduard Grej,  
Londër.**

Në takimin e gjerë në Xhejmstoun. Nju Jork. shqiptarët unanimisht protestuan kundër plebishitit të rremë për kolonizimin e kufijve jugorë të Shqipërisë, Fuqitë e Mëdha të mos lejojnë ushtrinë greke të zgjedhë kufijtë.

**Kryetari: Lepsisty.**

**25 Prill 1913.**

**Zotit Eduard Grej,  
Londër.**

Në një miting të gjerë të mbajtur në Bufalo, Nju Jork, nga shqiptarët e Korçës u kërkua që qyteti i tyre të mbetej nën qeverinë e re të Shqipërisë. Ne jemi të gjithë vendas nga Korça e Shqipërisë, përveç metropolit grek.

**Shqiptarët e Bufalos.**

**2 maj 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Tridhjetë mijë shqiptarë nga të gjithë anët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një takim të mbi njëmijë vetëve, mbajtur sot në Boston, protestojnë nëpërmjet delegatëve tanë kundër veprimit të padrejtë të Konferencës përsa i përket kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë.

Ne protestojmë gjithashtu kundër propozimit të gënjeshtërt grek për fiksimin e kufijve jugorë me plebishit,

## **Popullsia e Epirit**

---

për atë që kjo votë nuk do të shprehë vullnetin e lirë të shqiptarëve por vullnetin grek, të ndikuar mbi shqiptarët me anën e bajonetave.

Informojmë Konferencën e Nderuar se ne njerëzit që protestojmë, jemi shumica kristiane prej Jugut të Shqipërisë.

Prandaj i lutemi Shkëlqesisë Suaj ta marrë në konsideratë seriozisht problemin e të gjithë shqiptarëve dhe ti japë atij një zgjidhje të drejtë, sepse ju sigurojmë juve me fjalën e nderit tonën më të respektuar “besa besën” që nuk do të ketë kurrë paqe në ballkan nëqoftëse ne do të na hiqet toka që na përket për mbi pesë mijë vjet.

**Përfaqësuesit e gjithë shqiptarëve në USA.**

**2 maj 1913.**

**Zotit Eduard Grej,**

**Londër.**

Ne shqiptarët e Sirakuzës, Nju Jork, në një takim publik unanimisht i kërkojmë Shkëlqesisë Suaj dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër ta lejojë Korçën të mbetet nën pavarësinë shqiptare.

Kontrolli grek do të jetë i dëmshëm për popullatën e saj. Ata janë shqiptarë dhe punojnë veç për Shqipërinë.

Për shkak të ndikimeve greke, kongresi Shqiptar nuk mund të protestojë. Shqiptarët nuk lejohen të shprehin pikëpamjet e tyre të lira; ata janë të persekutuar.

Metropoliti është i vetmi grek në Korçë. Vetëm personat që flasin gjuhën shqipe duhet të lejohen të votojnë.

Ne kërkojmë me respekt ndihmën Tuaj.

**Kryetari: Vasil N.Progri.**

**15 Gusht 1913.**

## MID'HAT FRASHËRI

---

**Zotit Eduard Grej,  
Londër.**

Pesëqind shqiptarë nga Sentrëll Nju Hempshair në një takim të mbledhur në Konkord nëpërmjet një note të fuqishme protestuam kundër asaj që Korça dhe rrethinat të jenë nën sundimin Grek siç u propozua nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër.

Ne nuk do të pranojmë një propozim të tillë duke qenë nën sundimin grek. Në rast të kundër do të protestojmë fuqishëm dhe vazhdimisht pasi që nuk shohim shpresë tjetër.

**22 Gusht 1913.**

**Zotit Eduard Grej, Londër.**

Ne shqiptarët e Gari-t Ind dhe rrethinat iu kërkojmë me ngulm Shkëlqesisë Suaj që Korça dhe fshatrat përreth, duke qenë të banuara vetëm nga shqiptarët, në emër të humanizmit, të përfshihet në Shqipëri. Përndryshe gjakderdhja nuk do të shmanget dot.

Ne do të kërkojmë të drejtat tona.

**26 Gusht 1913.**

**S. Ex. Sir Eduard Grej.  
Londër.**

Shoqëria federative "Vatra" në emër të 40.000 anëtarëve, pjesa më e madhe e të cilëve të krishterë nga Shqipëria e Jugut, të bindur në pavarësinë e Britanisë së Madhe dhe me simpatinë e sinqertë të Shkëlqesisë Suaj, ju lutemi me respekt të mbështesni protestat e saj kundër privilegjeve që të ashtuquajturit epirotë kërkojnë për ortodoksët, nën të

## **Popullsia e Epirit**

---

cilën etiketë fshihen veçse intriga greke.

**Sekretari i "Vatrës"**

**L.Kristo.**

**15 Maj 1914.**

**S.Ex.Eduard Grej,**

**Kryetar i Konferencës së Ambasadorëve,**

**Londër.**

Ashtu siç është Shkodra, ashtu është edhe Korça për Shqipërinë. Pa Korçën nuk do të kishte patur rilindje moderne të shpirtit shqiptar. Ajo është Athina jonë. Pa Korçën, gjysma e popullit tonë, toskët, do të ishin privuar nga metropoli i tyre intelektual dhe do të mbeteshin të kërcënuar nga e ardhmja. Në emër të popullit shqiptar ne ju lutemi me gjithë shpirt Shkëlqesisë Suaj që ta vendosë Korçën në rajonet e shtetit shqiptar.

**Përfaqësuesit e kolonive shqiptare të Bullgarisë,  
Kristo Luarasi, redaktor, i krishterë,  
Veli Kolonja, musliman.**

**29 Maj 1913.**

**Shënim:** Kemi riprodhuar më lart vetëm një nga telegramet e dërguara nga shqiptarët në kolonitë e mësipërme. Numri real i telegrameve është shumë i madh, por ne nuk kemi dashur ta ngarkojmë më tepër këtë broshurë të vogël, prandaj kemi lënë jashtë fletëve pjesën më të madhe të tyre.

## MID'HAT FRASHËRI

---

**Zotit Eduard Grej,  
Londër.**

Në një miting të gjerë të shqiptarëve banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbajtur në 7 Dhjetor në Feniks Holl, Boston, u miratua gjithashtu një rezolutë duke ju transmetuar Shkëlqesisë Suaj shprehjet e një mirënjohjeje të thellë tonën për iniciativën njerëzore të marrë nga ju për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të problemit shqiptar dhe kështu të përfundojë era e shtypjes dhe e metodave barbare të mizorive greke në territorin shqiptar.

**Kryetari: C.Hotova  
16 Dhjetor 1913.**

**Zotit Eduard Grej,  
President i Konferencës së Ambasadorëve,  
Londër.**

Ne, përfaqësuesit nënshkrues të kolonisë së shqiptarëve në Bullgari, protestojmë shumë rreptësisht kundër takimeve të mbajtura në Shqipërinë e jugut në të cilat është detyruar që një pjesë e Shqipërisë të mbetet nën kontrollin grek. Mitingu i përmendur është bërë nën presionin e autoriteteve greke dhe nuk shpreh vullnetin e popullatës shqiptare. Dëshira e popullit tonë është që tërë vilajeti i Janinës të përfshihet në Shqipërinë e ardhshme, gjë e cila nëse nuk pranohet, paqja në Ballkan nuk do të jetë e sigurtë.

**Th. Sotiri, Kristo Luarasi, D.Molla,  
H.Prosi, Pando Devolli, Jani Korça, Ath.  
Nikolla, Veli Kolonja, Ibrahim Leskoviku,  
Jani Gjirokastra.**

**23 Prill 1913.**

# Popullsia e Epirit

---

---

## SHËNIME

1. Cështja maqedonase, nga Ed. Engelhardt, Paris 1906, f.30.
2. Të dhënat e mëposhtme i kemi nxjerrë nga libri "Irredentizmi helenik", nga Charles Velley, Paris 1913, që riprodhon promemorjen greke dhe shifrat e tabelës.
3. Ne e vemë në dyshim vërtetësinë e këtyre shifrave, sepse agjentët grekë kanë patur interes ta shtojnë numrin e "të krishterëve", shtetësinë e tyre, ndërkohë që shqiptarët muslimanë kanë patur gjithmonë zakon të regjistrojnë një numër sa të jetë e mund më të vogël gjatë regjistrimeve. Nga kjo arrijmë në përfundimin se në këto shifra numri i të krishterëve duhet të jetë të paktën 5 përqind më i lartë, ndërsa ai i muslimanëve 5 përqind më i ulët nga realiteti.
4. Shih: "Udhëtim nëpër Greqi, Paris 1820
5. Xenopol, "Historia e Rumanisë", Paris 1896, me parathënie të Alfred Romband.
6. "Mbi këtë tezë shih broshurën interesante të profesorit serb Cvijiç: "Shënime mbi etnografinë e Maqedonisë", Paris 1906.
7. W.M.Leake: Travels in Northern Greece, London 1835, vol.I, ph.88.
8. W.M.Leake: Vepër e cituar. Shih gjithashtu një studim interesant mbi Himarën në revistën "Roma e l'Oriente", Grotteferrata (Roma), viti III, fashikulli 34, f.209 e në vazhdim.
9. Historia e Gjeografisë, nga Malte-Brun, kapitulli 5.
10. I komentari di Theodoro Spandigio Cantaciscino gentiluomo Costantinopolitano, dell'origine de principi Turchi st de costumi di quella natione, Firenze 1551.  
Kjo vepër është botuar edhe në volumnin e parë të "Istoria univesale dell'origine guerre et imperio de Turchi", racolta da Francesco Sansovino, Venetia 1654.
11. Laquale era capo del regno dell'Albania. Edition de Florence, page 25, edit. de venise, geuillet recto.
12. Janina laquale percioche era luogo fortissimo era capo di tutta l'Albania. Edit, de Florence, ph.27, edit de Venise, meme geuillet.

---

13. Ma Amurato il quale era in punto, senza aspettare altro, entro nell'Albania et occupo l'Arta.

14. L'exuesit tanë seriozë janë të lutur t'i hedhin një sy veprave tepër të rëndësishme të Hopf.

15. Shih:Roma e l'Oriente, Grottaferrato, 3 me annee, ph.216.

16. Cf. Boppe, op.cit, ph.76.

17. Në faqen 120 të librit "Vendi i shqiptarëve" nga F.Gibert, Paris 1914, lexojmë:

"Ka një 30 vjet që konsulli grek në Shkodër. Mavromatis. shkruante me të drejtë në gazetën "Akropolis" se emrit Shqipëri munt t'i jepej një sens etnografik:

a). Shqipëria e Jugut, nga kufiri grek në lumin Shkumbin.

b). Shqipëria e Mesme, nga lumi Shkumbin deri në Mat.

c). Shqipëria e Sipërme, nga Mati në Mal të Zi.

d). Shqipëria e Veriut, përfshirë Novi Pazarin, shtrihet drejt Lindjes duke përfshirë Prizrenin, Prishtinën, etj.

e). Maqedonia e Lindjes që nga liqeni i Prespës dhe Ohrit deri në Manastir.

18. Numri i shqiptarëve në Greqi (para luftës ballkanike) ishte të paktën 250.000.

19. Një shqiptar ortodoks, Petro Nini Kolonja, ka publikuar në shqip një vepër të titulluar "Mallkimi i shkronjave shqipe", të shtypur në manastir më 1912, së bashku me faksimilet e dy letrave të peshkopit grek të Kosturit Filaret, të shkruara më 1892 kundër mësimit të gjuhës shqipe. Petro Nini Luarasi vdiq më 1911, i helmuar nga agjentët e Partiarkatit grek në bashkëpunim me një oficer xhonturk.

20. Nuk duhet harruar se qytetërimi grek dhe gjuha e shkruar greke janë më të vjetrat në Ballkan. Shqiptarët, me përjashtim të vllahëve dhe bullgarëve, kanë nisur të mendojnë për arsimin shqip dhe regjimin kombëtar, relativisht vonë.

Ka vetëm 40 vjet që kanë filluar përpjekjet tona për rilindje dhe në këtë punë na është dashur jo vetëm të krijojmë por edhe të rifitojmë atë çka helenizmi na ka marrë padrejtësisht.

21. Ne po flasim vetëm për veprimtaritë e ushtruara në Jug të Shqipërisë.

**Kujtesë e përkthyesit:**

**Të gjitha shënimet në libër janë të vetë autorit Mid'hat Frashëri.**



---

---

# ÇËSHITJA

# E

# EPIRIT

Gjenevë, 1919

## **Martirizimi i një populli**

LEXUESIT

I dashur lexues, në jug të Evropës, në buzë të Adriatikut, ndodhet një vend që quhet Shqipëri. Ajo ka qenë pjesë e Turqisë Evropiane deri më 1912. Gjatë luftës Ballkanike ky vend shpalli pavarësinë nëpërmjet një kongresi kombëtar të mbledhur në Vlorë më 28 nëntor. Konferenca e Ambasadorëve në Londër e konfirmoi këtë

## MID'HAT FRASHËRI

---

pavarësi duke e shpallur Shqipërinë një vend neutral dhe e vendosi atë nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha.

Popullsia e Shqipërisë e kalon pak milionin, por jashtë kufijve të shtetit shqiptar mbetën më shumë se një milion e gjysëm shqiptarë të tjerë, të ndarë ndërmjet grekëve, serbëve dhe malazesëve.

Popullsia një milionëshe që formon mbretërinë e Shqipërisë është e përbërë nga katolikë, ortodoksë dhe muslimanë që nuk kërkojnë gjë tjetër veç të jetojnë në paqe, nën mbretin e tyre evropian me fenë kristiane, të cilës ata e vendosën t'i kushtohen dhe që më në fund Fuqitë e Mëdha do t'ua japin këtë të drejtë një ditë.

Por jeta e shqiptarëve do të jetë fatkeqe në tokat e tyre të zëna prej fqinjëve grekë, serbë e malazesë pasi këta lakmojnë deri edhe pëllëmbën e fundit të kësaj toke shqiptare me etjen për ta parë të zhduket edhe shqiptari i fundit.

Do t'u tregojmë këtu një prej periudhave të kësaj lakmie të këtyre fqinjëve tepër kristianë. Krahinat tona më të pasura dhe më të lulëzuara të Jugut, tani s'janë më veç gërmadha të mbuluar nga hiri. Një popullsi e tërë paqësore, që kërkon veç të jetojë në tokën e të parëve të saj, është shfarosur.

Shqipëria neutrale e nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha, është shqyer e shkatërruar prej Greqisë. Ky krim është i pashembëllt, pasi është pasojë e pabesisë dhe e dredhisë.

Kjo fatkeqësi nuk ishte pasojë e një lufte. Fshatrat tona nuk u shndërruan në hi dhe njerëzit tanë (përfshi

## Çështja e Epirit

---

gra dhe fëmijë) nuk u masakruan gjatë furisë së ndonjë beteje. Këto barabari u kryen me qetësi dhe të peshuara mirë e bukur.

Këto tmerre u injoruan, bile kaluan pa u vënë fare në dukje. Shumë pak persona të së ashtuquajturës botë e qytetëruar, u shqetësuan për këtë. Disa syresh edhe i duartrokitën, duke u përpjekur t'i quanin ato si një veprim civilizues të Greqisë.

Në verën e vitit 1913 Zografos, ministri i Jashtëm i Greqisë, atëhere guvernator i Janinës, gjatë një darke që jepte për shqiptarët e shquar të Janinës dhe të rretheve të tjera, përveç mjaft fjalëve plot butësi evangjelike, la të shqiptoheshin nga goja e tij auguste këto fjalë të një “mirësie” të përjetshme:

“Mos krijoni iluzione: edhe nëse do të jemi të shtrënguar të braktisim Epirin, ne nuk do të lëmë veçse tokën, gjithshka mbi dhe do të rrafshohet” 1).

Meqënëse në fëmijërinë tonë na patën mësuar që çdo grek është në mënyrë të natyrshme gënjeshtar dhe batakçi, ne besonim se edhe në këtë rast bëhej fjalë për një kërcënim të pafuqishëm. Tani Zografos është shfaqur si burrë me karakter dhe i ndershëm. Në zanatin e tij prej batakçiu, ai e mbajti fjalën.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër nuk shënoi asnjë vijë për kufirin jugor të Shqipërisë. Ajo vendosi ta

## MID'HAT FRASHËRI

---

rishohë çështjen në terren nëpërmjet një komision ndërkombëtar, i cili do të caktonte këtë kufi pas një studimi etnografik të rajoneve.

Shumë shpejt, një komision i përbërë nga përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha, shkoi në Korçë dhe përshkoi vendin nëpërmjet këtij qyteti dhe detit duke kaluar nga Kolonja, Përmeti, Leskoviku, Gjirokastra e Delvina. Me të mbaruar punë, ai u kthye në Firence dhe përgatiti një protokoll ku njihte plotësisht karakterin krejtësisht shqiptar të rrethëve e krahinave të vizituara.

Greqia u përpoq me anë të marifeteve të saj meskine dhe të ulta për ta mashtruar komisionin. Grekët ishin brenda rolit të tyre! Në Kolonjë, bie fjala, autoritetet greke sollën me një frymë familje puro greke për t'i vendosur në rajone të tjera me ngut të madh, për të mbushur mendjen e komisionit ndërkombëtar që vendasit janë grekë.

Ç'komedi qesharake!

Një shembull tjetër i hileve greke: në fshatin Qnam të Kolonjës, ku komisioni duhej të kalonte në mbrëmje vonë, autoritetet greke varën një këmbanë në një pemë me qëllim që të krijohej pështypja e pranisë së një kishe ortodokse. Disa fëmijë të vegjël, të sjellë nga larg, duhej të llototnisnin greqisht! Ndërkaq, një prej kafsharëve, bashkëshoqërues i komisionit, ia nxorri bojën kësaj hileje aspak të ndershme dhe fort të trashë të autoriteteve greke 2).

Gjatë gjithë kësaj kohe, rrebeshi i telegrameve dhe peticioneve drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, nuk rreshti për asnjë çast. Qindra mijëra shqiptarë në Rumani, Egjipt, Amerikë, si dhe ata që gjenin prehje në Vlorë, të gjithë

## Çështja e Epirit

---

me origjinë nga provincat e Korçës dhe të Gjirokastrës, pjesa më e madhe e krishtere - kërkonin t'i bashkoheshin Shqipërisë duke protestuar nëpërmjet ndjenjave të tyre shqiptare.

Këto dokumenta janë të regjistruara ashtu siç duhet në regjistrat arkivalë të Konferencës së Ambasadorëve, por shumë pak gazeta pranuan të hapnin kolonat e tyre me to.

Kështu pra, u njoh që Korça dhe Gjirokastra t'i ktheheshin Shqipërisë si më parë. Populli shqiptar manifestoi vullnetin e tij dhe komisioni konstatoi në vend karakterin krejtësisht shqiptar të banorëve. Këtë vijës së kufirit mbeteshin në Shqipëri, në jug të Delvinës, një duzinë fshatrash të përzier me grekë apo shqiptarë të greqizuar. Ndërsa përtej kësaj vije, prej Kepit të Ftelisë deri në Prevezë e Janinë, më shumë se 100 mijë shqiptarë ( një pjesë e madhe e të cilëve në Camëri, rajoni i banuar prej shqiptarëve më të mirë) i mbetën Greqisë.

Kështu, nëse për këtë çështje, kishte ndonjë që duhej të hidhërohej, kjo ishte sigurisht Shqipëria dhe aspak Greqia. Pra Greqisë s'i mbetej gjë tjetër, veç të pranonte si një favor këtë vendim dhe t'i nënshtrohej atij. Në fakt tamam këtë bëri ajo në dukje dhe nëpërmjet notës së saj të datës 21 shkurt 1914, njoftonte Fuqitë e Mëdha se e pranonte vendimin e tyre. Por hesapet duheshin bërë gjithmonë, duke pasur parasysh pabesinë greke. Duhej përdorur dredhia, atje ku metodat e bindjes nuk mund të ndikonin.

Zografos ishte atje dhe ai s'e kishte harruar hiç kërcënimin e bërë. Ne nuk mund ta ndajmë veprimin e Zografos prej atij të qeverisë greke. Edhe nëse Venizellos

## **MID'HAT FRASHËRI**

---

ishte vërtet i sinqertë, s'kish asnjë dyshim që Zografos vepronte në një mendje me klikën ushtarake greke, shef i së cilës ishte mbreti Konstandin. Zografos me kompani kërkonin pra një marifet dhe do ta kopjonin atë nga autonomia jetëshkurtër e Gumuldjinës. Por ndërsa atje komedia kishte një karakter të parrezikshëm, këtu gjërat u shndërruan në tragjizëm dhe komedia e ashtuquajtur epirote la pas një vazhdë të kuqe në analet e kohës.

Masat e nevojshme ndërkaq ishin marrë dhe Zografos nuk i fshihte aspak qëllimet e tij: fjala ishte për të mbajtur Epirin dhe në pamundësi të mos braktisej ky rajon i shqiptarëve pa e masakruar e pa e shkatëruar më parë rrafsh me tokën.

Që në fillim të pushtimit të tyre, grekët ishin përpjekur të formonin disa "legjione të shenja" me vullnetarë shqiptarë, të destinuar për të përkrahur bashkimin e Epirit me Greqinë. Të rinjtë merreshin me forcë, të terrorizuar prej oficerëve dhe nënoficerëve grekë. Zanatçinj dhe dyqanxhinj paqësorë shkuleshin me dhunë nga punët e përditshme të tyre dhe stërviteshin ushtarakisht. Sidoqoftë këto ishin veprime që nuk mund të shkaktonin turbullira.

Por Greqia, e cila e dinte më mirë se kushdo që për ta mbajtur Epirin nuk mund të mbështetej kurrsesi te shqiptarët e vërtetë, veproi në mënyra të tjera.

Në krye ajo iu drejtua dy fuqive mike dhe mbrojtëse, Francës dhe Rusisë prej të cilave fitoi shpejt mbështetjen dhe ndihmën e duhur. Sidoqoftë vetëm politika është e pamjaftueshme për të dhënë rezultat pa u mbështetur nga një forcë materiale dhe meqë kjo forcë nuk mund të rekrutohej

## **Çështja e Epirit**

---

brenda vendit ( cili shqiptar do të kish dëshirë të luftonte për aneksimin e atdheut të tij nga Greqia?!) u përdor pak dinakëri, gjithnjë sipas mënyrës greke. Ushtarë të rregullt grekë, nën komandën e oficerëve të tyre, u maskuan si të ishin vendas, duke u hequr si banda epirote, me fjalë të tjera, si shqiptarë që kërkonin bashkimin me Greqinë dhe që luftonin për këtë bashkim!

Atëhere, me qëllim që të krijohej ideja se rrethet e Epirit ishin zbratur prej grekëve, të njëjtët ushtarë me të njëjtët oficerë në krye, bënë në njëjtën udhë në drejtim të kundërt dhe merrnin rishtaz në zotërim të njëjtat rajone, gjithmonë me po ato armë të tyre: pushkë, municion, mitraloza e të tjera.

Largimi i ushtarëve grekë apo më mirë, gjoja zbrazia e Epirit, filloi nga Korça më 3 mars 1914. Në këtë ditë u mbajt një proces-verbal ndërmjet kolonelit grek Konduli dhe majorit shqiptar Mustafa. Xhandarmëria jonë, e organizuar prej misionit hollandez, mori në zotërim qytetin e Korçës dhe hareja e përgjithshme arriti kulmin sa në këtë krahinë aq edhe në tërë Shqipërinë.

Pritej që ky largim të vazhdonte, shpresohej të shihej që vendi i pastruar nga uzurpatorët të kthehej te mëma për t'u bashkuar me të.

Por a është e mundur vallë t'i zihet besë ndonjëherë fjalës së dhënë prej një greku dhe nderit të tij?

Ja disa fakte që do të shërbejnë për të ilustruar historinë e çështjes së quajtur Epirote dhe që do të mund të hedhin mbi të një farë drite 4).

“Më 19 Mars grekët lajmëruan xhandarët tanë, që të

## MID'HAT FRASHËRI

shkonin për të marrë në dorëzim fshatin Odriçan pranë Frashërit (kazaja e Përmetit). Por në momentin kur tanët u futën në fshat, grekët tradhëtisht hapin zjarr nga kisha: oficeri Qani u plagos, ndërsa 12 burra u vranë.

Natën e 18 Marsit u luftua në Radom, pranë Leskovikut, të cilin grekët e kishin zbratur dhe ia kishin rikthyer xhandarmërisë shqiptare. Ndërkaq po këta grekë kthehen dhe sulmojnë njerëzit tanë por, përball rezistencës së vendosur morën arratinë duke lënë nja tridhjetë të vranë.

Po atë ditë grekët, si hakmarrje për humbjen e paparashikuar të tyre, ekzekutuan shtatë fshatarë, ndër ta edhe një djalë katërmbëdhjetë vjeçar. Këta fshatarë të ngratë ndodheshin në duart e grekëve në Leskovik, si karvanarë të marrë me qera).

Ja pra ndershmëria dhe besnikëria e grekëve!

Ndërsa zyrtarisht e sa për sy e faqe gjoja largoheshin ushtarë grekë nga Epiri, në të vërtetë rrënohej vendi dhe bëhej kërdia. Zografos, Venizellos dhe Lidhja (ose më mirë klika) ushtarake paguhej nga kreu i Fuqive(!). Kështu luhej komedia: grekët luanin rolin e tyre dhe Europa bënte sikur nuk e kuptonte ose më keq akoma, lëshonte klithma admirimi për poshtërsitë e panumërta të tyre.

Tamam të nesërmen e të ashtuquajturit largim të ushtarëve grekë prej Korçës, disa korrespondentë gazetash përhapnin zëra për ripushtimin e qytetit prej grekëve. Megjithëse kthimi i këtij kryevendi u krye në formën e duhur, ishte shumë e vështirë të merrej me mend goditja e projektuar nga fqinjët tanë të jugut. Në të njëjtën kohë në Shqipëri thuhej, dhe kjo besohej sinqerisht, që Greqia nuk do të guxonte kurrë



## Çështja e Epirit

ta bënte një të tillë pabesi tamam nën hundën e gjashtë Fuqive nënshkruese të traktatit të Londrës, të cilat në mungesë të ndonjë ndjenje tjetër duhet të kishin të paktën një çikë sedër.

Ndërkaq ja se çfarë ndodhi:

Grekët, duke braktisur Korçën, kishin lënë në qytet një tridhjetë të sëmure me dy mjekë, një oficer dhe disa ushtarë që duhej të rrinin tek koka e të sëmureve. Kjo ishte një vatër e vogël infeksioni, që gabimisht u tolerua, pasi disa andartë grekë u futën tinëz në qytet dhe netët e 3 e 4 prillit u tentua kryerja e një aksioni, i cili dështoi menjëherë përpara rezistencës së banorëve vendas. Kur besohej se rreziku kishte kaluar, më datën pesë të po atij muaji u mësua mbërritja e një bande të armatosur fare pranë Korçës. Këtu u zhvillua një luftim i vërtetë prej të cilit agresorët morën arratinë duke shpëtuar kokën drejt viseve të Jugut.

Cfarë kishte ndodhur?

Zografos dhe klika ushtarake përgjonin kryerjen e aksionit të armatosur në Korçë të përgatitur prej grekëve nën patronazhin e peshkopit grek të qytetit, një fanatik sektar, andart siç ishin të gjithë priftërinjtë e sjellë prej Patriarkanës Ekumenike të Konstadinopolit, një kolerë e vërtetë për besimtarët ortodoksë shqiptarë, të cilëve ata mendonin t'i udhëhiqnin shpirtrat. Meqënëse aksioni i armatosur në Korçë dështoi, qeveria helenike e mori vetë çështjen në dorë duke shpresuar se shpata do të ish më e fuqishme dhe më e vlefshme se kryqi.

Treqind e pesëdhjetë ushtarë u nisën nga Kosturi (qytet në Jug të Korçës, një territor shqiptar i aneksuar nga

## MID'HAT FRASHËRI

---

Greqia), të komanduar nga oficerë të ushtrisë aktive të madhërisë së saj helenike: Mavraza, Laza, Benapoli, Asterio, Ilija Papageorgiu. Shtojini këtyre pesë oficerëve edhe një personazh me një fizik të mbrapsht, një lloj Kuazimodo të quajtur Bussios, ish deputet grek i Serfixhes në parlamentin otoman dhe do ta keni para syve të gjithë ngjarjen e nevojshme. Ushtarë e oficerë, përpara se të merrnin udhën e agresionit, do të merrnin bekimin e peshkopit grek të Kosturit 5).

Gjatë këtyre operacioneve grekët nuk nguruan të kryenin qindra mizori: i vunë flakën shumë fshatrave, i therën dhe i dogjën të gjallë banorët paqësorë e të pafajshëm -përfshi edhe gra e fëmijë. Fshatarë të tjerë i larguan me forcë për të krijuar idenë e rreme të një eksodi ndaj qeverisë shqiptare, të gjitha këto me synimin e vetëm për të shkretuar vendin dhe për të mbjellë skamjen.

Ndërmjet krimeve të shumta të tyre mund të përmendim vrasjen e një prifti vllah: Papa Harallambi i Korçës, i therur me gjak të ftohtë së bashku me të vëllanë dhe kushëririn e vet. Ky krim i kryer ndaj një personaliteti të shenjtë, ngjalli indinjatë dhe zemërim të madh.

Dhe ndërsa këto krime e tmerre kryheshin në Korçë - në një mënyrë krejt të ulët e të pandershme - gazetatat greke ngazëllonin! Ato nuk gjenin dot shprehje për të lajkatur këtë vepër makabre, për të admiruar sakrificën dhe "patriotizmin" grek! "Lë Temps" njoftonte më 5 Prill që Korça ndodhej në duart e grekëve! E njëjta gazetë, pas disa ditësh, në numrin e saj të 13 Prillit thoshtë ndër të tjera kështu:

"... gjatë një përlëshjeje të vogël, at Balamaci është

## Çështja e Epirit

---

vrarë pasi është keqtrajtuar rëndë...”

E vini re cinizmin?! Vrasja e poshtër e një prifti të nxjerrë me dhunë nga shtëpia, cilësohej thjesht si një keqtrajtim...

Po akoma më e fëlliqur ishte zhurma që përhapnin grekët për të mbuluar poshtërsitë e tyre. Po binin të gjitha këmbanat: pa skrupuj e pa turp grekët çirreshin për kapjen gjoja të vrasësve kur furisë së tyre shkatërruese nuk i shpëtonte asgjë. Nuk mund të mos qeshësh kur lexon gazetet greke të vitit të kaluar! Në numrin 10 Prill 1914 te “Lë Temps” lexojmë këtë telegram:

“Athinë, data 9. Xhandarmëria shqiptare pasi çarmatosi paraprakisht popullsinë e Korçës, nisi masakra të përgjithshme. Qeveria greke i bëri të njohura faktet e saj...”

Kjo është e gjitha!. Po të dëgjosh grekët del se janë autoritetet shqiptare ata që masakruan të krishterët! Por ajo që na çudit në telegramin e mësipërm është ky turp që ne po e vëmë në dukje më poshtë: duke folur për banorët e Korçës për ta thuhet thjesht “të krishterë”, ose kudo gjetkë dhe përherë grekët përdorin shprehjen “grekë” për të krishterët ortodoksë të Shqipërisë.

Tamam këtu qëndron çmenduria e pakorigjueshme e fqinjëve tanë të dashur të Jugut! Për ata kushdo që është ortodoks është domosdo grek; është e pamundur për një grek të bëjë dallimin ndërmjet kishës ose fesë dhe racës nga ana tjetër. Në këtë mënyrë shqiptarët ortodoksë janë marrë për grekë ashtu siç janë quajtur si të tillë bullgarët, vllahët apo serbët deri në ditët tona 6).

## MID'HAT FRASHËRI

---

Përsa u përket grekëve, siç e kemi thënë edhe më lart, ashtu siç e kanë përcaktuar edhe konferencat e Londrës dhe të Firences, nuk ka syresh në të gjithë Shqipërinë përveç nja dhjetë fshatrave të përzier në jug të Delvinës. Nuk gjendet asgjëkund tjetër qoftë edhe një grek i vetëm. I mëshojmë termit I VETËM dhe e nënvizojmë atë sepse grekët, për të cilët janë të huaja të gjitha ndjenjat e ndershmërisë e të turpfit, nuk kanë rreshtur kurrë së bëri të mundurën e të pamundurën për të mashtruar opinionin publik botëror.

Në të kundërt gjenden më shumë se 100 mijë shqiptarë në rajonet që shtrihen në jug të Kepit të Ftelias (kufiri jugor i Shqipërisë) në Prevezë dhe në Artë.

Të kthehemi në çështjen e Korçës.

Fatkeqësisht e keqja nuk është lokalizuar vetëm në rrethinat e Korçës; murtaja greke shtrihej përgjatë gjithë frontit të kufijve jugorë nga Bilishti në detin Adriatik, duke kaluar nga Leskoviku, Përmeti, Tepelena, Himara... Xhandarmëria shqiptare, nën komandën e oficerëve hollandezë, kish shkuar të merrte në dorëzim krahinat që grekët duhet të zbraznin sipas notës së datës së 21 Shkurtit nëpërmjet së cilës Greqia deklaronte se i nënshtrohej vendimeve të Fuqive të Mëdha për kufijtë e Shqipërisë.

Por në vend të marrjes thjesht në dorëzim, xhandarëve tanë ju duhej të hynin në luftime të vërteta kundër ushtarëve grekë të maskuar ku më pak e ku më shumë (si andartë).

Ne nuk kemi më as më të voglin dyshim për natyrën e vërtetë të këtyre të ashtuquajtur andartë. Ka dëshmi të shumta të cilat vërtetojnë që këta epirotë s'ishin gjë tjetër veçse ushtarë grekë ose vullnetarë. Raporti i gjatë i shefit të

## Çështja e Epirit

misionit hollandez në Shqipëri që po e publikojmë në fund të këtij libërthi, është një provë më shumë për çka parashtruam më sipër. Tani kam para syve dëshmitë e gjashtë grekëve të kapur me armë në duar në Korçë më 6 Prill 1914. Të gjithë këta “trima” pohuan se ishin ushtarë grekë duke dhënë saktësisht edhe numrin e kompanisë dhe të batalionit të tyre 7).

Autori i këtyre radhëve u ndodh më 28 Prill (9 Maj) 1914 në Kolonjë, në jugperëndim të Korçës, me majorin hollandez Verhulst në një takim që duhej të zhvillohej ndërmjet nesh dhe disa oficerëve epirotë. Unë pashë tri oficerë grekë, ku më i madhi ishte me gradën e kapitenit dhe quhej Cipuro. Ata mbanin të gjithë uniformën greke, kasketën ushtarake dhe... kurorën mbi kasketë. Jashtë rregullit, ndërmjet këtyre oficerëve trimoshë, ndodhej një farë Stefo, që hiqej si shqiptar por që ne e njohëm pa mundim që ishte një grek apo më mirë një vllah i greqizuar prej rajonit të Gramozit, nga fshati Liskateh, i cili ndodhet në territorin shqiptar të aneksuar nga Greqia.

Për askënd nuk ishte më mister. Greqia i pranonte me vullnet mjaft të keq vendimet e Fuqive të Mëdha, apo më mirë të themi, nuk i pranonte fare ato. Ndërkaq rezistenca e saj u bë akoma më e thjeshtë pasi Fuqitë e Mëdha nuk ishin hiç të prirura për të mbrojtur vendimet që ato vetë i kishin marrë në Londër.

Greqia e shtynte gjithmonë për më vonë datën e largimit të trupave greke prej Epirit, ndërkohë që Venizellos u bënte vizitë qeverive të Europës. U tha që ky largim prej Shqipërie do të fillonte më 18 Dhjetor 1913, pastaj më 18

## MID'HAT FRASHËRI

---

Janar, më tej akoma më 18 Shkurt dhe më në fund kjo histori filloi më 3 mars 1914 prej qytetit të Korçës.

Përballë vullnetit të keq të Greqisë, Shqipëria ishte tepër e dobët dhe aspak në gjendje për të vendosur drejtësinë me forcat e saj. Kështu që ajo vendosi për ta kthyer çështjen në duart e fuqive nënshkruese të konferencës së Londrës.

Pra siç e patëm vënë në dukje, vullneti i të mëdhenjve nuk ishte aspak aq i mirë sa ç'dëshëruam e shpresuam ne. Venizellos kish arritur të merrte disa premtime gjatë turneut të tij dhe ai shpresonte të mbante jugun e Shqipërisë. Sidoqoftë, duhej bërë çmos për të mos dalë në shesh të palarat, meqë vetë Fuqitë e Mëdha donin të linin pështypjen që e mbanin fjalën e dhënë sipas firmës së vënë ku boja ishte ende e freskët. Me një fjalë, duheshin lënë të dy palët e interesuara ta sqaronin problemin ndërmjet tyre; pra të vihej përballë Shqipëria e vogël e sapolindur me Greqinë pesë herë më të madhe dhe me një pavarësi gati shekullore.

E kjo Greqi, duke mos dashur të kompromentojë përkrahësit e saj, shpiku komedinë epirote, u përpoq të bëjë sa të jetë e mundur të besueshme, rezistencën e armatosur nga brenda vendit kundër bashkimit me Shqipërinë! Për ta realizuar këtë projekt, Zografos, ky tradhëtar (8) i shërbente si marionetë, me qejf të madh klikës ushtarake. Ushtarë, oficerë, municione, armë dhe para u vunë në dispozicion të tij. Një bandë e madhe keqbërësish dhe kriminelësh si dhe mjaft ish burgaxhinj të sprovuar nga e gjithë Greqia, u çuan për të shtuar radhët e rekrutëve për legjionet, të cilët me kulmin e paturpësisë quheshin të SHENJTË!

E gjithë kjo masë që thamë, u cilësua si epirote: grekë,

## Çështja e Epirit

---

andartë, kaçakë të Korfuzit e të Zantës, që të gjithë u vetëquajtën vendalinj, pra shqiptarë të Epirit!

Dhe përballë kësaj paturpësie të qartë, ne lexojmë radhët e mëposhtme të “Lë Temps” të datës 26 Prill 1914 9).

“Qeveria greke ka siguruar se do të përpiqet gjithmonë për të mos penguar veprimtarinë e qeverisë shqiptare dhe ajo e përgënjeshton kategorikisht thënien se qindra ushtarë të rregullt grekë i janë bashkëngjitur lëvizjes kryengritëse”.

Risum Teneatis? (10).

Këta epirotë (prej Krete), këto legjione të shenjta (prej Belzebuth), këta Zografistë ( siç thirren ata shkurt) ishin ngarkuar me detyrën për ta plaçkitur vendin, për të rrafshuar çdo gjë mbi dhe, tamam sipas fjalës evangjelike të të damkosurit në fjalë.

Përveç kësaj, ky gjoja largim i trupave u krye pjesërisht, pasi ushtarët grekë në vend që të merrnin mundimin e të riktheshin duke u hequr si epirotë, nuk u larguan fare nga skaji jugor i Epirit.

Krimet dhe dëmet e bandave zografiste janë të panumërt. Mund të thuhet pa e tepruar që i gjithë Jugu i Shqipërisë u rrënuar, dy provincat e bukura të Korçës dhe Gjirokastrës përfshirë këtu edhe Bilishtin, Kolonjën, Leskovikun, Përmetin, Frashërin, Skraparin, Oparin, Tepelenën, Kurveleshin- u shkretuan; të paktën 250 fshatra të djegur, disa mijëra njerëz përfshi gra dhe fëmijë u masakruan barbarisht, 100 mijë njerëz u detyruan të emigrojnë me pahir (pjesa më e madhe e të cilëve, vdiqën

## MID'HAT FRASHËRI

---

nga uria në Vlorë).

Në "Lë Temps" të numërit 10 ne gjejmë një pohim grek mbi krimet që ata kryen. Grekët pranojnë dhe pohojnë me gojën e tyre se ata djëgin fshatra gjatë tërheqjes dhe që pararoja e përbërë nga kretas vret gjithkënd për të mos lënë shqiptar të gjallë.

Përball këtyre krimeve të qeverisë greke, as që mund të imagjinohej që xhandarmëria jonë dhe vullnetarët tanë qëndronin me duart në gjoks. Një vijë më e gjatë se njëqind e pesëdhjetë kilometra mbrohej ushtarakisht.

Çdo metër katror tokë duhej mbrojtur nga ushtria greke. Zyrtarisht thuhej se Zografosi kishte dhjetë mijë deri në gjashtëmbëdhjetë mijë njerëz (shih "Lë Temps" të datës 9 Prill 1914). Ne kishim vetëm 3000 xhandarë dhe disa mijëra vullnetarë të rekrutuar me nxitim dhe të armatosur e pajisur keq. Në fillim ne nuk kishim asnjë top dhe kur i patëm Cështja e Epirit kishte përfunduar në katastrofë.

Pavarësisht numërit të vogël, ushtarët tanë luftuan me trimëri dhe zmbropsën mëse një herë legjionet "e shenjta"(!).

Më 2 Maj ata ishin fare pranë Gjirokastrës në manastirin e Cepos, dy orë larg nga qyteti dhe katër orë larg nga Delvina. Zografistët ia kishin mbathur para një grushti shqiptarësh, kishin braktisur me nxitim Delvinën, vendndodhjen e tyre kryesore, dhe ishin tërhequr përtej kufirit ndërmjet të ashtuquajturës Republikë Epirote dhe Greqisë së vërtetë: urës Arinistra. Por sapo arritën atje patën një përforsim të madh me ushtarë të rregullt (11) grekë, u kthyen të nesërmen dhe i detyruan ushtarët tanë të braktisnin pozicionet e tyre.



## Çështja e Epirit

---

Më 7 Maj një sulm i fuqishëm grek u spraps me sukses nga ushtarët tanë në Nikolic dhe Arza (në juglindje të Korçës) duke iu shkaktuar grekëve humbje të mëdha.

Për sakrificat dhe dhimbjet tona ne lexojmë në "Lë Temps" të datës 7 Maj një telegram të ardhur nga Athina, dt.6 Maj, me një cinizëm të vërtetë grek:

"Trupat epirote, në vijim të luftimeve të fundit, kishin gjetur shumë kufoma oficerësh italianë e bullgarë..."

Përveç të tjerave ishte kënga e përhershme e shtypit grek dhe asaj që i bëhej jehonë falas: nxitja e përhershme për të gjetur një gisht të huaj në përpjekjet shqiptare duke mohuar pa turp e pa skrupuj se këto luftime ishin spontane, të paorganizuara. Duhej patjetër të gjendeshin intriga austriake ose oficerë italianë a bullgarë! Po shtypi i Beogradit a nuk ishte atje për të bërë korin e shpesh për të luajtur rolin e maestros?

Sulmet nga ana e grekëve vazhdonin pa pushuar asnjë ditë e nga të gjitha anët. Ajo që vlen të mos harrohet në këtë luftë, ishte inferioriteti i shqiptarëve të armatosur keq, pa municionin e duhur e pa artilieri, përball një kundërshtari tepër të madh si në numër ashtu edhe në armatim. Burimet e grekëve ishin të pashtershëm, ushtria e mbretit Kostandin ishte atje me batalionet dhe oficerët e saj. Aventurierët dhe kriminelët andartë ishin gjithnjë gati për të bërë "punë patriotike" përmes vrasjeve dhe plaçkitjeve të panumërta.

Në Shqipëri kishin akoma iluzione dhe shpresohej se Fuqitë e Mëdha që kishin firmosur në konferencën e Londrës, do të detyronin Greqinë dhe trupat ushtarake të

## MID'HAT FRASHËRI

---

saj që të respektonin vendimet e marra atje si dhe zotimet e saj publike.

Por, a nuk kishin këto Fuqi nga një përfaqësues në Shqipëri, në përbërje të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe a nuk ish deklaruar kjo Shqipëri neutrale dhe nën garancinë e Fuqive në konferencën e Ambasadorëve në Londër?

Populli i pezmatuar, i dërgonte si rrebesh telegrame pas telegramesh dhe peticione pas peticioneesh Komisionit të Kontrollit me seli në Durrës si dhe mjaft kancelarive perëndimore. Disa prej këtyre telegrameve dhe peticioneve ishin hartuar me një ton vërtet të dëshpëruar. Efekti i tyre ishte mbajtja e një interpelance nga ana e deputetit, Mr. Aubrey Herbert në parlamentin anglez (Prill). Ministri i Jashtëm i Greqisë në Londër, mohoi gjithshka! A nuk është tipik të gënjerit dhe ndjenja mohuese për gjithë grekët deri te zyrtarët e lartë!

Si përgjigje deputeti i parlamentit anglez Mr. Aubrey Herbert publikoi një raport të hollësishëm e të detajuar i sapoardhur nga Korça ku bëhej fjalë për tmerret greke në këto zona.

Të deleguarit e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, secili veç e veç, njohën pandershmërinë greke duke pranuar padrejtësinë dhe qëndrimin e gabuar që ish mbajtur ndaj Shqipërisë. Por bashkërisht ata qenë të paafte për çdo iniciativë apo për çdo veprim.

Përse?

Sepse Venizellosi kish bërë një udhëtim nëpër Europë, kishte bërë vizita të gjata në kancelaritë e saj. Ndër të tjera

## Çështja e Epirit

---

ishite edhe çështja e 12 ishujve që i ishte bashkuar asaj të Shqipërisë Jugore. Ishte paskëtaj edhe rivaliteti foshnjërak dhe qesharak i dy Fuqive që ishin më drejtpërdrejt të interesuara për çështjen shqiptare: Italia dhe Austria.

Ndërkohë qeveria shqiptare që e shtrënguar të niste tratativat me pseudoqeverinë e Epirit, me shefin e saj të damkosurin Zografos. Fillimisht ishte koloneli hollandez Tomson që shkoi në Korfuz për të dëgjuar kërkesat e atyre të ashtuquajturve epirotë; por duke kuptuar shpejt farsën që donin të luanin grekët, këto tratativa e përpjekje u ndërprejnë.

Gjatë kësaj kohe ndodhej në Durrës një farë Varatassi, një kuçovllah nga Konica, ish-gubernator i Korfuzit dhe i dërguar special nga qeveria helenike si një ministër i ardhshëm i Greqisë në Shqipëri. Ishte një burrë i vogël, me pamje rakitike dhe tepër të zymtë. Ai kish përparësinë e madhe për t'i pëlqyer Esad Toptanit. (Atij, duke u kujtuar vetëm për keq, i detyrohen një pjesë të fatkeqësive tona).

Ky Varatassi bëri disa propozime, duke dashur të shërbente si ndërmjetës, dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit shkoi i plotë në Korfuz për të diskutuar me po atë Zografos (8 Maj 1914). Greqia dukej sikur donte të binte në ujdi. Zografos, që dy javë më pas, u zgjodh deputet i Atikës, nuk kërkonte gjë tjetër veç disa konçensioneve për grekët e Epirit: njohjen e të drejtave të tyre për të patur shkollë greke dhe privilegjet religjioze të kishës ortodokse greke. Në fakt bëhej fjalë për t'i njohur Greqisë të drejtën e ndërhyrjes në punët e brendshme të Shqipërisë.

Por për cilët Greqia, nëpërmjet Zografos, i kërkonte

## MID'HAT FRASHËRI

---

këto privilegje? Kush ishin këta grekë të Epirit?

Ne këtë tashmë e kemi thënë dhe nuk dimë të themi më tepër se kaq: nuk ka as edhe një grek të vetëm brenda kufijve të Shqipërisë; ashtu siç u vendosën këta kufij prej Fuqive të Mëdha në Konferencën e Firences. Ata që Greqia i quan grekë, s'ishin gjë tjetër veçse shqiptarë të krishterë të rritit ortodoks.

Pikërisht ishin këta ortodoksë më të alarmuar prej dredhivë të parreshtura greke dhe ishin po këta që kërkonin më me ngulm të drejtat e tyre kombëtare. Atyre u pati ardhur në majë të hundës trajtimi i tyre si ROUM (domethënë si grekë) prej Turqisë e cila me kryeneçësi i kishte renditur gjithmonë njerëzit sipas kishës pa dashur (dhe pa dyshim pa mundur) të dëgjonte aspak për kombësinë e tyre, për karakterin e tyre etnik.

Kur këta ortodoksë morën vesh për bisedimet ndërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe Zografos në Korfuz, një ortek telegramesh e peticionesh proteste mësynë në Durrës. Ne do t'ju njohim me disa prej tyre më poshtë.

Por Greqia dhe Zografos, të paktën, a ishin të sinqertë, a ishin të ndershëm në qëllimet e tyre?

Mendoj se nuk është e nevojshme të përgjigjesh. Gjithë sa kemi thënë deri tani, është një provë shumë e qartë e qëllimeve të vërteta të fqinjëve tanë "të këndshëm" të Jugut që synonin veç të sorrollateshin dhe të fitonin kohë për të përfunduar ndërmarrjen e tyre kriminale.

Ndër të tjera ata kishin dhënë më shumë se një herë prova të pabesisë. Disa herë ata kishin prishur armëpushimin

## **Çështja e Epirit**

---

e fiksuar gjatë tratativave të Korfuzit. Dhe më në fund, pa pritur që këto dispozita ( siç i quanin ata) të merrnin një formë përfundimtare, duke përfituar edhe prej vështirësive të brendshme të krijuara nga trazirat tona rreth Durrësit, e kaluan edhe një herë vijën tokësore të përkohshme të vendosur prej armëpushimit dhe u turrën, shumë superiorë në numër në Korçë, në të njëjtën kohë që kryen një sulm të menjëhershëm në të gjitha frontet.

E tillë është çështje e Epirit:

Rezultati: dy prej krahinave të bukura shqiptare, Korça dhe Gjirokastra -të shkretuara; më shumë se 250 fshatra të djegur, me dhjetra e dhjetra të tjerë të rrënuar e të plaçkitur. Disa mijëra njerëz të vdekur në luftime ose të vrarë poshtërsisht, përfshirë në ta gra edhe fëmijë, 100 mijë njerëz të mbetur pa strehë.

Ja disa prej telegrameve të dërguara nga Korça gjatë kohës që kjo provincë luftonte kundër sulmeve dhe intrigave të grekëve:

### **“Madhërisë së Tij Mbretit të Shqiptarëve,**

Ne të nënshkruarit në cilësinë tonë të përfaqësuesve të shqiptarëve ortodoksë të Korçës, kemi nderin t’i parashtrijmë Madhërisë Suaj, që sapo mësuam prej gazetave të huaja se Greqia, nën preteksin e kishave dhe shkollave tona, ka pretendimin për t’u përzier në çështjet e brendshme të Shqipërisë.

Por, nëse ky lajm është i vërtetë, ne, si qytetarë të Shqipërisë dhe si shtetas të Madhërisë Suaj, deklarojmë se e kemi parasysh t’i kërkojmë qeverisë sonë të na plotësojë

## MID'HAT FRASHËRI

---

nevojat që mund të kemi, por kurrë nuk ia lejojmë një personi të tretë, që të ketë të drejtën të ndërhyjë në çështjet që çenojnë pavarësinë morale dhe politike të mbarë kombit tonë dhe veçanërisht të bashkësisë sonë ortodokse.

**Shërbëtorët shumë të bindur e të përrulur të Madhërisë Suaj.**

**Më 5 Maj 1914".**

(Vazhdojnë firmat e famulltarit të peshkopatës ortodokse dhe të qytetarëve të shquar të kësaj bashkësie).

**“Shkëlqesisë së Tij, Ministrit të Punëve të Jashtme, Londër, Paris, Berlin, Vjenë, Romë, Petersburg.**

Ne po ju lutemi të hidhni një vështrim, në emër të zemërmirësisë, mbi fatin e hidhur të popullatës së krishterë të Korçës dhe të Kolonjës.

Me cilësinë e të qenit Shqiptarë, jemi dhe do të jemi gjithmonë të lumtur të mbetemi shqiptarë. Përkundër kësaj, grekët, nën preteksin qesharak të mbrojtjes së interesave tona, por në të vërtetë për të luajtur intrigat e tyre, kryejnë inkursione në rajonet tona, rrënojnë vendin, i marrin me vete me forcë vëllezërit tanë në tërheqje e sipër, duke patur si qëllim të vetëm të shkatërrojnë Shqipërinë dhe të krijojnë idenë, në botën e qytetëruar, të egzistencës së mosmarrëveshjeve ndërmjet të krishterëve dhe qeverisë shqiptare.

Greqia harron që e mira më e madhe, që ajo mund të na bëjë është të na lërë të qetë, gjë për të cilën ju lutemi të përdorni të gjithë ndikimin Tuaj.

**Në emër të banorëve të krishterë të rajoneve të**

## **Çështja e Epirit**

---

**Korçës dhe të Kolonjës.**

**Më 7 Maj 1914".**

(Vazhdojnë firmat e qytetarëve të shquar ortodoksë të Korçës dhe të Kolonjës).

**"Madhërisë së Tij Mbretit të Shqiptarëve,**

Ne sapo mësuam që disa anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit janë kthyer nga Korfuzi dhe po shqyrtojnë propozimet e Zografos, që u fryjnë zjarreve në Shqipërinë e Jugut.

Ato janë mjaft të dëmshme për gjithë atdheun dhe të një natyre që vënë në rrezik të ardhmen e tij. Guxojmë sërish t'i parashtrojmë Madhërisë Suaj, që ne banorët e rajonit të Korçës, që gjithmonë kemi luftuar dhe po luftojmë për çështjen kombëtare, konsiderojmë, që detyra jonë ndaj Madhërisë Suaj dhe ndaj Atdheut na urdhëron, që më mirë të vdesim se sa të pranojmë copëtimin e atdheut shqipëtar.

Gjithashtu kemi bindjen e plotë, që këto të quajtura kërkesa nuk do të hidhen poshtë nga Madhëria Juaj. Ju sigurojmë se ne do të jemi në gjendje të mbrojmë vetë nderin, prestigjin dhe tërësinë e atdheut pikërisht me forcat tona, mjaft që të na mbërrijnë topat, që po i presim prej kaq shumë kohe.

**Më 20 Maj 1914".**

(Vazhdojnë firmat).

\*  
\*            \*  
\*            \*

## MID'HAT FRASHËRI

---

Këto që sapo thamë më sipër janë një përshkrim në vija të trasha i veprimit të grekëve kryesisht në qytetin dhe rrethinat e Korçës. Por të këqijat e fqinjëve tonë të pabesë janë ushtruar rregullisht në të gjitha rajonet e dy trevave të Korçës dhe të Gjirokastrës (Epiri sipas grekëve) domethënë nga bregdeti i Adriatikut deri në brigjet e liqenit të Ohrit.

Milëfi dhe tërbimi i tyre nuk kurseu asgjëkafshë. as banorët, as shtëpitë, as gjënë e gjallë, as të korrat. Në shumë fshatra njerëzit u dogjën të gjallë, si në Gratza ( në juglindje të Korçës) ku më 5 Prill 1914 gjashtë burra dhe tri gra u shkrumbuan të gjallë, si dhe katër burra dhe katër gra nga Starja (Kolonjë, në jugperëndim të Korçës) më datën 30 të po atij muaji.

Gjetkë, siç ndodhi në Kodër, grekët ( ushtarë dhe oficerë të mbretit Kostantin të Greqisë) nisën një varg masakrash.

Do të na duhej të krijojmë një volum të tërë për të treguar me imtësi krimet e grekëve. Ne po mjaftohemi të riprodhojmë këtu dy dokumente:

I pari është një raport i hartuar prej gjeneralit Dever, shef i Misionit hollandez për riorganizimin e xhandarmërisë në Shqipëri, ndërsa i dyti përmban një listë të 144 fshatrave të djegur prej grekëve, me numrin e shtëpive dhe atë të banorëve të tyre.

Kjo listë fshttrash është mjaft e mangët. Ne po e riprodhojmë atë ashtu siç e gjejmë në gazetën italiane "Corriere delle Puglie" e datës 14-15 Dhjetor 1914 ku ajo është publikuar mbasi i qe dorëzuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë dhe përfaqësuesve përgjegjës të pesë Fuqive



të tjera të Mëdha.

Siç e kemi thënë gjetkë, numri i përgjithshëm i fshatrave që vuajtën urrejtjen “e devotshme” të neo-helenëve arrin të paktën në 250 dhe në listën e mëposhtme nuk janë paraqitur fare krahina e zona të tëra si Gora, Devolli, fusha e Korçës etj.

Nga frika e pamundësisë për të qenë plotësisht të saktë, ne iu shmangëm hartimit të një liste dhe u mjaftuam me këtë këtu megjithëse nuk mund të jetë e plotë.

Në po atë numër të së njëjtës gazetë italiane ne lexojmë që 48 teqe ( kuvende fetare të sektit të bektashinjve) kanë pësuar po ashtu tërbimin e grekëve “shenjtorë”

Në vijim të sulmeve dhe të mizorive të panumërta greke në Shqipërinë jugore, pothuajse e gjithë popullsia u shtrëngua të merrte arratinë dhe të kërkonte strehë në anët e Beratit dhe të Vlorës. Sidomos ky qytet i fundit u ngarkua mjaft nga një numër shumë i madh emigrantësh.

Pak pasi Italia pushtoi këtë port dhe ndërpreu qarkullimin, si nga brenda vendit ashtu edhe nga jashtë nëpërmjet rrugëve detare, uria nuk vonoi të bënte lemerishëm kërdrinë. Mbi 30 mijë prej këtyre fatkeqëve që kishin ikur nga kthetrat vrasësve zografistë, gjetën vdekjen në Vlorë.

Falë të krishterëve “zemërmëdhenj” të Greqisë dhe të larove të tyre kretas, prej njëmbëdhjetë krahinave të begata e të lulëzuara ( Gora, Devolli, Korça, Kolonja, Leskoviku, Përmeti, Frashëri, Skrapari, Tepelena, Kurveleshi dhe Gjirokastra), nuk mbeti gjë tjetër veç një pirgu rrënojash.

### RAPORT LIDHUR ME MASAKRAT

kryer në fshatin Kodër më 29 Prill 1914

Më 12 maj, duke qenë në Tepelenë, nënshkruesi mori atje prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, telegramin e mëposhtëm:

“C.I.C (12). me pëlqimin edhe të përfaqësuesit të Epirit, vendosi të hapë një hetim mbi masakrat e Hormovës dhe të Kodrës, me qëllim që të përcaktojë përgjegjësinë dhe të kërkojë fajtorët. Sigurisht që Komisioni hetimor do të jetë një komision i përzier. C.I.C ju lutet pra, që të dërgoni një oficer hollandez në Hormovë për tu marrë vesh me oficerin epirot, të cilit i janë dërguar udhëzime të ngjashme”.

**Korfuz, 11 Maj 1914.**

**Presidenti**

**Mehdi Frashëri**

#### **Gjenerali Dever:**

Në përputhje me këtë telegram unë caktova si anëtar të këtij komisioni kapitenin C. de Longh në Tepelenë, njoftova komandantin e postës së Shtëpëzimit (Labovë), si edhe majorin e ushtrisë hollandeze H. de Vaal në këtë fshat që një oficer epirot do të paraqitej në vijat e përparuara si anëtar i Komisionit të sipërpërmendur.

Njëkohësisht dhashë urdhër që ky oficer të përcillej menjëherë në Tepelenë.

Këtu duhet vënë në dukje se është folur gjithmonë gabimisht për masakrat e kryera në Hormovë dhe në Kodër. Masakrat për të cilat bëhet fjalë, janë kryer vetëm në Kodër,

## Çështja e Epirit

---

---

por pjesa më e madhe e viktimave ishin banorë të fshatit Hormovë të shpënë dhunshëm në Kodër prej andartëve grekë.

Më datën 13 Maj unë mora prej majorit hollandez de Vaal një telegram në të cilin ai më thoshte :

“Deri dje në mbrëmje ministri i luftës i republikës epirote nuk kishte marrë akoma urdhër nga Zografos për të caktuar një oficer epirot si anëtar të komisionit hetimor”.

Në mëngjesin e 14 Majit, ai më njoftone që oficeri epirot nuk ishte paraqitur ende. .

Duke parë rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, unë ia komunikova menjëherë këtë informacion Komisionit Ndërkombëtar të Hetimit duke i njoftuar që tashmë do të nisja hetimin edhe pa praninë e një oficeri epirot.

Isha i mendimit që një hetim i tillë nuk duhej shtyrë, pasi vështirësitë për një kërkim të paanshëm, të drejtë dhe të thelluar, do të shtoheshin nga dita në ditë, duke patur parasysh kalbëzimin e përditshëm të kufomave.

Për këtë unë mora si anëtarë të Komisionit të Hetimit:

**Mjekun major : Dr. F.H. de Groot.**

**Kapitenin hollandez : C. de Iongh.**

**Togerin shqiptar : Meleq bej Frashëri.**

Po atë ditë, më 15 Maj, ky komision hetimor e filloi punën e tij duke dëgjuar si dëshmitarë prefektin e Tepelenës dhe disa prej atyre të shumtëve që morën arratinë nga Hormova e nga Kodra, shumica gra që vajtonin kush babanë, kush burrin apo djalin.

Një ditë më pas, më datën 16 Maj, komisioni hetimor

## MID'HAT FRASHËRI

---

vizitoi pikërisht vendin e kasaphanës:

### DËSHMITË

#### 1. Fahri bej Frashëri, prefekt i Tepelenës:

Më 25 Prill Tepelena u zbraz nga grekët dhe më 26 Prill xhandarët e zunë këtë qytet. Po atë ditë andartët e sulmuan vendin, por pa sukses. Sipas deklaratave të dy të krishterëve: Kote Peçi dhe Dhame Kolë Pestani, midis andartëve gjendeshin 300 ushtarë grekë së bashku me oficerët : Saghilari (oficer i mitralierëve), Klemati dhe një nënoficer i quajtur Stathi.

Pas sulmit, brenda asaj dite, këta andartë zaptuan Kodrën, prej nga qëlluan me një top e me mitraloza mbi tepelenë.

Më 19 Prill po ky Saghilari duhet të ketë shkuar në Hormovë me ushtarët grekë. Aty ai mori 40 banorë, të cilët i dërgoi si robër në Kodër. Mjaft nga të ikurit në Tepelenë për këtë njeri kanë dhënë një përshkrim të ngjashëm ndërmjet të cilit është bërë e mundur që ai të njihej dhe të identifikohet lehtë.

Më 28 Prill u dërgua sërish një detashment nga Kodra për në Hormovë. Këtë radhë detashmenti ishte pajisur me një listë që përmbante emra fshatarësh dhe prej tyre u shpënë në Kodër 45 banorë.

Së fundi më 29 Prill, erdhi për të tretën herë një detashment në Hormovë për të marrë aty të gjithë burrat që mund të gjente. Me sa duket, vetëm 16 burra që tashmë ndodhen në Tepelenë, mundën të shpëtojnë.

Pasdreken e asaj dite andartët u nisën nga Kodra në

drejtim të Labovës. Para se të niseshin ata i vranë të gjithë robërit e tyre, ndërmjet të cilëve gjendeshin edhe 5 burra nga Salaria dhe 5 burra nga Luzati.

Janë dëgjuar klithmat e thekshme të viktimave në Dragot (në drejtim të Beçishtit) dhe në Luzat; gjithashtu janë dëgjuar edhe krisma armësh.

Në mëngjesin e 30 Prillit disa forca ndihmëse greke të ardhura nga Luzati zunë Kodrën dhe dërguan më pas një ushtar në Tepelenë për t'i treguar prefektit mizoritë e kryera në këtë fshat.

Më 1 Maj prefekti dërgoi në fshat një farë Xhevdet, avokat në Vlorë, për të shqyrtuar të vërtetën mbi këto lajme. Ai vetë, fshatin e vizitoi më 2 Maj, i shoqëruar nga doktor Musai dhe nga dy xhandarë.

Prefekti pa shumë vende ku kishin varrosur mjaft të vdekur, të mbuluar vetëm me një shtresë të hollë rëre dhe, për më tepër, ai pa fare pranë Kishës dy kufoma që nuk qenë varrosur, njëra prej të cilave me kokë të prera.

### **2. Doktor Musai:**

Deklaron të ketë parë afër Kishës dy kufoma të pavarrosura, njëra prej të cilave ishte me kokë të prerë; pak më tutje ai gjeti copa trush njeriu. Veç kësaj ai pa në lindje të fshatit një gropë të gjatë rreth 20 metra të mbuluar me rërë të njomur me gjak. Po ashtu, ai vizitoi vendet e caktuara nga autoritetet vendase.

### **3. Gruaja Bezai nga Hormova:**

Ka një djalë të vetëm, Bek Seferi, të cilin kjo grua e

gjeti me kokë të prerë fare pranë Kishës. Kufoma nuk ishte varrosur. Kufomat e katër të afërmve ajo i pa brenda një grope të madhe prapa kishës. Kokat e disa prej këtyre njerëzve ishin gjymtuar në atë farë mase, sa që ata u njohën vetëm prej veshjeve.

Ajo është e bindur, se fshati i saj ka humbur mbi 200 banorë. Ata janë marrë në 3 pjesë bashkë me banorët e Leklit, të zvarritur nga ushtarë grekë që komandoheshin prej një oficeri. Herën e parë ata morën gjithashtu rreth 40 dele.

#### **4. Deklaratat e gjashtëmbëdhjetë grave të tjera janë të njëjta.**

Ato tregojnë të gjitha, në mënyra të njëjlojtë se si burrat e Hormovës u çuan me grupe në Kodër. Ndër të tjera ato deklarojnë se andartët kanë zhvatur të gjitha gjërat e tyre me vlerë: paratë, bagëtitë, veshjet, orenditë etj.

#### **5. Ramo Ibrahim.**

Ky njeri ishte me djalin dhe me bagëtitë e tij në Labovë. Kur po mbërrinin andartët, ai u fsheh dhe më pas e mbajti frymën në Tepelenë. Ramoja nuk e di se ku e shpunë andartët djalin e tij pasi e morën, po ashtu edhe bagëtitë. Veç kësaj ai humbi edhe një vëlla me gjithë të birin.

**6. Deklaratat e dy burrave të tjera nga Hormova,** të cilët u fshehën me të mbërritur në fshat oficeri grek me njerëzit e tij. Pas nisjes së tyre ata ikën nxitimthi në Tepelenë.

**7. Në spitalin e Tepelenës u mjekua nga doktor de**

**Groot**, një djalë i vogël dhjetë-vjeçar, i quajtur Resul, me një plagë të madhe në gjoks.

Ai ishte duke ruajtur delet, në malet në Jug të Hormovës, kur u zu në befasi prej andartëve, të cilët e morën atë me gjithë delet e tij për ta shpurë në Gjirokastër. Gjatë rrugës djali mundi t'ia mbathte. Ai mori rrugën maleve, kur takoi shtatë djem të tjerë. Të gjithë bashkë ata u kapën nga andartët, të cilët qëlluan mbi ta dhe për pasojë u plagos rëndë Resuli. Megjithatë ai mundi të mbërrijë në Tepelenë.

### **Vizitë në Kodër**

Disa ditë pasi mbërrita në Tepelënë (13), më 14 Maj, unë vizitova fshatin Kodër i shoqëruar nga doktori de Groot.

Gjithkund nëpër fshat ajri ishte i molepsur prej kërmave të lopëve, të deleve, të bagëtive të tjera- që të gjitha në gjendje të llahtarshme kalbëzimi.

Në jug të fshatit gjendet një kishë e vogël, e cila pa asnjë dyshim ishte përdorur si burg. Brenda saj muret dhe toka ishin spërkatur me gjak; kudo kish feste dhe veshje të gjakosura. Mjeku vetë vërtetoi aty praninë e copave të truve të njerëzve. Në vendin ku dikur gjendej altari, kishin varur një litar gjithashtu të përgjakur.

Porta e vogël e drunjtë e kishës ishte bërë shoshë dhe gëzhojat para portës u tregonin vizitorëve prejardhjen e këtyre rrebesheve të plumbave.

Përmbi portë kishin krijuar dy hapësira gjatësore - duke hequr disa tulla - ku gjithashtu gjendeshin një numër i madh gëzhojash.

Prapa kishës kishin gërmuar një gropë të madhe dhe nën shtresën e hollë të rërës, mund të dalloheshin lehtësisht

## **MID'HAT FRASHËRI**

---

trajtat e trupave njerëzore.

Përpara kishës, pak më poshtë, mund të shquheshin po ashtu disa kufoma në një gropë të vogël.

Në lindje të fshatit ndodhet një shtëpi e vogël e rrethuar me pemë. Fare pranë njërës prej pemëve shquhej qartë një gropë rreth pesëmbëdhjetë metra e gjatë ku dhe ishte gjithkund i njomur me gjak: dhe tamam nën pemë shiheshin gjurmët e një pellgu gjaku.

Rreth kësaj peme, në një largësi prej pesëdhjetë metrash, ne kontrolluam tri gropa të mëdha si dhe një më të vogël. Në njërën prej gropave të mëdha ne pamë kufomën e një gruaje pa kokë.

Meqënëse kufomat ishin varrosur shumë cekët, doktori de Groot e gjykoj të nevojshme, për të parandaluar rrezikun e infeksionit, të zbrazeshin disa prej këtyre gropave, të thelloheshin ato dhe të varroseshin menjëherë sërish kufomat në mënyrë përfundimtare.

Më 16 Maj një numër i madh arrixhinjsh, filloi këtë punë të përzishme.

Po atë ditë komisioni hetimor vizitoi fshatin Kodër. Ai gjeti gjithshka, tamam siç është përmendur më lart; dy gropa "a" dhe "b" (14) ishin zbrazur. Ajo që ndodhej prapa kishës (a) përmbante tridhjetë e katër kufoma, mjaft prej të cilave e kishin kafkën e kokës të dërrmuar.

Brenda gropës së dytë (b) të hapur gjendeshin të rrasura çip më çip nëntëmbëdhjetë kufoma, disa prej të cilave me kafkën të dërrmuar.

Meqënëse mjeku nuk e gjykoj të arsyeshme që të hapeshin po ashtu si gropat e tjera, pasi ato ishin të thella aq



## **Cështja e Epirit**

sa duhet, komisioni hetimor e përfundoi punën e tij. Një prej gropave (c) kishte qenë përdorur më parë për të përgatitur gëlqere. Ajo kishte një thellësi prej 4-5 metrash. Duke qenë e mbushur në pjesën më të madhe të saj me kufoma, ajo duhej të përmbante, sipas vlerësimit tonë, rreth njëqind trupa njerëzish.

Gropat e tjera përmbanin sipas radhës: 34 (tridhjetë e katër), 2 (dy), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), dhe 20 (njëzet) kufoma njerëzish; gjithsej 195.

Bashkë me këtë raport unë kam nderin t'i paraqes komisionit tuaj një listë që përmban emrat e njerëzve që mendohet të jenë vrarë në fshatin Kodër 15).

**Gjeneral Leitnant**

**Dever**

**Kapiteni**  
**C. de Iongh**

**Mjeku Major**  
**F.de Groot**

**Toger: Meleq Frashëri.**

\*

\* \* \*

\*

### **Lista e fshatrave të shkatërruara**

<b>Nr.</b>	<b>Fshati</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Banorët</b>	<b>Shtëpitë</b>
1.	Fterra e Kurvelesh	Gjirokastër	431	86
2.	Lekdush	"	616	97
3.	Progonat	"	1463	222
4.	Nivicë	"	1450	325

## Çështja e Epirit

Nr.	Fshati	Qyteti	Banorët	Shtëpitë
92.	Radiq	Përmet	125	21
93.	Fratar	“	125	21
94.	Qeshbesh	“	73	9
95.	Koprencka	“	52	8
96.	Backa	“	21	3
97.	Gjergjova	“	15	2
98.	Panarit	Korça	373	62
99.	Flokë	“	17	1
100.	Trebicka	“	9	1
101.	Selenicë	Kolonja	168	28
102.	Taç i Poshtëm	“	77	11
103.	Taç i Sipërm	“	191	25
104.	Leskovik	“	68	7
105.	Muzhaka	“	153	17
106.	Qafëzeza	“	63	12
107.	Kreshova	“	94	21
108.	Malinat	“	6	1
109.	Kakosh	“	4	1
110.	Muzencka	“	62	11
111.	Kaltanji	“	192	39
112.	Qinam	“	61	10
113.	Qyteza	“	78	9
114.	Raja	“	12	4
115.	Bezhan	“	64	4
116.	Gjonç	“	26	5
117.	Mezar	“	12	1
118.	Corovodë	“	10	2
119.	Lencka	“	18	3
120.	Barmash	“	62	11

## MID'HAT FRASHËRI

Nr.	Fshati	Qyteti	Banorët	Shtëpitë
63.	Markat	Përmet	8	1
64.	Vilusha	"	8	1
65.	Gjata	"	14	1
66.	Manubas	"	117	15
67.	Peshtan	"	150	32
68.	Panarit	Frashër	44	6
69.	Bistrovica	"	25	2
70.	Alipostevan	"	59	10
71.	Radina	"	2	1
72.	Bagri	"	9	1
73.	Brezhdan	"	3	1
74.	Kurtës	"	30	4
75.	Frashër	"	12	218
76.	Riban	"	131	34
77.	Varibob	"	11	2
78.	Miraslavica	"	28	3
79.	Çepan	"	36	6
80.	Malind	Skrapar	22	3
81.	Serepol	"	61	13
82.	Delvina	"	127	26
83.	Navarica	"	9	2
84.	Sevrani	Përmet	195	84
85.	Topojan	"	239	36
86.	Tolari	"	231	38
87.	Kajtsa	"	25	6
88.	Zhepova	"	325	43
89.	Memaliaj	"	168	32
90.	Mazhan	"	215	34
91.	Pale	"	188	27

## Çështja e Epirit

Nr.	Fshati	Qyteti	Banorët	Shtëpitë
34.	Dams	Tepelenë	513	87
35.	Mezhgoran	“	474	87
36.	Salari	“	862	142
37.	Mërtinjë	“	70	14
38.	Potgoran	“	283	35
39.	Kiçok	“	8	1
40.	Arzë	“	667	49
41.	Toskmartalloz	“	293	45
42.	Shelq	“	90	13
43.	Turan	“	368	52
44.	Moriçan	“	346	58
45.	Bënja	“	89	12
46.	Kashishti	“	419	66
47.	Bënça	“	577	130
48.	Hormova	“	523	98
49.	Bubës	“	117	13
50.	Beçisht	“	185	34
51.	Veliqot	“	100	22
52.	Melçan	“	4	1
53.	Vasjar	“	15	7
54.	Pavar	Përmet	15	6
55.	Zavalinë	“	3	1
56.	Këlcyrë	“	515	89
57.	Gërpcka	“	46	13
58.	Vinokash	“	21	3
59.	Bënjëza	“	26	3
60.	Përmet	“	4	1
61.	Ogren	“	7	1
62.	Virtenig	“	9	1

## MID'HAT FRASHËRI

---

Nr.	Fshati	Qyteti	Banorët	Shtëpitë
5.	Vergo	Gjirokastrë	217	34
6.	Zhulat	"	1495	249
7.	Kuç	"	1848	300
8.	Borsh	"	1120	183
9.	Palavli	"	174	28
10.	Kalasa	"	304	64
11.	Kallarati	"	567	98
12.	Kongutz	"	37	6
13.	Kolonja(Labëri)	"	475	74
14.	Picar	"	658	121
15.	Sasaj	"	190	32
16.	Golem	"	1098	153
17.	Gusmar	"	571	95
18.	Tatzat	"	353	137
19.	Bolena	"	918	159
20.	Rexhinë	"	399	65
21.	Kopaçez	"	355	115
22.	Teheror	"	148	30
23.	Shtëpëz	"	66	12
24.	Kardhiq	"	281	50
25.	Gjirokastrë	"	9	3
26.	Plesat	"	246	48
27.	Prongji	"	212	38
28.	Dorëza	"	12	1
29.	Fushëbardhë	"	61	7
30.	Tepelena	Tepelenë	353	62
31.	Luzat	"	462	71
32.	Dukaj	"	494	89
33.	Dragot	"	253	49

## MID'HAT FRASHËRI

Nr.	Fshati	Qyteti	Banorët	Shtëpitë
121.	Qesaraku	Kolonja	30	1
122.	Erseka	"	15	2
123.	Selenica	"	81	14
124.	Pezar	"	104	18
125.	Lubonja	"	99	19
126.	Starja	"	38	5
127.	Gostivishti	"	84	14
128.	Luaras	"	99	17
129.	Pazhomit	"	49	11
130.	Shalës	Leskovik	40	8
131.	Kockë	"	gjithë fshati	
132.	Peshtan	"	82	11
133.	Radan	"	81	5
134.	Radat	Leskovik	6	1
135.	Novosela	"	265	53
136.	Bejkova	"	42	6
137.	Kagjinas	Leskovik	178	25
138.	Hoseçka	"	53	11
139.	Vërpcka	"	41	8
140.	Konispol	"	87	15
141.	Leshnja	"	126	17
142.	Poda	"	3	1
143.	Zhepova	"	16	2
144.	Korona	"	42	13

## SHËNIME

1. Ne garantojmë autencitetin e tekstit, nëpërmjet dëshmime të shumë bashkëkohësve.

2. Dhëlpëritë e qeverisë greke provokuan neveri dhe humbje durimi te z. Asquith, kryeministër i Britanisë së Madhe.

3. Për ne Epiri është i gjithë Jugu u Shqipërisë, deri në gjirin e Artës. Për grekët është vetëm pjesa që formohet prej rrethëve të Korës dhe të Gjirokastrës.

4. Kemi nxjerrë dy paragrafët e mëposhtëm nga gazeta "Koha", botimi Frëngjisht dhe Anglisht, nr.1, që doli në Korçë më 3/16 Maj 1914. Numri i dytë dhe i fundit i kësaj gazete doli më 15/28 Maj.

5. Shih Brailsford, "Macedonia, its races and their future", London 1905, një përshkrim i peshkopit të Kastorias dhe të terrorizmit religjioz të grekëve.

6. Kjo çmenduri është e përgjithshme tek të gjithë grekët: një ish konsull i përgjithshëm grek në Selanik, aktualisht ministër i Plotëfuqishëm në Romë, përdor të njëjtën gjuhë me një seriozitet të habitshëm!

Fare pak kohë më parë (Janar 1915) qeveria e Venizellos nuk pretendonte, dhe pa shaka, që në Durrës kishte 1800 grekë, duke dashur të thotë me këtë për gjithë sa qenë të krishterë-ortodoksë!

Fjalë për fjalë: "Lajmëtari (Le messenger) i Athinës i datës 9 Janar (n.s) 1915: Komuniteti helenik i Durrësit, sipas një statistike zyrtare, llogarit jo më pak se 2000 shpirt (!!)

7. Në muajin Prill 1914 gjendeshin në Korçë tri të rinj të huaj: konti Pimodan (francez), princi Stourdza (rumun), dhe Mr. H. Shervord Spencer (amerikan). Këta tri zotërinj, ndonëse kishin ardhur thjesht për kuriozitet dhe si turistë, u gjendën në

## MID'HAT FRASHËRI

---

epirotë, në Kolonjë, në jugperëndim të Korçës; ata panë me sytë e tyre se ata që thirreshin epirotë, nuk ishin veçse ushtarë dhe oficerë grekë, të veshur si hajdë malesh.

8. Kujtojmë këtu që gjatë gjithë problemit epirot, Zografos dhe kolegu i tij Spiro Mïlo, të dy epirotë, domethënë shqiptarë, i pari bir i një babai me origjinë nga Gjirokastra dhe i dyti i lindur në Himarë, që të dy hynë të rinj në shërbim të Greqisë dhe, si gjithë tradhtarët, me një devotshmëri servile ndaj çështjes greke.

9. Nëse ne pëlqejmë të citojmë në rëndë të parë gazetën “Koha” (Lë Temps), kjo ndodh kryesisht për shkak të karakterit të saj skandaloz grekofil, se sa për ndonjë arsye tjetër.

10. Të mbajmë të qeshurën?

11. Thuajse të gjithë oficerët grekë të mbiquajtur Zografistë dhe Epirotë, janë akoma në ushtrinë greke madje të graduar.

12. C.I.C.-Shkurtim i përdorur për Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit.

13. Është gjithmonë gjenerali Dever që flet. Raporti i është adresuar C.I.C.

14. Një skicë i është bashkëngjitur raportit.

15. Lista e 217 personave i është bashkëngjitur raportit.



---

**Shqiptarët  
në  
vendlindje  
dhe në  
mërgim**

Lozanë 1919

Një ditë në shtëpinë e një miku, kur ra fjala për karakterin e shqiptarëve, aftësitë, sociologjinë, mënyrën e jetesës dhe të punës, të pranishmit thanë:

“Në përgjithësi shqiptarët na i kanë përshkruar si një popull primitiv ( për të mos thënë fis), që nuk kanë tjetër aftësi veçse të luftojnë”.

Por për vetitë e luftëtarit, zakoni që të përballojë vdekjen pa u frikësuar prej saj, nuk duhet të përjashtojë virtytet e tjera dhe atdheu i shqiptarëve aq i copëtuar dhe i sakatuar fizikisht i ka dhënë jetë një diversiteti të madh dispozitash natyrale dhe prirjesh banorëve të vet. Kështu nëse ka ndërmjet tyre ushtarë të shkëlqyer, nga ana tjetër nuk mungojnë tregtarë të mirë, artizanë shumë të aftë dhe punëtorë të fuqishëm.

Shumica e udhëtarëve i kanë njohur shqiptarët vetëm si KAVASS, si një roje apo si pjestar të gardës së bukur të Sulltanit në Kostandinopojë. Kështu, ata kanë menduar se shqiptari është një djalosh i fortë e i bukur, besnik dhe i aftë, të cilit mund t'i zihet besë gjithmonë, por nga i cili nuk mund të presësh punë e prodhim, domethënë “një njeri i admirueshëm që krekoset për gjithshka po pa bërë asgjë”, siç thotë me humor një francez i mbushur me frymëzim 1).

Fjalët e mësipërme janë si një dackë miqësore mbi shpatullat e shqiptarëve, sepse ashtu si “krekosjen” askush nuk ka marrë guximin të vërë në dyshim vetitë e tyre.

“Nëse udhëtari i thur lavde turqve sepse shërbëtori i tij turk është mjaft i sjellshëm, ju do të zbuloni në përgjithësi se ky turk është një shqiptar 2).

Kështu Kavass-ët 3) e të gjitha ambasadave dhe legatave në Kostandinopojë, ashtu si edhe ata të konsullatave në qytetet e Turqisë kanë qenë përgjithësisht shqiptarë. Ata gjithashtu

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

gjendeshin pranë misioneve të huaja, në dyqanet e mëdhenj të tregtisë dhe veçanërisht në ato të pasurat, kudo ku kërkoheshin njerëz që të përmbushnin detyrat e tyre me sjellje të mira dhe zgjuarsia dhe sidomos me shumë maturi dhe besnikëri. Askush nuk është penduar nga kjo zgjedhje edhe kurrë ndonjë padron nuk është tradhtuar, vjedhur, braktisur ose rrezikuar nga kavass-i i tij.

“Shqiptari është një njeri besnik deri në vdekje. Mbasi ka dhënë fjalën, një urrejtje është jo vetëm shërbëtori më i sigurt dhe shoku më i sinqertë në gjithë Lindjen, por është mbrojtësi më i mirë në çdo vështirësi që paraqitet”<sup>4</sup>).

Anglezi Brailsford që kishte qenë në Maqedoni për t’u shpërndarë ndihma bullgarëve mbas revoltës së tyre të vitit 1803, nga ana e “Komitetit Ballkanik” të Londrës, me të mbërritur në Manastiriu drejtua personave të ndryshëm të krishterë, me pozita zyrtare, për t’iu kërkuar njerëz besnikë dhe më në fund ai mësoi se njerëzit që i duheshin ishin vetëm shqiptarë muslimanë, ortodoksë, katolikë ose protestantë, që të gjithë të rekomanduar jo nga shqiptarët por nga kryepeshkopë, konsuj ose misionarë 5).

Brailsfordi na tregon se misioni për shpërndarjen e ndihmave u krye nga 15 shqiptarë dhe gjashtë jo-shqiptarë, domethënë sllavë. Nga këto gjashtë të fundit vetëm dy u ngarkuan me detyra të rëndësishme dhe njëri prej tyre u tregua i paaftë për të kryer misionin e tij, që përbën 50 përqind të efektivit. Ndërkohë që ndërmjet pesëmbëdhjetë shqiptarëve vetëm njëri u bë objekt i një shqetësimi të lehtë sepse të 15-tët kishin detyra të rëndësishme. Pra një propocion prej 6 përqind. Shifrat flasin vetë.

I kërkojmë ndjesë lexuesit që të na lejojë të riprodhojmë këtu një copëz të shkurtër të librit të Brailsfordit, ku përshkruhet karakteri i shqiptarëve:

“Sensi i humorit i një shqiptari, nuk është i kapshëm menjëherë, siç mund ta shprehin shqisat e jashtëm. Ai do t’ju vriste pa iu dridhur qerpiku, nëse e çon ndërmend që ju e keni lënduar, siç e kanë paguar shtrenjtë kësisoj oficerë turq dhe konsuj rusë. Dhe nëse vrasësi, tani një kriminel endacak, do të gjente strehë në rrugë, tek dikush i panjohur ose edhe në armiqësi me këtë, ky i fundit do ta pranonte më lehtë të luftonte për hir të tij deri në fund se sa të dorëzonte vrasësin tek autoritetet vendase.

Është jashtëzakonisht domethënë fakti që shqiptari është tepër fanatik edhe ndaj mbajtjes së besës së dhënë. Për ta mbajtur këtë besë si burrë i vërtetë, atij i duhet të përballet me gjithfarë rreziqesh. Për të ndihmuar dikë në mbajtjen e besës, fisi asnjëherë nuk mund të hidhej në sakrificat e paarsyeshme.

Pa dyshim që sensi i humorit të shqiptarëve është mesjetar. Por nëse tek ky sens ka vrazhdësi dhe ndonjë dozë mungese të arsyes, ai përmban në të njëjtën kohë edhe fisnikërinë e një kalorsi të vërtetë, domethënë diçka nga dinjiteti i paepur i shpirtit kalorsiak.

...Do t’ju rrëfej një ngjarje befasuese e cila më ka lënë në kujtesën time një ndjenjë të pashlyer për tërë jetën dhe që shërben si shembull më i qartë për të kuptuar më lehtësisht se çdo lloj dëshmie se kush është qëndrimi i zakonshëm i të huajve ndaj shqiptarëve, duke patur parasysh sidomos ata që i njohin mirë këta të fundit. Situata mjaft e rënduar në dimrin e fundit ishte e tillë që s’kish rrugë zgjidhjeje tjetër humane, veç dërgimit prej Fondit Britanik në Maqedoni një shumë të madhe të hollash në flori. Rruga kalonte në Ohër, Resnjë dhe disa vende të tjera ku ne kishim qendrat tona shpërndarëse. Mënyra më e thjeshtë ishte të dërgonim shoqëruesin tonë shqiptar, një djalë shpuzë i quajtur Hasan, i cili hipur mbi kalë do të kalonte fillikat malet duke patur vetëm pushkën, shpatullat e gjera dhe paratë e vendosura në qese

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

rreth belit të tij si lastar. Ai e çoi ku duhej dërgesën e parë të vogël dhe më pas këto dërgesa u bënë shumë të mëdha. Por askurrë nuk ndodhi që t'i mungonte gjatë dorëzimit ndonjë qindarkë.

Një ditë të bukur, Hasani arriti në Ohër me 400 stërlina flori. Qëndrimi i tij ishte shpërfillës e ndërsa unë numëroja monedhat e arta ai më vështronte me një ndjenjë sa të çiltër aq edhe të sigurtë për arritjen e suksesit. Virtyte të tilla i kërkohe natyrisht më tepër dhe shumë seriozisht një nxënësi qytetar të shkollës publike angleze se sa një fshatari ballkanas. Përpara meje qëndronte një fytyrë që askush nuk mund të mos e besonte. Prej saj buronte veç ngohësi e mirësjellje të çilat shpërthenin prej shpirtit të pastër dhe harmonizoheshin, aq mrekullisht me sytë ngjyrë qielli-kristal dhe me flokët e verdhtë që të jepnin përshtypjen se ke përpara një anglez tipik apo nordik të fisshëm. Si gjithnjë edhe kësaj radhe, paratë ishin në rregull. Në diskutim e sipër pyes Hasanin, në dinte ndonjë shtëpi për të qënë në Ohër i cili asokohe ishte një qytet me rrugica të pandriçura dhe të braktisura, pothuaj të shkatërruara. Ai nënqeshi për pyetjen që i bëra. Qytetin e njihte si në pëllëmbë të dorës. Kishte diçka shpotitëse në vështrimin e tij gjë që më shtyu ta pyes se si mund të ishte shtëpia në fjalë. Hasani vinte nga një vend i largët, porse kishte banuar nja dy vite në Manastir. Me një ndjenjë miqësore dhe me çiltërsi krejt natyrale ai më tha: "Unë jam mik me Shahinin!".

Instiktivisht e pashë veten në këmbë, me një ankth të paspjeguar frike për çantat me flori rrëzëllues tek qëndronin me gryka të hapura mbi tavolinë. Kjo, sepse Shahini (ose Skifteri siç e thërrisnin në ato anë) ishte më i tmerrshmi i të gjithë kusarëve të atyre zonave fshatare, një lloj Robin Hudi i cili të vidhte me një finesë të jashtëzakonshme por edhe të vriste me qesëndi duke ta numëruar në lule të ballit. Në një farë-mënyre, Shahini ishte

## Mid'hat Frashëri

---

tirani i pakurorëzuar i atyre viseve...

Kur ia tregova këtë histori një mikut tim, ai më tha: “Përse ju nuk do t’i besonit atij trimi”? Dhe më tej ai shtoi: “Kusaria është një zanat si gjithë të tjerët. Përderisa ai ishte një cub, sigurisht që ka qenë njeri i besuar i çetave të banditëve. Njëkohësisht ndërsa ishte në shërbimin tuaj, do të ishte edhe i besuari yt”.

Hasani duke më folur për Shahinin kishte pohuar diçka të fshehtë, ndërsa një i ri anglez për këtë do të mburrej duke thënë: “Unë kam shërbyer në kalorsinë mbretërore” ose “Unë kam qenë në krah të Baden Pauellit”.

Por më e rëndësishmja nga të gjitha këto, është shprehja lakonike me të cilën një peshkop bullgar m’u kundërpërgjigj.

“Imzot, a do t’i besonit ju atij”?-pyeta unë.

“Ai është shqiptar, apo nuk është kështu”?-që përgjigja e shkurtër e tij.

Hasani ishte fshatar dhe muhamedan. Por ai, falë zgjuarsisë dhe urtësisë së tij, zotëronte aftësi gjykuese më të mira se ato që zotëronin shqiptarët e tjerë që në fakt i përkisnin fesë kristiane, qoftë edhe ndaj atyre njerëzve me nivel kulturor të lartë. Nuk kishte asnjë lloj qëllimi dashakeq ose brengë ndërgjegjeje në qëndrimin e tij.

Këto tipare, përgjithësisht shihen tek të gjithë vendasit të cilët na ndihmuan neve në një mënyrë apo në një tjetër në të shtatë vendshpërndarjet e ndihmave humanitare.

Fillimisht, në kryerjen e misionit, unë gjeta 15 shqiptarë dhe vetëm gjashtë vetë që u përkisnin racave të tjera. Prej këtyre të gjashtëve vetëm dy prej tyre kishin një lloj pozicioni të sigurtë, madje njërin mund ta quaje jo të përshtatshëm. Ndërsa nga të pesëmbëdhjetë shqiptarët, vetëm njëri shfaqti dikur një kundërshtim në zbatimin e urdhrave. Sidoqoftë, ata kalonin nëpër duar me mijëra e mijëra stërlina dhe kësisoj unë do t’u garantoja duke venë dorën në zjarr për ndershmërinë gati hyjnore të secilit prej

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

tyre, që nga i pari deri tek i fundit.

Më kujtohet fare mirë kur shkova një herë tek njëri prej misionarëve protestantë për t'i kërkuar të më rekomandonin disa ndihmës besnikë dhe të ndershëm për blerjen dhe shpërndarjen e ushqimeve dhe veshmbathjeve. Në këtë kërkesë, misionari ndihej i sigurtë, pasi shpërndarja e ndihmave përbënte edhe problemin më akut që e rrethonte. Protestanizmi në sytë e tij ishte gati i barabartë me garancinë e ndershmërisë.

Kur lista përfundoi, vura re se secili emër i përkiste një shqiptari, gjë që për mua ishte krejt e habitshme, duke pasur parasysh faktin që misioni protestant supozohej të ishte i bullgarëve. Prifti katolik ishte krejt i sigurtë se ndershmëria është e papajtueshme me kristianizmin lindor. Ai desh të pohonte këtë duke sjellë përpara nesh "katolikun" më të ndershëm në tërë Manastirin. Por njeriu në fjalë, ai burrë trim, rezultoi të ishte një shqiptar i thekur.

Unë ndjeva jo pak tundim. Këtu, qysh prej kohëve që nuk mbahen mend, egziston realisht një racë të cilën nuk mund ta korruptojnë askurrë si feja ashtu edhe arsimimi.

Tek e fundit doja të shtoja se stafi ynë shqiptar, përfshinte tërë "mozaikun" fetar. Aty kish muslimanë, "grekë", protestantë dhe katolikë. Kujtoj se njëri prej burrave, një trim i çartur, më i forti dhe më i guximshmi nga ata- ishte një protestant. Ky shqiptar kishte një psikikë të mahnitshme, por i lindur në qytet ai kurrë nuk kishte mbajtur armë në duart e veta. Në kohën që autoritetet turke në Kostur keqtrajtonin duke rrahur fshatarë bullgarë që vinin në spitalin tonë, që godisnin me grushte njerëz të mjerë - unë dërgova këtë shqiptar të qëndronte në hyrje të qytetit dhe të më informonte për gjithshka lidhej me misionin tonë.

Ky shqiptar, në vend që të humbiste kohën për vrojtim, e pa të udhës të vepronte si të mundëte e të përballonte situatën e nderë. Kam mbetur pa mend kur mësova se ai "kaur" i

## Mid'hat Frashëri

---

paarmatosur, ka çarë përmes xhandarëve turq pa u trembur duke i udhëhequr fshatarët bullgarë për në spitalin tonë.

Mbajtja e një pushke në duar, do ta bënte "burrë" një bullgar kokëshkrëtë porse, vetëm një shqiptar do të mund të kryente një veprim të tillë ku i paarmatosur u përball me një formacion të tërë luftimi të turqve të armatosur deri në dhëmbë. Sigurisht në natyrën e qënies shqiptare kanë egzistuar dhe egzistojnë kapacitete dhe virtyte të rralla si ky që përmenda.

Ndershmëria dhe guximi, në shkallë të ndryshme, janë virtyte të rralla të malësorëve të vërtetë.

Motrat shqiptare të urdhrit të Shën Vinsent të Palit, të cilat punonin në Manastir nën drejtimin e një kryemurgeshe franceze dhe ato në Kostur nën urdhrat e një zonje angleze, Motra Augustinë, kanë dhënë provat e një përkushtimi tepër të rrallë. Të lindura në një vend ku asnjë grua nuk ëndërron diçka jashtë mureve të kullave, këto gra i zbatonin si me magji të gjitha kërkesat dhe shërbimet ndaj të vuajturve. Në mënyrë të padiskutueshme, këto "Motra" vendosën mbi gjithshka mirësjelljen, tiparin më dallues në raport me urdhrat e tjerë fetarë.

Ato nuk i trembeshin as ekspozimit ndaj sëmundjeve ngjitëse, as infeksioneve vrastare dhe as lodhjes tinzare dhe raskapitëse. Ta kini të qartë se asnjë zonjë e lartë angleze, e qytetëruar prej shekujsh, nuk mund të kishte qenë kaq fisnike, zemërbutë dhe dashamirëse.

Këto gra vinin nga rajonet më të thyera të Shqipërisë së Veriut dhe unë i parafytyroj burrat e braktisur të familjeve, ende të egërsuar në kulm. Për më tej, me këto gra luanesha, dikush pat realizuar një përpjekje arsmimi dhe ato flisnin një frëngjishte të kulluar aristokrate, madje me bindje e vendosnin veten e tyre në anën e kristianizmit perëndimor. E pra, ato ishin motrat dhe vajzat e bajraktarëve gegë".

\*



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

\* \* \*

\*

Si ushtarë dhe luftëtarë, shqiptarët kanë një famë të madhe për të cilën është folur shpesh. Ata kanë përbërë jo vetëm trupat më të mira të Turqisë, por njëkohësisht janë shquar dhe kanë kryer shërbime të shkëlqyera si prijësa ushtarakë pranë princave në Perëndim, në Itali, në Francë, e deri në Finlandë ku kanë shërbyer në rang sundimtarësh 6).

Gjithashtu thuhet se arti ushtarak i detyrohet diçka shqiptarëve që kanë qenë të parët që kanë futur në Perëndim kavalerinë e lehtë 7).

Shihet pra se shqiptarët mbasi kanë mbajtur lart flamurin e tyre në luftën e lavdishme kundër turqve në shekullin XV, kanë qenë jo më pak të shkëlqyer në shërbim të princave të tjerë, ndonëse gjatë pushtimit turk një pjesë e mirë prej tyre pati përqaftuar islamizmin. Por do të ishte gabim t' i akuzoje ata se i kanë shërbyer qështjes së Hënës, sepse në fillim të shekullit të kaluar do t' i shohim që t' i përkushtohen Kryqit me një trimëri dhe vetmohim që ndeshet rrallë në histori 8).

Në fakt, nëse shqiptarët si Omer Vrioni, Ibrahim Pasha (djali i Mehmet Aliut të Egjyptit) Mustafa Pasha nga Shkodra dhe Aleksandri i Zi nga Mirdita- luftonin për sulltanin, nga ana tjetër kishte të tjerë shqiptarë si heronjtë e Sulit dhe të Hidrës, Boçarët e Xhavellet, Bubulinat e Miaulet, që derdhin gjakun e tyre të kulluar për lirinë dhe lavdinë e Kryqit 9). Mbasi shkrova këto rreshta, desha të di se ç' thuhet tjetër për shqiptarët në përgjithësi dhe mora rastësisht nga librat e vjetër njërin që më ra në dorë. Ishte një Fjalor gjeografik xhëpi dhe ja se çfarë lexohej në faqen 13, në artikullin "Shqipëria": 10)

"Shqipëria, provincë e Turqisë Evropiane në gjirin e Venecias, kufizohet në jug nga Livadhia, në lindje nga Thesalia

## Mid'hat Frashëri

dhe Maqedonia, në veri nga Bosnja dhe Dalmacia. Ajo përfshin Ilirinë e vjetër greke dhe Epirin. Prodhon verëra të shkëlqyera. Banorët e saj janë shtatlartë, të guximshëm, të palodhur, kalorës të mirë dhe hajdutë të mëdhenj". Mund edhe t'i kisha zhdukur dy fjalët e fundit dhe ta kisha kursyer frazën e papëlqyeshme për shqiptarët e mi. Por duke u thelluar, mendova se ato dy fjalë duheshin marrë në shqyrtim dhe se është mirë ta shohësh të vërtetën në sy, qoftë edhe e hidhur. Në të vërtetë, a nuk është gabim, krim, mungesë njohjeje, t'i akuzosh shqiptarët si hajdutë dhe banditë? A nuk janë poetët, shkrimtarët dhe publicistët që i kanë përshkruar shqiptarët si cuba të egër, vrasës të pamëshirshëm dhe hajdutë të mëdhenj? Është e modës sot që çdo gjëkafshë të shpërftyrohet dhe të egzagjerohet. Por le ta shohim çështjen me gjakftohtësi, me paanshmëri dhe sidomos nga një këndvështrim objektiv dhe aspak nisur nga paragjykimet apo pasionet politike.

Së pari, nuk e quaj të jashtëzakonshme dhe as të pamundur që të ketë patur ose të ketë cuba në Shqipëri. Kjo është thjesht një gjë për të ardhur keq, por aspak një anomali e përbindshme. Harruam se në Turqi banditizmi ka qenë i përhapur kudo si në Evropë ashtu edhe në Azi? Harruam se Anadulli ka qenë molepsur nga banditët dhe se Bullgaria e Serbia kanë patur bandat e tyre të haiduk-ëve (cubave)? A nuk e dimë se fjala KLEFT, e poetizuar dhe e "sublimuar", do të thotë thjesht bandit e hajdut në gjuhën greke?

Dhe kjo nuk i përket historisë së lashtë, nuk është fjala për një të kaluar të largët të mbuluar me mjegullën e kohës; cubat, banditët dhe hajdutët, me një fjalë kleftët janë të një epoke krejt moderne në Greqi për të mos thënë janë bashkëkohore. K u s h nuk i kujton ende bëmat e tyre dhe kush do të mohonte kujtimin e banditizmit që lulëzonte jo shumë kohë më parë edhe në Itali?

E përse qenka e pazakontë që të ketë banditë edhe në

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

Shqipëri, në një vend të pushtuar nga Turqia ku për pasojë banditizmi është nxitur dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për ta frenuar? Banditizmi në Shqipëri është apo ka qenë një efekt logjik dhe kobzi i administratës otomane, apo është thjesht një institucion kombëtar i shqiptarëve? Përgjigjja e jonë është e shkurtër: Gjatë një viti e gjysmë afërsisht sa zgjati qevria shqiptare (1912-1914), nuk është regjistruar asnjë rast banditizmi, vjedhje ose grabitje në të gjithë Shqipërinë.

Tjetër fakt: Gjatë pothuaj dy vjetëve që zgjati Lidhja e famshme e Prizrenit më 1880, nuk ka patur asnjë rast banditizmi dhe veriu i Shqipërisë, domethënë rajonet ku ushtri pushteti ky organizim mbarëkombëtar, kanë gëzuar një qetësi, një disiplinë dhe një siguri të plotë.

Një tjetër fakt akoma më bindës: dihet se më 1912 shqiptarët patën luftuar kundër shovinizmit të Turqve të Rinj dhe se një pjesë e madhe e vendit ishte ngritur në revoltë. Në një çast të dhënë shqiptarët mundën turqit, hynë fitimtarë në qytetet e mëdha duke përfshirë edhe Prishtinën e Shkupin ku çdo autoritet i qeverisë otomane kishte pushtuar së egzistuari dhe ku shqiptarët mbetën zotërit absolutë duke iu bindur vetëm kryetarëve dhe... arsyes së tyre.

Kjo gjendje zgjati disa javë dhe një dëshmitar që i kishte parë ngjarjet me sytë e tij në Shkup, më ka treguar me një admirim të thellë se gjatë gjithë kohës kur qyteti kishte mbetur në zotërim të plotë të "shqiptarëve të egër", nuk ishte kryer asnjë krim, madje as më e vogla paligjshmëri.

Këta malësorë të armatosur as nuk kanë plaçkitur, as nuk kanë vrarë dhe as nuk kanë vjedhur qoftë edhe një krodhe buke. Dhe kur komandantët dhanë urdhër që të ktheheshin në shtëpitë e tyre, të gjithë u larguan me po atë dinjitet dhe disiplinë ashtu siç kishin ardhur.

## Mid'hat Frashëri

---

Shqiptarët pra janë të aftë të ruajnë disiplinën dhe rregullin. Banditizmi nuk është në natyrën e tyre. Ashtu siç e thotë fare qartë Brailsfordi në copëzën e cituar më lart, shqiptari ka një ndjenjë shumë të fuqishme të dinjitetit dhe kërenaria e tij arrin në një shkallë tepër të lartë; mund të thuhet se koncepti i nderit të tij është karakteri i ashpër, shqetësimi i tij më i madh. Është kjo që e ban atë kaq mikpritës sa që ai e konsideron fyerje personale mohimin e mikpritjes së ofruar prej tij.

Autori i këtyre rreshtave ka kaluar shtatë vjet më parë nga Gjakova në Mirditë nëpërmjet Urës së Vezirit mbi Drin. Në mes të urës takoj një shqiptar rreth të pesëdhjetave që po vinte kaluar drejt nesh, mbasi ishte lajmëruar se një i huaj po kalonte në afërsi të shtëpisë së tij. Dashamirësi ynë na ftoi për ta kaluar natën në shtëpinë e vet ose të paktën të hanim një kafshatë buke me të. Ne ishim me ngut dhe nuk dëshironim të humbnim kohë, por ai nguli këmbë dhe na tha: “Në rast se ju nuk pranoni të jeni miqtë e mi kur kaloni fare pranë shtëpisë time, unë nuk do të kem asnjëherë nderin t’ju pres në shtëpi sepse ju me siguri nuk do të kini rastin që të kaloni përsëri nga kjo rrugë”.

Ne u detyruam ta prananim ftesën.

Është e njëjta ndjenjë që e bën shqiptarin të mos pranojë rryshfet sepse jo vetëm që miku nuk duhet të paguajë kurrë, por është një gjë akoma më e rrallë që një shqiptar të pranojë shpërblim për shërbimin e tij kur atë e ka bërë për respekt ose për miqësi.

Do ta kujtoj gjithmonë atë që më ka treguar një mik i vjetër dhe i pasur që kishte udhëtuar nga Durrësi në Elbasan, i shoqëruar nga një xhandar vendas i cili i shërbente plakut me mjaft zell, me sjellje shumë të mira dhe ndihej tepër i lumtur duke i bërë nderet e vendit të tij një të huaji të shquar. Me të mbërritur në vendin e duhur, udhëtari desh ta shpërblente xhandarin për shërbimin e mirë por ai nuk e pranoi dhe tha duke u skuqur se e kishte për nder që i

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

kishte shërbyer një miku që udhëtonte në vendin e tij.

“Qoftë Vezir i madh në Stamboll, qoftë bari në malet e Pindit, shqiptari është një aristokrat, një njeri i lirë, një fishnik” 11). Edhe shërbëtori në Shqipëri trajtohet me mjaft ngrohtësi nga i zoti që e thërret “djalë” dhe “trim”; këto dy terma zëvendësojnë fjalët “shërbyes” dhe “shërbëtor”.

Oficerët turq e kanë paguar shpesh herë me kokën e tyre fyerjen personale që i kanë bërë ndonjë ushtari shqiptar. Më 1911, një oficer gjerman në shërbim të Turqisë u vra në Jilldiz nga një ushtar shqiptar sepse e kishte goditur me shuplakë. Ndërsa konsulli rus në Manastir Rostkovski që e kishte zakon të fshikullonte ushtarët me kamzhik, gjeti vdekjen nga një roje shqiptare kur kishte provuar ta trajtonte me po atë mënyrë 12).

Por le t'i kthehemi banditizmit. E vërteta është se ai ka egzistuar në Shqipëri ku ka patur banditë, të cilët mund t'i ndajmë në profesionistë dhe në banditë të rastësishëm. Këta të fundit në përgjithësi kanë qenë të persekutuar nga qeveria otomane ose njerëz që kanë patur ndonjë ngatërresë me dikë më të fortë se veten, një lloj faji që i trembeshin dhe i fshiheshin drejtësisë.

Këta pra nuk e ushtronin këtë profesion për qëllime përfitimi ose për të kaluar kohën, ndryshe nga ata të tjerët domethënë nga banditët profesionistë. Banditizmi profesionist ka egzistuar vetëm te banorët e Lumës, Mirditës dhe tek malësorët e Dibres në Shqipërinë e Veriut, ndërsa në Jug janë lebërit - që jetojnë ndërmjet Vlorës dhe Gjirokastrës - të cilët fatkeqësisht janë të njohur për vjedhjet dhe grabitjet e tyre. Në pjesën tjetër të Shqipërisë vjedhja nuk njihet: në Kosovë bie fjala, dhe unë flas kryesisht për Pejë dhe Gjakovën, për të cilat jam i informuar shumë mirë, mund të udhëtosh i ngarkuar me ar pa patur asnjë frikë. Atje, kur zbulohet ndonjë kufomë e dikujt të vrarë për hakmarrje, është e sigurt se në trupin e të vdekurit nuk është

## Mid'hat Frashëri

prekur asgjë, sepse vrasësi e quan për nder që ka marrë gjakun e të afërmit të vet por do ta ndjente veten përjetësisht të turpëruar nëse do të vidhte viktimën e tij.

Banditët e Mirditës e ushtrojnë mjeshtërinë e tyre mbi banorët e fushës së Tiranës e të Krujës që janë përgjithsisht muslimanë; ata të Dibrës e të Lumës bëjnë pre të tyre si muslimanët ashtu edhe të krishterët pa dallim dhe nuk është e drejtë të thuhet se është vetëm popullsia e krishterë që vuan prej tyre. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vjedhjet e lebërve.

Shkaqet e këtyre "trimërive" të mynxyrshme duhen kërkuar në gjendjen e prapambetur të Shqipërisë dhe kryesisht në moskokëçarjen e qeverisë otomane, e cila nuk ka dashur kurrë ta parandalojë këtë fatkeqësi. Përkundrazi regjimi turk, e themi këtë pa patur frikën e përgënjeshtimit, e nxiste me të gjitha mënyrat banditizmin duke përfutur prej tij funksionarët civilë dhe ushtarakë 13).

Natyra e varfër e vendit ka ndikuar gjithashtu në lindjen dhe zhvillimin e këtyre zakoneve të mbrapashta. Një administrim i mirë dhe sidomos përmirësimi i kushteve ekonomike, do të bëjnë që të zhduket kjo mjeshtëri e fëlliqur. Provën për këtë na e jep krahina e Kolonjës -ndërmjet Korçës dhe Leskovikut në Shqipërinë e Jugut- që i famshmi Pukëvil, konsull i Francës pranë Ali pashës së Janinës (14), e përshkruan si një vend banditësh. Tani, mbas njëqind vjetësh, kushtet kanë ndryshuar dhe banorët e Kolonjës, duke hequr dorë nga të mirat që iu sillte mjeshtëria e rrezikshme me armë, sot jetojnë me djerësën e ballit dhe fitojnë me punë të ndershme duke e nxjerrë bukën e gojës në rast nevojë edhe larg vendit të tyre.

\*  
\* \* \*  
\*

Dy fjalë mbi të famshmen hakmarrje të shqiptarëve. Ky

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

zakon i kobshëm dhe prapanik nuk është vetëm i tyre, sepse ai njihet edhe në Korsikë edhe te Mainotët e Moresë. Në një vend ku mungon drejtësia e organizuar dhe rërgjegjësit e sigurisë publike, hakmarrja ka shërbyer deri në një farë mase si institucion rregullues, i aftë për të ngjallur respekt për njeriun dhe për të parandaluar të keqen.

Hakmarrja ka ligjet dhe kodet e saj, të cilat nuk janë të shkruara, por respektohen plotësisht. Duhet të kemi kujdes që atë të mos e bëjmë sinonim të krimit apo vrasjes. Zakoni i hakmarrjes, i të paguarit ose i marrjes së gjakut është një detyrim, një fatkeqësi që duhet ta pësosh dhe së cilës duhet t'i nënshtrohesh me përlësi, si ndaj një fataliteti të pashmangshëm.

Karakter i shqiptarit nuk është i prirur ndaj armiqësisë; vëzhgimet që kam bërë, më detyrojnë më tepër të pranoj se ka më shumë shpirtmadhësi sesa në cilido popull fqinj të tij.

Gjatë revoltave të tyre kundër turqve, gjatë grindjeve të tyre me grekët dhe serbët, shqiptarët kanë treguar bujari e zemërgjerësi, të cilën gjithmonë kundërshtarët e tyre e kanë shpërblyer me tradhti dhe mizori të ftohtë. Sjellja e shqiptarëve gjatë revoltave të vitit 1914 e ka forcuar bindjen time dhe cilindo që ka marrë mundimin të studiojë mënyrat e tyre të veprimit dhe t'i krahasojë ato me çka ndodhur në Rumani (1907), në Maqedoninë Bullgare (1903) dhe në ditët tona në Rusi, do të bindet për vërtetësinë e pohimit tonë 15).

\*

\*

\*

\*

\*

Në përgjithësi besohet se shqiptarët në vendin e tyre merren vetëm me rritjen e bagëtive dhe se ata parapëlqejnë jetën e bariut kundrejt asaj të punëtorit. Në fakt është e vërtetë se malet e Shqipërisë ushqejnë tufa të panumërta bagëtish me lëkurë

## Mid'hat Frashëri

---

të butë dhe me lesh tepër fin. Mali Sharr në veri të Shqipërisë dhe vargmalet paralel me bregun e detit, që shtrihen nga Vlora në Prevezë, fshehin pasuri të pamata që përbënin për jugun, me ullishtat e pemëtoret, burim të ardhurash për banorët. Thamë përbënin sepse numri i bagëtive që shqiptarët kanë humbur gjatë luftës Ballkanike të viteve 1912-1913 vlerësohet në më shumë se dy milionë krerë.

Por rritja e bagëtive në zonat mafore të Shqipërisë nuk e pengon zhvillimin e agrikulturës në zona të tjera. Fusha e Korçës dhe e Starovës, lugina e Devollit, krahina e Gorës, fusha e Tetovës dhe sidomos toka që shtrihet nga Peja në Gjakovë, janë të kultivuara me shumë kujdes dhe prodhimi që jep agrikultura është me të vërtetë mahnitës.

Cilido që ka udhëtuar nga Peja në Gjakovë, ka mbetur i mahnitur nga bukuria e fushave dhe e pemishteve, nga kanalet vaditëse që shërbejnë për të ujitur deri livadhet, nga kujdesi me të cilin janë mirëmbajtur deri vijat e ujit dhe përmbyllëset e tyre. Fshatarët atje janë shqiptarë autentikë, të gjithë muslimanë, pa asnjë përzierje gjaku me sllavët. Dhe ashtu si terreni fushor ndërmjet dy qyteteve të mëdha të veriut Pejës dhe Gjakovës, e gjithë pjesa tjetër e fushës së Kosovës, prodhon drithëra dhe fruta të mira. Fushat e Tetovës, Starovës, Korçës dhe Devollit janë pemishte të vërteta, të admirueshme për drithërat e tyre, zarzavatet dhe frutat e mrekullueshme.

Artizanati dhe njeshtëritë nuk janë të lëna pas dore, ashtu siç mendohet. Qytetet e mëdhenj të Veriut, Prizreni dhe Gjakova janë mjaft të njohur në përpunimin e hekurit, arit dhe argjendit ku artizanët shquhen për punime me të vërtetë artistike të larjes me flori dhe të filigramës. Atje prodhohen armë të bukura, kama prej çeliku, qyta dhe doreza të gdhendura e të lara me flori. Këto qytete shquhen gjithashtu edhe për punimet e holla të qëndismave në



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

lëkurë dhe kadife, punime të mrekullueshme me të cilat shqiptarët zbukurojnë veshjet e tyre ose brezin e gjerë prej lëkure ku mbajnë armët e tyre.

Punimet e qëndstarisë prodhohen kudo me shumë shije që nga Janina deri në Shkodër dhe në disa qytete të tjera si Tiranë dhe Elbasan; Shkodra shquhet veçanërisht për elegancën dhe tejdukshmërinë e copave të mëndafshita.

Vlerat e shqiptarëve, si një popull punëtor, kanë qenë përmendur nga shumë autorë të huaj. Vetë Pukëvili, ky francez që kishte motive politike personale për të mos i dashur shqiptarët, është i detyruar t'u thurë atyr lavde:

“... duke vërejtur kolonitë e tyre të shpërndara në Korinth dhe në Atikë, Argosin që ata e ngritën nga rrënojat, Athinën që e gjallëruan, do të shihet se duke u larguar nga jeta e tyre primitive, shqiptarët kërkojnë të përmirësohen pa humbur energjitë e tyre. Do të bindesh njëkohësisht se ata janë më me dituri se grekët në menazhimin e ekonomisë shtëpiake. Por për t'i vlerësuar më mirë duhet të marrësh në konsideratë begatinë e lartë të ishujve Hidra dhe Specia, shkëmbijtë sterilë të të cilëve barazohen ose tejkalojnë gjithë fushat më të lulëzuara të Mesdheut” 16).

“Shqiptarët, punëtorë agrikulture, janë vendosur në gërmadhat e qyteteve të mrekullueshëm; ata e mbajnë pushkën me kaq shkathtësi sa edhe lopatën (17)... Ndërkaq, kjo racë luftarake, duke kaluar nga një luftë në tjetrën, luftë edhe brenda vetvetes, nuk ka lënë pa e kultivuar tokën dhe pa e begatuar atë; ky popull ka një energji që u mungon vendasve...18).

Dr. Alfred Filipson, që ka studiuar gjithashtu shqiptarët e Peloponezit pak vjet më parë, pranon se ata janë më aktivë, më të qëndrueshëm, më të fortë e punëtorë sa fqinjët e tyre grekë 19).

“Kjo racë është e aftë për luftë po aq sa edhe për

## Mid'hat Frashëri

---

agrikulturën”, thotë një autor tjetër 20).

Do të flasim më poshtë për cilësi të tjera të shqiptarëve, po për t’u thelluar më tej në virtutin e tyre si agrikultorë dhe punëtorë të mirë, do të citojmë një pjesëz ku flitet për shqiptarët që kanë emigruar në shekullin XV për t’u vendosur në Jug të Italisë dhe në Sicili:

“...Të detyruar nga nëvoja të punojnë për shumë vite, të syrgjynosur në male shterpë, ata kanë hapur toka të reja dhe kanë sjellë jetën aty ku mbretëronte vdekja 21).

Pjesët e cituara më lart nga Pukëvili dhe Döpping na japin rastin për të folur pak më shumë për shqiptarët e Greqisë dhe të Peloponezit, të cilat kanë qenë autorët kryesorë jo vetëm të pavarësisë së mbretërisë por edhe të zhvillimit ekonomik. Pa ata Greqia ndoshta nuk do të kishte mundur kurrë të rimëkëmbej as moralisht, as materialisht.

Eruditi i shkëlqyer grek Coray në një broshurë të publikuar në Paris për grekët (22), nuk gjen lëvdata veçse për hidriotët dhe suliotët, domethënë për shqiptarët që nuk kishin asgjë të përbashkët me grekët. Kontrasti është tepër i madh ndërmjet karakterit të grekëve të vërtetë dhe atij të shqiptarëve të ishullit dhe krahasimi është kuptimplotë:

“Ishulli Hidra ndryshon nga pjesa më e madhe e ishujve të tjerë të Greqisë ku gjen vetëm një popull të degjeneruar që zvarritet nën pushtimin e të huajve, të varfër në mes të një vendi të pasur, të trishtuar e të sëmurë në një klimë balsamike. Në Hidra shihet karakteri grek me të gjithë energjinë e tij. Hidriotët janë gazmorë, të fuqishëm dhe aktivë; qytetet e tyre rriten çdo ditë; shtëpitë e pastra, të ajrosura, të bëjnë të mendosh për një bollëk të vënë me djersë, madje edhe për njëfarë luksi. Atje shihen magazina e dyqane të mbushura plot me mallra të industrisë dhe të tregtisë, një tempull i një arkitekture elegante... Janë hidriotët që furnizojnë Kostandinopojën me trurin e Lindjes” 23).

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

Një autor tjetër Depping që e kemi cituar më lart shprehet kështu në volumn III, faqe 5, të veprës së sipërpërmendur:

“Duket se shqiptarët, duke u vendosur në disa ishuj të Arqipelagut kanë shfaqur shumë energji, të cilat kanë qenë të ndrydhura nga plogështia orientale”.

Ndërsa pak më poshtë, në faqen 8 të të njëjtit volum, duke folur për Hidrën dhe duke konfirmuar Kastelanin, ai shton:

“Është e drejtë të mendohet se ky aktivitet energjik i hidriotëve është ndoshta efekt i gjakut shqiptar që rrjedh nga paraardhësit e tyre”.

Po atje, faqe 14, lexojmë:

“Banorët e ishullit të vogël Specia ecin në gjurmët e marinarëve të Hidrias. Marina e tyre përmban nja 60 anije dhe rreth 2700 marinarë; kjo është marina më e fortë e Arqipelagut mbas asaj të Hidras, ndërsa ishulli i madh i Kretës nuk ka një marinë me përmasa të tilla të konsiderueshme”.

Janë shqiptarët e Hidras dhe të Specias që kanë bërë të mundur ripërtëritjen e Greqisë me Miaulët, Konduriotët dhe shumë të tjerë. Autorët e kësaj vepre nuk kanë mundur të gjejnë asnjë lëvdatë për grekët, ndërsa kanë shprehur mjaft të tilla elokuente për shqiptarët 24).

Emerson në veprën “Tablo e Greqisë”, përkthyer në anglisht nga Jean Cohen, Paris 1826, faqe 259, i thur lavde karakterit të sinqertë e të ndershëm të Miaulit, mbasi shkruan kështu për grekët në përgjithësi:

“Pështypja që grekët bëjnë tet të huajt nuk është shumë e mirë, madje ajo që nuk është aspak në favor të tyre është fakti se personat që kanë folur keq për ta janë tamam ata që kanë jetuar për një kohë të gjatë në Greqi, në republikën Joniane dhe në Smyrne”.

Mjeshtëria e detarit nuk është privilegj vetëm i

## Mid'hat Frashëri

---

shqiptarëve të Hidras dhe Specias; ata të Ulqinit dhe të Himarës kanë qenë gjithmonë të njohur si mjeshtër në artin e lundrimit dhe ende sot- ulqinakët janë marinarë të shkëlqyer dhe zhvillojnë një tregti mjaft aktive me anijet e tyre me vela ose me varka të tjera të vogla në gjithë Mesdheun. Fatkeqësisht në pjesën tjetër të Shqipërisë gjen shumë pak detarë dhe gjeografi i madh Elise Reclus shtron me të drejtë pyetjen:

“Sado të madha të jenë vështirësitë ( që paraqet bregdeti shqiptar), habitesh se sa i pakët është lundrimi gjatë brigjeve të Shqipërisë. Epirotët dhe grekët a nuk janë të së njëjtës racë si piratët hidriotë, që gjatë luftës së pavarësisë helenike kanë bërë të mundur lindjen në Arqipelag të flotave të tëra dhe që më pas janë bërë ndër marinarët më të shkëlqyer të Greqisë? Dhe ndërkaq, portet e bregut shqiptar: Tivari, Durrësi, Vlora e Parga, të mbuluar me pyje agrumesh, ashtu si edhe Preveza e njohur e rrethuar me pyllin e saj prej mëse 100.000 ullinjve, nuk kanë veçse një tregti fare të vogël” (25).

Nuk kemi aspak qëllim të denigrojmë grekët, por të themi të vërtetën për shqiptarët. Por në këto çaste që po shkruajmë këto rreshta, ata janë vënë që të gjithë në lëvizje për të shpifur dhe diskretituar shqiptarët. Pra, nuk do të ish e tepërt të kujtojmë se ç’kanë thënë për grekët të huajt, në fillim të epokës së tyre të pavarësisë.

J.S.Mangeart, “Kujtime nga Morea”, Paris 1830, fq. 15:

“Këta njerëz kur i pashë për herë të parë, nisa t’i përpij me sy duke i paramenduar si heronj, ndonëse heronj fatkeqë por ata më lanë pështypjen e një tufe njerëzish të egër, hajdutë, mjeranë të cilët nuk e kishin për gjë të rripnin mirëbërësin e tyre ndonëse e dinin mirë se nuk ishin më të fortë se ai; sepse unë dallova te ata shenjat e njerëzve të poshtër dhe nuk pendohem që po i quaj kështu”.

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

E njëjta gjë shprehet edhe në faqen 29 të librit të mësipërm kur ai vë të njëjtat fjalë në gojën e një mjeku leonez, Saint-Andre.

Anglezi George Finley në librin e tij “Historia e Greqisë”, Londër, duket se nuk ka ndonjë mendim më të mirë për heronjtë e tij.

Dhe pothuaj është e njëjta përshtypje që gjejmë tek një grek, autor anonim i librit “Të dhëna mbi Greqinë dhe administrimin e Capo d’Istria”, Paris 1833, dëshmitar okular i fakteve që ai sjell.

Në Capo d’Istria duket se është shtruar shpesh herë pyetja nëse ky popull është i aftë të jetojë. Të parët e vendit janë të pakënaqur nga institucioni i gjykatave dhe heqja e shkollave, pirateria është në lulëzim, vjedhjet dhe grabitjet janë një praktikë e zakonshme.

“Para se të mendojmë për të organizuar vendin në brendësi, duhet të zgjidhim këtë problem: a mundet populli i Greqisë të ruajë pavarësinë e tij? A i ka ai energjitë dhe aftësitë e duhura për këtë? A ka ai të paktën burime njerëzore? Dhe nëse këto burime njerëzore egzistojnë, a do të ndeshen ata me pengesa gjatë zhvillimit të ardhshëm?”

Roli i luajtur nga shqiptarët në ringjalljen e Greqisë, ka qenë i njohur nga të gjithë historianët francezë, anglezë apo gjermanë.

Pak kohë përpara ringjalljes së grekëve, një autor kishte vënë re se i vetmi element i aftë për të ushtruar një ndikim mbi fatin e Greqisë ishte ai shqiptar mbasi vetë grekët nuk kishin asnjë energji:

“Me shumë të drejtë mund të çmosh guximin e shqiptarëve, të cilën grekët e vlerësojnë lart në aksionet heroike në Sul duke e krahasuar trimërinë e tyre me ato të spartanëve

## Mid'hat Frashëri

---

dhe të athinasve të hershëm. Por ndërkaq ata harrojnë se një pjesë e këtyre shqiptarëve, ndonëse jetojnë në Greqi, nuk kanë aspak origjinë të përbashkët me helenët e rinj” 26).

\*  
\*       \*  
\*

Por për të vlerësuar më mirë veprimtarinë e shqiptarëve, qëndresën e tyre ndaj lodhjes dhe këmbënguljen në punë, duhet t'i shohësh ata jashtë vendit të tyre, atje ku puna, e tyre çmohet më shumë.

Shqiptari e lë atdheun pa të keq jo për të emigruar, por për të kërkuar fatin gjetiu dhe ndoshta është ky eksod që e pengon vendin e tij të lindjes të begatohet sa më lart. Është gabim të besohet se shqiptari jashtë vendit të tij kërkon punë për të cilën ai nuk mundohet shumë. Në fakt Viktor Berard ka thënë ndër të tjera me frymëzim dhe me mjaft arsye:

“Bullgarët janë të shëmtuar dhe me fytyra të trishtuara. Kostumet e tyre pa shije e pa ngjyra të gjalla, janë të qëndisura me ngjyrë jeshile të errët dhe të zezë. Pranë tyre shqiptari duket i bukur me atë veshje të kuqe, që shfaqet përpara nesh i hipur në kalë, me pushkën në shalë, me një pamje madhështore, ngadhënjimtare dhe hijerëndë prej zotnie. Ai vjen nga Korça dhe, i pajisur me pushkën dhe zotësinë e tij, shkon të kërkojë fatin në Stamboll. Ai do të bëhet ZAPTIE, prefekt, ambasador, ndoshta vezir i madh dhe kudo ai do të mbajë sërën e tij” 27).

Ndërkaq të gjithë ata që largohen nga fshatrat e vilajeteve të Janinës, Manastirit, Shkupit dhe Shkodrës nuk shkojnë veçse për t'u bërë nënpunës, funksionarë dhe KAVASS të thjeshtë. Një numër akoma më i madh, marrin rrugën e egzilit me qëllimin jo për të shkëlqyer e për t'u dukur por për të fituar bukën e gojës me

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

djersën e ballit.

Kostandinopoja numëron ndoshta mëse 60.000 shqiptarë të ardhur prej katër vilajeteve të Shqipërisë. Disa mjeshtëri janë tërësisht në duart e tyre dhe kryeqyteti i perandorisë turke nuk do të mund të bënte dot pa to.

Të gjithë shtruesit e rrugës në brigjet e Bosforit dhe të Bririt të Artë janë shqiptarë nga Opari dhe Tomorrica, ata formojnë një korporatë të madhe dhe tepër të pasur duke qenë të vetmit sipërmarrës të punëve bashkiake; deri në atë pikë sa më 1913, të nesërmen e luftës Ballkanike kur shqiptarët patën deklaruar pavarësinë e tyre, turqit deshën ta bojkotonin por shumë shpejt u shtrënguan të heqin dorë.

Agrikultura, (zarzavatet, sallatat etj) është ushtruar ekskluzivisht prej shqiptarëve të ardhur nga rajonet e Përmetit dhe të Leskovikut. Janë ata që prodhojnë këto kultura, që bëjnë shitjen ambulante të tyre dhe që kanë dyqanet. Magazinat e frutave më të mira dhe më të bukura në Pera dhe në Stamboll janë hapur dhe mbahen nga po këto shqiptarë. Përmeti dhe Leskoviku, vendlindja e këtyre njerëzve, megjithëse nuk kanë fusha shumë të mira kanë arritur një prodhimtari të madhe në sajë të punës këmbëngulëse të banorëve të tyre dhe udhëtarët mund të admirojnë si pemishtet dhe kopshtet me zarzavate, ashtu edhe fushat e begata.

Kultura e hardhisë në bregdetin e Evropës dhe Azisë, në rrethinat e kryeqytetit, është zhvilluar nga shqiptarët e Matit dhe të Elbasanit. Janë po këta banorë që kultivojnë fushat e mëdha në Maltepe-përballë Prinkipos, në bregdetin e Azisë- të mbjella me zarzavaten e famshme që quhet bamje.

Dyqanet e vegjël ku shiten limonata, akulllore, musht rrushi si dhe prodhimet e ëmbla të qumështit (oriz me sheqer, oriz me sheqer dhe me lëng pule, etj), shitësit ambulantë të lëngut

## Mid'hat Frashëri

---

të fermentuar, që quhet bozë, të akulloreve, të gështenjave, të sheqerkave, të salepit etj -janë prodhime të shqiptarëve të ardhur nga Dibra dhe Prizreni.

Ata që kanë udhëtuar për Kostandinopojë, kanë vërejtur patjetër luksin dhe shijen e hollë me të cilën janë sistemuar dyqanet e këtyre prodhimeve që shtrihen njera pas tjetrës përgjatë rrugës së madhe Pera, që nga sheshi i Tunelit në Çiçli, dhe me siguri nuk i kanë harruar akulloret, limonatat dhe ëmbëlsirat e të famshmit Rexhep Aga në hanin e Bursës, në fund të urës Karakei.

Mjeshtëria e kasapit dhe të gjitha ato që rrjedhin prej saj, -shitja e të brendshmëve, trurit, këmbëve të bagëtive, mëlçisë dhe mushkrive- janë bërë monopol i shqiptarëve si në Gallatë, në Pera, në Stamboll ashtu edhe rreth e qark tyre. Korporata e këtyre kasapëve është mjaft e pasur sepse ajo është e lidhur me atë të rritësve të njohur shqiptarë të bagëtive që janë përhapur që nga mali i Sharit deri në Brus në Azinë e Vogël.

Pjesa më e madhe e furrtarëve në Kostandinopojë dhe në qytetet e tjera të mëdha të Turqisë, janë shqiptarë nga Dibra.

Një mjeshtëri tjetër ku shqiptarët janë treguar profesionistë, është ajo e ndërtimit të ujësjejsayë. Njëzet vjet më parë Pukëvili ka folur për këtë art ose më saktë për këtë shkencë që zotërohej nga banorët e një numri fshatrash në lindje të Gjirokastrës.

Konsulli i Francës na bën të ditur se shkencë hidraulike është transmetuar te këta njerëz prej disa breznish. Janë ata që ndërtuan ato që quhen ekuilibrat ujqorë, domethënë që përmirësuan nivelin ujqor 28).

Një mjeshtëri ose e thënë ndryshe një shkencë që banorët e fshatit Buhali (rajoni i Përmetit) e ushtrojnë me shumë shkathtësi dhe sukses- gjë që me sa di nuk është njoftuar nga asnjë i huaj- është ai i mjekësisë. Ata i trashëgojnë praktikat empirike nga i ati



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

te i biri, nga i ungji te nipi dhe shumë prej tyre tregojnë një zotësi shumë të madhe në operacionet e vështira kirurgjikale. Kam patur rastin të bisedoj ndërmjet Këlcyrës dhe Tepelenës me dy buhalotë dhe kam mbetur tepër i befasuar nga kostatimi se ata nuk ishin kundra dhe nuk kishin asnjë paragjykim ndaj zbulimeve shkencore mjekësore; ata i besonin teorisë së mikrobeve dhe praktikonin autopsinë me aq sa qe e mundur.

Por një mjeshtëri tjetër që shqiptarët e ushtrojnë me të vërtetë shkencërisht, është pa dyshim ajo e ndërtuesit dhe e arkitektit. Malësorët e Dibrës dhe të Ohrit kanë fituar një famë të madhe në këtë fushë dhe disa inxhinierë më kanë siguruar se rrallë mund të shohësh njerëz të thjeshtë, analfabetë që të kenë prirje kaq të madhe për një mjeshtëri e cila përgjithësisht kërkon mjaft inteligjencë dhe shumë studime paraprake.

Të tillë njerëz ndeshen kudo nëpër Turqi si në pjesën evropiane ashtu edhe në atë aziatike, që ndërmarrin punë të rëndësishme në ndërtim dhe që shkëlqejnë qoftë si punëtorë të thjeshtë në gdhendjen e gurëve qoftë si muratorë e si arkitektë.

Turqia nuk është i vetmi vend ku shqiptarët gjejnë fushë të lirë veprimi për të shpalosur cilësitë e tyre dhe për të siguruar jetesën. Në të gjitha shtetet ballkanike takohen koloni të rëndësishme, ndonëse nuk bien fort në sy.

Muratorët dhe arkitektët shqiptarë e ushtrojnë profesionin e tyre me mjaft përfitim si në Serbi ashtu edhe në Bullgari. Në këtë të fundit, madje brenda në Sofje, janë të shumta dyqanet e ëmbëlsirave, të bozës e të limonatës, ndërsa punëtorët e Dibrës dhe të Tetovës janë gjithashtu të shumtë në Vidin, në Rjustuk dhe në Varna.

Në Rumani banon një numër i madh shqiptarësh veçanërisht në Bukuresht dhe në Kostancë. Në këtë të fundit shqiptarët (të ardhur nga Proгри, fshat afër Korçës), ushtrojnë

## Mid'hat Frashëri

---

mjeshtërinë e tyre të muratorit dhe arkitektit; të tillë gjenden gjithashtu edhe në Mexhidia (në Dobrush). Ndërsa në Braila shqiptarët me origjinë nga Negovani, pranë Follorinës, janë karpentierë dhe sipërmarrës të ndërtimeve dhe punimeve në dru.

Veprimtaria dhe inteligjenca e këtyre artizanëve shqiptarë duhet të jetë e njohur shumë larg, sepse ja ç' thotë profesori i spikatur Gelciç në veprën e tij, 29):

“Shqipëria, tokë e bekuar për prodhime të ndryshme e të bollshme qysh nga kohërat e Balsidëve, sheh të ankorohen në brigjet e saj ato çka industrinë evropiane sillnin në këmbim të grurit, të drurëve të mrekullueshëm, të metaleve të çmuara, të kafshëve të rralla, ndërkohë që përkushtimi me devotshmëri i misionarëve kishte mbajtur gjallë tek ata ndjenjën fetare si dhe dashurinë për letërsinë dhe shkencat. Shqiptari, inteligjent nga natyra dhe i pajisur me shije tepër të hollë, i kishte zbukuruar qytetet e tij me monumente artistike shumë të vyera. Atyre ua zunë vendin kullat me një sy dhe kështjellat e ftohta veneciane.

Përpara grykësisë së zjarreve që bënë shkrumb e hi këto qytete të mjerë, heshtën përgjithmonë shumë ofiçina që jo vetëm në Ballkan por në të dy brigjet e Adriatikut deri në Maqedoninë e Largët shquheshin për punime të mrekullueshme në argjend, fildish, korale, ndërsa kamat, armët dhe sendet prej bakri të punuar mjaft hollë, konkuronin edhe ato të Damaskut. Jorganët të qëndisur me fije ari, që deri në atë kohë përdoreshin si dekoracion për bukuritë gjeniale të Ballkanit, vinin të gjitha nga Shqipëria...

Emigracioni shqiptar vazhdonte parreshtur qysh nga koha e Teutës dhe Gencit duke kontribuar ngadale-ngadale në rritjen e qyteteve dalmate nëpërmjet Katarit dhe Rraguzës; në ditët e Balsidëve kjo veprimtari ndërtuese u gjallërua më tepër.

E ndërkaq arti romak që në Dalmaci, qysh nga lindja e tij, kishte patur në Shqipëri frymëzimet dhe apostujt e parë, do të

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

arrinte shkëlqimin e tij të vërtetë në gjysmën e dytë të viteve 300, domethënë në epokën fatale që i përgatitën Shqipërisë shekujt e robërisë dhe që detyruan të mërgonin përgjithmonë shumë gjeni të gjithanshëm duke kontribuar në shkëlqimin moral dhe material të mjaft qyteteve bregdetare dalmate ku shqiptarët gjetën një mikpritje vëllazërore dhe punë të përhershme e frytdhënëse.

Shumë familje që sot e quajnë veten dalmate, rrjedhin pikërisht nga refugjatët e hershëm të asaj kohe. Shumë vepra që sot konsiderohen si produkt i gjenialitetit dalmat, nuk janë veçse krijime mjeshtërore e të papërsëritshme shqiptare.”

Kemi thënë më lart se shqiptarët në Kostancë dhe në Mexhidia janë muratotë, ndërsa ata në Braila janë karpentierë. Por shqiptarët në Rumanë ushtrojnë edhe mjeshtëri të tjera; ata të Bukureshtit, që duhet të jenë disa mijëra të ardhur nga krahina e Korçës, janë tregtarë, bakallë ose shitës pijesh. Ata janë të krishterë ashtu si edhe bashkëatdhetarët e tyre në Kostancë dhe në Braila. Por përveç këtyre ka mëse 10.000 shqiptarë të tjerë të ardhur nga Dibra, Gostivari, Kërçova dhe Tetova.

Shqiptarët e Dibrës janë të shpërndarë në të gjitha fshatrat dhe qytetet e zonës Valaki për të ushtruar tregtinë e vogël duke hapur dyqane kinkalerie ku shihen cikërrima por edhe pëlhura prej pambuku dhe leshi.

Një deputet rumun më thoshte kohët e fundit se shqiptarët në Valaki luajnë një rol të ngjashëm me atë të çifutëve në Moldavi duke shtënë në dorë të gjithë tregtinë e vogël, sepse disa qindra ndër ta ushtrojnë tregtinë e vezëve, të pulave, të lëkurëve të deleve dhe të dhive. Të ardhurit nga Dibra pasohen në këto veprimtari nga banorët e ardhur nga Tetova. Ndërsa shqiptarët e ardhur nga Gostivari përgjithësisht mbajnë dyqane karamesh, ëmbëlsirash dhe limonatah. Ata të Kërçovës ushtrojnë kryesisht funksionet e rojës, të mbikqyrësit ose të administrimit në depo të mëdha, në

magazinat dhe pronat rurale.

Të gjithë shqiptarët e Dibrës, Gostivarit, Kërçovës, Tetovës janë muslimanë dhe shumë lexues padysim do të habiten kur të mësojnë se ndërmjet tyre ka njerëz që kanë aftësi për tregti dhe për më tepër ka nga ata që ua kalojnë për zotësi edhe çifutëve 30).

Fakt është se ato që kemi përmendur më lart nuk janë të vetmet, ka edhe banorë nga Gjakova që kanë një prirje tepër të zhvilluar për tregti, tregtarë shumë të mëdhenj që ndeshen në Shkup, Mitrovicë, Prishtinë dhe në të gjitha qytetet e rëndësishme të Shqipërisë së Veriut, janë me prejardhje nga Gjakova.

Dhe është një numër i madh prej tyre që kanë llogari bankare në Selanik dhe në Kostandinopojë. Shpirti tregtar është po ashtu shumë i zhvilluar tek muslimanët e Dibrës si dhe tek banorët e Shkodrës, qofshin muslimanë apo katolikë.

Shkodra zhvillonte një tregti të gjerë me Italinë dhe Francën dhe ende sot mund të shohësh në Shkodër magazina të mëdha nga ku pëlhrat e mëndafshta dhe kadifeja të ardhur nga manufakturat evropiane, niseshin drejt Kostandinopojës dhe Rumelisë.

Një numër i madh shqiptarësh kanë qenë vendosur në Venecie, në Trieste, në Vjenë ku kishin arritur suksese të mëdha. Fatkeqësisht qysh prej një shekulli, kjo tregti ka marrë rugë të tjera dhe tani magazinat shkodrane janë fare bosh.

Një gjë duhet pasur parasysh: Shitësit dhe tregtarët shqiptarë gëzojnë një reputacion shumë të mirë ndershmërie sipas shembullit të kavass-ëve dhe të rojeve, të cilët kanë merituar çdo besim.

Drejtorët e bankave të Selanikut thonë se nuk kanë asnjë ankim për marrëdhëniet e tyre me shqiptarët. Zakonisht transaksionet ndërmjet shqiptarëve bëhen verbalisht me gojë, pa asnjë shkresë, pa garantë, pa kontrata. Nëse huamarrësi vdes, trashëgimtari i tij para së gjithash nxiton të shlyejë huanë e të

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

ndjerit.

Nje trëgtar i pasur rumun më tregonte në Bukuresht se shqiptarët që jetonin në Rumani e që ushtronin tregtinë e manufakturave, mjafton t'i drejtoheshin shtëpisë së familjes Nikulesku të Bukureshtit dhe atyre u jepej menjëherë kredi pa kërkuar asnjë lloj garancie por vetëm mjaftonte vërtetimi se ata ishin shqiptarë.

Përveç se në Turqi, Bullgari dhe në Rumani, një numër i madh shqiptarësh që shkojnë për të kërkuar punë dhe për të siguruar jetën e tyre, gjenden edhe në Greqi, në Serbi dhe në Bosnjë. Në Greqi shqiptarët punojnë si punëtorë krahu në kanale drenazhimi dhe në punët e ndryshme të fushës. Në Serbi dhe në Bosnjë ata janë më shumë shitës ëmbëlsirash, boje, salepi, limonata dhe akulloresh. Që të gjithë janë muslimanë nga Shqipëria e Veriut, Prizreni, Dibra, Gostivari dhe kudo ata tregojnë një qëndrueshmëri të lartë në punë duke mos u kursyer të punojnë edhe natën.

Një mjek që i ka njohur dhe i ka studiuar shqiptarët në Bosnjë, admiron shpejtësinë e tyre në punë dhe shton:

“...Shtytjen e jetës në Bosnjë - Hercegovinë e dhanë shqiptarët 31). Ata ishin tregtarë të zellshëm, njerëz të aftë për veten por edhe që ndihmonin të tjerët. Si tregtarë ishin mjaft aktivë dhe të zgjuar por edhe të ndershëm dhe të zellshëm. Gjithashtu si zanatçinj tregonin vullnet të fortë”32).

Shumë shqiptarë jo më pak aktivë, punëtorë dhe të ndershëm janë vendosur edhe në Egjipt, ndërsa një numër akoma më i madh (afro 80.000 tani për tani), sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku pjesa më e madhe punon në fabrika si punëtorë të thjeshtë, me përjashtim të atyre të ardhur nga fshatrat e quajtura Vakëf (rajoni i Kolonjës) që janë specialistë të drurëve dhe të dërrasave, mjeshtëri që e ushtrojnë edhe në rajone të ndryshme të Bullgarisë.

## Mid'hat Frashëri

---

Unë mund të shtoj me një ndjenjë kënaqësie të ligjshme se shqiptarët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vlerësuar si punëtorë të ndershëm, të përkorë, të ndërgjegjshëm dhe se janë preferuar ndaj racave të tjera ballkanike.

\*  
\*       \*       \*  
\*

Çfarë ideali kanë këta kolonë në vendet ku mërgojnë dhe cila është ideja që kalit moralin e tyre dhe rrit qëndrueshmërinë ndaj lodhjeve dhe vështirësive?

Kjë është dëshira për t'u kthyer të pasur në vendin e tyre. Të gjithë shqiptarët që lenë malet dhe fushat e tyre, largohen me idenë për t'u kthyer një ditë në vatrën amtare dhe për t'i ngrysur aty ditët e tyre. Prandaj mund të themi se nuk ka emigrantë të vërtetë shqiptarë dhe se janë shumë të paktë ata që ngulen jashtë vendit të tyre e që qëndrojnë atje. Pjesa më e madhe kthehen në atdhe, të pushtuar nga malli mbas pak vitesh që mund të shkonjë nga pesë deri në njëzet vjet 33).

Shqiptari ka kultin e shtëpisë dhe të familjes. Solidariteti ndërmjet anëtarëve të së njëjtës familje, është i habitshëm: jo vetëm takohen - sidomos në verë - 150 deri në 200 vetë që jetojnë nën të njëjtën çati në harmoni të plotë, por gjithashtu - dhe kjo është më e shpeshhtë - ka njerëz që rropaten për vite të tëra jashtë vendit të tyre dhe ia dërgojnë fitimet një vëllai, i cili drejton shtëpinë, familjen e madhe dhe kështu mban gjallë dhe të paprekur nderin dhe prestigjin e krejt familjes.

Ky vëlla që qëndron në shtëpi është gjithmonë i martuar, ka grua dhe fëmijë, ndërkohë që të tjerët, autorët e vërtetë të begatisë së vatrës u nënshtrohen mijëra halleve dhe nuk martohen, përveç rasteve kur të ardhurat e tyre janë aq të mëdha sa të

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

plotësojnë nevojat e shtëpisë, ose kur anëtarë të tjerë të familjes kanë mundësi të mërgojnë, gjë që sjell të ardhura shtesë.

Në Shqipëri nuk ka raste që një nënë, një motër ose gjyshe të braktiset nga njerëzit e vet. Femrat dhe pleqtë mbahen gjithmonë nga fëmijët e tyre dhe në mungesë të tyre, mbahen nga nipat, mbesat ose kushërinjtë qofshin edhe tepër të largët. Gjithashtu, kurrë një shqiptar nuk do të mendonte për veten dhe punët e tij pa rregulluar më parë motrën e tij, qoftë ajo edhe shumë më e re se ai.

Ky solidaritet i madh i familjes shqiptare, spjegon solidaritetin e fisit dhe atë të kombit. Dy shqiptarë me fe të ndryshme dhe nga krahina të ndryshme, kur takohen jashtë vendit të tyre e quajnë njeri-tjetrin vëllezër; ata ndihmohen reciprokisht dhe ndajnë ndërmjet tyre edhe bukën e gojës. Në Shqipëri dasitë lokale dhe hakmarrja nuk e cënon aspak këtë ndjenjë.

Një njohës i popujve të Lindjes së Afërt, me të drejtë ka thënë:

“Shqiptarët kanë një ndjenjë shumë të spikatur solidariteti dhe të interesave të tyre të përbashkëta, pa dallim besimi dhe dialekti. Më 1879, kur traktati i Berlinit i dha Malit të Zi një rajon të banuar prej shqiptarësh, ata themeluan një “Lidhje Shqiptare” dhe u mobilizuan që të gjithë nën armë, të krishterë dhe muslimanë, në ndihmë të vëllezërve të tyre që ndodheshin në rrezik” 34).

“Ata shquhen për një solidaritet etnik të fuqishëm, të qëndrueshëm dhe gjithmonë në rritje”, thotë një autor tjetër që e ka njohur Shqipërisë deri në skutat më të thella 35).

Ky popull ka një ndjenjë shumë të fortë të prejardhjes së përbashkët dhe të lidhjes së gjakut. Duke qëndruar në majë të shkëmbenjve, qysh nga koha e Iliadës ata kanë parë të kalojnë poshte këmbëve të tyre pushtues të ndryshëm: romakë nga

## Mid'hat Frashëri

Perëndimi, gjermanë dhe sllavë nga Veriu, mongolë nga Jugu dhe Lindja. Vazhdimisht tokat e tyre janë pushtuar nga serbët, bullgarët, turqit dhe grekët gjë që i ka bërë të ruajnë një ndjenjë tepër të lartë solidariteti të racës së tyre, kështu që rreziku i armikut i gjen gjithmonë të lidhur e të bashkuar...”36).

Me kultin e familjes dhe si pasojë e kësaj ndjenje, shqiptari ka gjithashtu kultin e shtëpisë, të vatrës. Mbasi ka bërë pak pasuri, ai ka vetëm një dëshirë: të kthehet në vendin e tij dhe të ndërtojë një shtëpi më të mirë dhe më të bukur se sa ajo e vjetra. Në shumë fshatra mund të dallosh ata që kanë qenë në Amerikë vetëm duke numëruar banesat e ndërtuar rishtaz.

Gjashtë vjet më parë unë kam numëruar në fshatin Bënçë të Tepelenës, një fshat i humbur në një grykë mali, njëzet e tre shtëpi të reja, komode dhe më të bukura se të tjerat: në fshat ishin 23 të rinj që kishin punuar për disa vjet në Shtetet e bashkuara të Amerikës 37).

Të gjithë ata që punojnë dhe rropaten në Kostandinopojë, në qytetet e tjera të mëdha të Turqisë ose jashtë saj, rikthehen në vendin e tyre me sende të çmuara të nevojshme për shtëpinë ose që shërbejnë thjesht për zbukurim, për luks.

Shërbyes të thjeshtë kur kthehen për pushime në shtëpitë e tyre, janë krenarë të sjellin sende të nevojshme që shërbejnë për zbukurim si tapete të Orientit dhe vazo të çmuara.

Nuk është çudi pra që kur e kalon natën në shtëpinë e një shqiptari, si në Jug ashtu edhe në Veri, të flesh me çarçafë mëndafshi dhe të fshihesh me një peshqir të qëndisur anash me fije ari. Luksi është një nevojë për shqiptarin, si për veshjen e tij ashtu edhe për objektet që e rrethojnë: kjo është krenaria e tij, për luksin ai jeton dhe i nënshtrohet punës.

\* \* \*



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

Në Shqipëri shtëpitë janë gjithmonë prej guri të gdhendur, të forta dhe të mira. Mund të thuash pa frikë se fshatrat shqiptare dallojnë- nga cilësia dhe bukuria e shtëpive të tyre- nga fshatrat serbë, bullgarë e rumunë.

Një oficer slloven që kishte udhëtuar nëpër Shqipëri, na thoshte se rrallë herë kishte parë gjatë udhëtimeve të tij nëpër Evropë- përfshirë edhe Hollandën- fshatra aq të begata si ato të Devollit, rajon që ndodhet në lindje të Korçës. Një tjetër udhëtar fliste me një admirim të thellë për shtëpitë që kishte parë në fshatrat e Gollobordës, në jugperëndim të Dibrës.

Ndonëse në Shqipëri ka rajone të varfëra, nga ana tjetër gjenden krahina mjaft të pasura ku natyra dhe njeriu kanë krijuar një mirëqënieje të vërtetë. I tillë është përshkrimi i ultësirës ndërmjet Pejës dhe Gjakovës:

“Vendi deri më sot është në gjendje të mirë. Fushat janë të mbjella me misër dhe parcelat janë të shëndetshme e të pasura me ujë. Edhe fshatrat janë në gjendje të mirë. Aty nuk sheh kasolle, veçse ndërtesa prej guri. Jeta rrjedh normalisht dhe gjithë njerëzit punojnë në bujqësi. Punojnë edhe gratë që nuk shihen të mbajnë fereixe. Ky është vend i begatë”**38**).

Pikërisht kundër kullave, shtëpive të forta dhe të qëndrueshme, ka shpërthyer terrori i xhonturqve gjatë viteve 1909-1911, të cilët shkatërruan, me vetëdije dhe me gjyle topash, disa mijëra banesa. Por një terror akoma më i madh ka qenë ai i serbëve, të cilët rrafshuan me themel disa dhjetra fshatra dhe veçanërisht më 1913 në njëzeteshtatë fshatra të Gollobordës-ndërmjet Dibrës dhe Elbasanit- shkatërruan shtëpitë e mrekullueshme, për të cilat folëm më lart.

Por shkatërrimet e turqve dhe të serbëve duken vogëlsira në krahasim me ato të grekëve, të cilët zhdukën nga faqja e dheut

## Mid'hat Frashëri

---

mëse 300 fshatra të shpëtuara në Jug. Dhe në rast se turqit mund të kenë nxjerrë si shkak besimin e tyre tek Muhamedi, i cili urdhëron që të mos kihet asnjë mëshirë për “të pafetë”, serbët dhe grekët sipas almanakut të Gotha-s i përkasin besimit të Atij që ka predikuar dashuri dhe humanizëm.

“Në sheshin e madh të qytetit të Delvinës ne shohim gërmadhat e para të shkaktuara nga bandat greke të Zografos, të cilat rrënuan me një tërbim të madh shtëpitë e muslimanëve. Shkatërrimi që sistematik.

Që Shqipëria Jugore të bëhej greke, duhej zhdukur elementi musliman: ja shkak i vërtetë i masakrave të kryera në Epirin e Veriut dhe i plaçkitjeve të më shumë se 400 fshatrave, rrënojat e të cilave i kemi ndeshur ndërmjet Delvinës dhe Tepelenës si dhe në gjithë Kurveleshin” 39).

I njëjti korrespondent shkruan më vonë një tjetër letër që flet për Shqipërinë, nga e cila po shkëpusim këtë fragment:

“... I gjithë rajoni i Kolonjës është shkretuar gjatë kalimit të bandave dhe ushtrisë greke më 1914.

Emrat që gjenden në hartë nuk janë veçse kujtime; në terren ato paraqiten si disa gërmadha pa formë që tregojnë vendin e fshatrave muslimane. Në grumbuj kashte aty këtu fshihen njerëz fatkeqë që jetojnë në mënyrë të mjerë duke punuar në ndonjë fushë orizi. Kudo ndihet urrejtja e njeriut për atë që nuk është i racës dhe i fesë së vet” 40).

Duke parë numrin e fshtarave dhe të pasurive të shkatërruara nga serbët dhe grekët (1913-1914), nuk është aspak e tepruar shifra e dëmit material që ka qenë vlerësuar në 400.000.000 franga, të cilat sot janë afërsisht një miliard duke patur parasysh edhe rritjen e çmimeve gjatë këtyre pesë vjetëve.

Por mjaft folëm për shkatërrimet, le ta mbyllim këtë parantezë dhe të rikthehemi te shqiptarët, tek ata që ndërtojnë dhe

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

rimëkëmbin.

Kemi thënë se jo të gjitha pjesët e Shqipërisë janë të pasura dhe pjellore, se ka rajone të varfëra ku njerëzit mezi nxjerrin bukën e gojës dhe atëhere ndjejnë nevojën për të punuar jashtë vendit të tyre, por gjithmonë me dëshirën që një ditë të rikthehen dhe ta kalojnë jetën aty.

Lidhja me atdheun është shumë e fortë tek ky popull dhe pavarësisht se ku ndodhet shqiptari, se ç'pozitë ka ai, shpirti i fluturon pa rreshtur drejt vendlindjes, drejt shkëmbinjve, kodrave, maleve ose lëndinave të vogla që lidhen me kujtimet e fëmijërisë së tij.

Kështu shpjegohet krijimi i shoqatave të shumta patriotike që janë themeluar nga shqiptarët jashtë në Egjipt, në Rumani, në Bullgari, në Amerikë si dhe përpjekjet për rimëkëmbjen e atdheut qysh nga punëtori i thjeshtë dhe analfabet 41).

\* \* \*  
\*

Mbasi kemi folur shkurtazi për karakterin moral të shqiptarëve, për aftësitë e tyre dhe për ç'ka janë të zotët të bëjnë, dëshirojmë të themi edhe dy fjalë për cilësitë e tyre fizike, megjithëse kjo është një çështje e dorës së dytë.

Siç thotë një antropolog që ka studiuar racën shqiptare, nga kjo pikëpamje "pjesa më e madhe e udhëtarëve janë befasuar nga bukuria fizike e shqiptarëve" 42).

Pukëvili, të cilin e kemi cituar disa herë, flet me admirim për çamët, fis shqiptar që banon në bregun e Adriatikut, që shtrihet nga Delvina në Prevezë, qendrat e të cilët janë Filati dhe Margariti. Në një çast konsulli i Francës pranë Aliut të Janinës, gjen një frymëzim lirik dhe shkruan:

## Mid'hat Frashëri

---

“Myzeqeja (fushë që shtrihet në veri të Vlorës) dhe luginat e Tomorrit (mal në lindje të Beratit) fshehin thesare bukurie të denja për kurorat e dashurisë” 43).

Çamët, ku përfshihen edhe suliotët, banorët e Kosovës, ata të Pejës si dhe të Prishtinës, janë djemtë më të bukur dhe më të fuqishëm. Është e pamundur t’i shohësh ata pa admiruar shtatin e tyre të lartë, mjaft mbi mesataren, dhe ecjen e tyre krenare. Një njohës i pupujve të Ballkanit ka thënë me të drejtë se:

“Shqiptarët janë ndoshta raca më e bukur e Turqisë..., ndërmjet tyre mund të gjesh tipa të denjë për t’u marrë si model për Afërditën dhe Apolonin...”44).

Shumë udhëtarë të tjerë e kanë miratuar mendimin e Ami Bue (45), ndërsa para tij një dijetar gjerman që ka udhëtuar në Greqi, flet kështu për shqiptarët:

“Në Athinë, nën një qiell mjaft të pastër, femrat kurdoherë kanë qenë më pak të bukura në krahasim me të tjerat, dhe ende sot janë ndër më të shëmtuarat e Greqisë. Por nuk mund ta themi këtë për shqiptarët e bukura që banojnë në qytetin e Athinës, sepse ato janë një racë krej e huaj” 46).

Ndërsa një shkrimtar i shquar dhe poet bashkëkohor ka gjetur bukur një frazë mikluese për shqiptarët që ka njohur në Korfuz:

“Tipet më të fisme në Korfuz ishin ende shqiptarët me fustanella të bardha” 47).

I quajmë të mjaftueshme këto pak fjalë si dhe citimet e mësipërme mbi fizikun e shqiptarëve. Le të merremi pak tani me karakterin intelektual të kësaj race dhe të përpiqemi të shohim nëse ajo ka cilësi të larta shpirtërore, nëse ajo është me të vërtetë inteligjente, nëse truri i saj është i aftë për punë, për të prodhuar diçka mbi të zakonshmen.

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

\*  
\*            \*  
\*

Arnautët në Turqi gëzojnë namin si njerëz inteligjentë, me një shpirt të pasur, që meritojnë emrin e tyre të mirë. Profesoret dhe mësuesit e shkollave na kanë siguruar se nxënësit më të mirë të klasave ishin shqiptarët dhe se në konkurset janë vetëm apo kryesisht ata që marrin çmime.

Tani së fundi një inxhinier në Rumani më thoshte se shqiptarët që shesin bozë, mbahen përgjithësisht si njerëz shumë inteligjentë dhe të mësuar në fshatrat e mbretërisë moldo-valake. Të tillë emër të mirë kanë shqiptarët në Bullgari si dhe në Serbi deri në kryeqendrën e tyre Beograd.

Në Turqi përveç artizanëve dhe punëtorëve, ndeshen kudo në Kostandinopojë si dhe në qytete më të largëta të Azisë së Vogël, një numër i madh funksionarësh otomanë me origjinë shqiptare që kanë pasur poste në të gjitha degët dhe nivelet e administratës.

Dhe përgjithësisht në fakt, këta funksionarë shqiptarë bëjnë karrierë shumë më shpejt se turqit dhe janë mjaft të vlerësuar prej tyre. Nuk ka qenë ndonjë gjë e rrallë që një udhëtar të takonte një gjykatës, një prokuror, një oficer, një gjeneral ose një prefekt shqiptar. Ndokush madje thotë se funksionarët më të mirë otomanë, kanë qenë shqiptarët.

Një konsull i Francës që ka jetuar për një kohë të gjatë në Veri të Shqipërisë, nuk nguron të thotë se “natyra e ka pajisur shqiptarin me një inteligjencë të rrallë” 48).

Hekuard, në faqe të tjerë të veprës së tij, flet me dashuri për elokuencën që zotërojnë shqiptarët dhe bën një protret mjaft miklues për femrën tonë.

## Mid'hat Frashëri

---

Nga ana e tij shkrimtari që i ka ngritur një monument gjeografisë dhe që e ka bërë një shkencë të vërtetë, përsa i përket racës sonë thotë:

“Kështu shqiptarët kanë hyrë në lëvizje të përgjithshme, por kur ata hyjnë na marrëdhënie të vazhdueshme me popujt e tjerë mund të shpresohet me të drejtë se ata do të luajnë një rol të rëndësishëm sepse ata në përgjithësi shquhen për një finesë shpirtërore, qartësi mendimi dhe forcë të veçantë karakteri 49).

Ky opinion i Reklusit konfirmohet nga pasazhi që vijon, të cilin e kemi nxjerrë nga njëri prej librave të rrallë të mirë të shkruar në kohët tona për shqiptarët:

“Shqiptarët janë një popull fëminor. Kur atij t’i jepet me kujdes dhe me mençuri një impuls energjik në rrugën e rendit dhe të arsmimit, nuk ka asnjë dyshim se do të zërë me shpejtësi vendin e vet ndërmjet kombeve të qytetëruar.

Të mos harrojmë se shqiptarët janë mjaft inteligjentë. Qysh në kohën e pushtimi tonë të ishujve të Jonit në fillim të shekullit XIX, oficerët tanë janë mahnitur se sa me lehtësi banorët vendas kanë mësuar prej tyre sistemin metrik” 50).

Së fundi, le të shohim opinionin e mirë të dijetarit të madh dhe antropologut, profesor Virçov. Është Bllouic, korrespondent i gazetës “Times” që na përcjell bisedën e tij me profesorin e mësipërm. Në kabinetin, ose më mirë në muzeun e tij më 1878, gjatë zhvillimit të Kongresit të Berlinit, të mbajtur të nesërmen e luftës ruso-turke, duke folur për racat e ndryshme të Ballkanit, profesor-dijetari ngrihet me rrëmbim:

“Qëndroni, tha Virçov, ja raca me të vërtetë superiore e këtyre vendeve. Shikojeni këtë”. Dhe ai më vuri përpara tri kafka krejt të ngjashme.

“Njëri nga kolegët tuaj më ka sjellë të parën dhe më pas unë gjeta edhe dy të tjerat. Janë kafka shqiptarësh të vrarë prej

turqve. I vëreni me kujdes këto kafka: a nuk janë të bukura? A nuk janë madhështore?

Kur më ra në dorë kafka e parë, mendova se mos ishte ndonjë rastësi. Por pashë se të gjitha kafkat e shqiptarëve janë krejt të ngjashme mes tyre. Ja raca superiore mbi të gjitha të tjerat!”

Dhe dr. Virçov përkëledhte me një ëmbëlsi entuziazte kafkën në fjalë që e mbante ndër gjunj. Pastaj, mbasi u ngrit dhe e vuri kafkën me kujdes në dysHEME, nisi të përcaktojë me pak fjalë popujt e ndryshëm të Turqisë evropiane dhe në mbështetje të çdo opinionit që jepte, tregonte modele kafkash malazeze, boshnjake, dalmate, serbe, bullgare, rumune, turke dhe hungareze. Pak nga pak ai i kishte shtuar provat mbështetëse dhe më në fund bëri demonstrimin e tij në qendër të një rrethi të plotë të formuar nga kafka të dimensioneve të ndryshme dhe pak a shumë të dëmtuar nga armë të ftohta dhe armë zjarri.

Ishte kongresi që çuditërisht do të gjykonte nga pikëpamja e (kraniologjisë). Por gjithmonë ai i rikthehej atyre kafkave shqiptare dhe kur fliste përkulej për t'i prekur me gishta, ndërkohë që të tjerat i tregonte me majën e këmbës...51).

Por do të ishte më mirë të shihnim nëse kjo aftësi intelektuale e racës dhe vlerat e saj të larta, janë shfaqur në një mënyrë ose në një tjetër, nëse me pak fjalë, ka patur ndërmjet shqiptarëve njerëz të mëdhenj që janë ngritur mbi mesataren.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ne do të mjaftohemi të riprodhojmë katu atë ç'ka kanë shkruar të huajt, tri vjet më parë, në një studim të shkurtër (52), i cili ka qenë vetëm një ekstrat i një vepre të vogël të publikuar.

\*  
\*       \*  
\*

Ashtu si intelijenca edhe aftësia e vullneti i shqiptarëve, nuk janë vënë kurrë në dyshim. Ka shumë që mendojnë se natyra e ka pajisur mirë shqiptarin në këtë raport.

Ndërmjet figurave të ndritura të kohërave moderne, gjendet një numër mjaft i madh shqiptarësh, njerëz të shquar që meritojnë një vëmendje të posaçme dhe kjo sidomos po të merren parasysh rrethanat në të cilat ka jetuar kjo racë si dhe vështirësitë e panumërta me të cilat është ndeshur.

Historia e Turqisë tregon një listë të gjatë shqiptarësh që kanë patur poste nga më të lartat në Perandori dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në të gjitha degët e administratës.

Një libër turk (53) numëron 18 vezirë të mëdhenj shqiptarë ndërmjet 172 të tillë qysh nga koha e themelimit të Perandorisë deri në ditët e Selimit III.

Ndërmjet këtyre vezirëve të mëdhenj i pari në kohë është Ajaz pasha në vitin 942 në kohën e sulltan Sulejmanit; pastaj vijnë më radhë: Kara Ahmet pasha, Ahmet pasha, Sinan pasha, Ferhat pasha, Jemiçxhi Ahmet pasha, Mene Husein pasha, Dabani Jasi Mehmet pasha, Kara Mustafa pasha, Murat pasha, Tarhunxhi Ahmet pasha, Qyprili Mehmet pasha (54), Qyprili Zade Fazil Ahmet pasha, Qyprili Zade Mustafa pasha, Qyprili Zade (ose më mirë Amuxha Zade) Hasan pasha, Qyprili Zade Numam pasha, Halil pasha, Arnaut Memih pasha etj.

Në këtë listë duhen shtuar edhe pesë vezirë të tjerë të mëdhenj, të cilët autori në fjalë nuk i përshkruan si shqiptarë por prejardhja e tyre nuk lë asnjë dyshim mbi racën: Arabaxhi Ali pasha (Ohër), Daltaban Mustafa pasha (Manastir), Damad Hasan pasha (More), Topal Osman pasha (More), Alemdar Mustafa pasha

..



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

(lindur në Rustçuk, Bullgaria e sotme, por me prejardhje nga një familje shqiptare).

Gjatë epokës së sulltan Selimit III ka patur tre vezirë të mëdhenj shqiptarë: Mustafa Nail pasha (nga Pojani afër Korçës por i quajtur gabimisht Guintli nga Kreta), Halil Rifat pasha (lindur në Melnik por nga prindër shqiptarë) dhe Ferit pasha Vlora.

Kështu numri i përgjithshëm i vezirëve të mëdhenj që kanë drejtuar punët e Perandorisë së madhe otomane, ngjitet në njëzetepesë.

Por autori i Hadikat-ul-Vuzera, hesht mbi origjinën dhe racën e tetë vezirëve ndër të cilët ka shumë mundësi që nja dy të tjerë të jenë me prejardhje shqiptare.

Po e kalojmë në heshtje katalogun e pasur të një numri mjaft të madh pashallarësh të dorës së dytë, komandantë ushtrish, prefektë të përgjithshëm etj, që shënohen sipas shkallës së shërbimeve të tyre. Por, nuk mund të lëmë pa tërhequr vëmendjen e lexuesit mbi tre vezirë të mëdhenj të cilët e kanë çuar në kulm famën e ushtrisë perandorake turke: Sinan, Ferit dhe Qypri.

Si ekonomistë Tarhunxhi Ahmet pasha (i përmendur më lart) dhe Koçi bej (ky i fundit nga Korça), janë të vetmit emrë të mëdhenj në Turqi.

Në fushën e arteve Turqia ka patur disa gjeni si arkitekt Kasëm, lindur në fshatin Gramsh pranë Beratit, autor i xhamisë së bukur Jeni-Valide pranë urës Kara-Kei në Stamboll; arkitekti Ahmet aga ose më mirë Biçakxhi. Ahmet aga duhet të jetë nga Elbasani, autor i xhamisë së sulltan Ahmetit, në sheshin e hipodromit si dhe autor i shatërvanit të mrekullueshëm përpara portës së sarajit të vjetër, mbrapa ministrisë së Drejtësisë; po ashtu gjeniali i vërtetë, vetë Sinani me origjinë nga Tepelena, autor i xhamisë madhështore të sulltan Sulejmanit në Stamboll,

## Mid'hat Frashëri

---

autori i xhamisë tjetër të sulltan Selimit në Andrianopojë, pra vetë Sinani autor i mëse 200 veprave që mund të quhen kryevepra, është me origjinë shqiptare sipas mendimit të një historiani turk bashkëkohor 55).

Në Greqi janë emrat e shqiptarëve Boçari, Miauli, Xhavella, Bubulina dhe shumë të tjerëve që ndriçojnë qartë në historinë e luftimeve për pavarësi dhe që janë shembujt më të bukur në punët e armëve.

Në Moldo-Valaki tri familje Gjika, Lupu dhe sidomos ajo Duka kanë dhënë princa të shquar me personalitetin e tyre.

Ndër tre përfaqësuesit e familjes Lupu (Vasili, vëllai i tij Mateu dhe i biri Stefani), i pari, Vasili, princ i Moldavisë në vitet 1634-1654 meriton pa mëdyshje lavdet më të mëdha në përpjekjet e tij të parreshtura për përhapjen e arsimit, për themelimin e një shtypshkronje dhe për ngritjen e kishës së mrekullueshme të Lasit.

Familja Gjika me prejardhje nga Përmeti në Shqipërinë e Jugut, i ka dhënë Moldo-Valakisë 11 princër: Gregor, Gregor I, Gregor II, Aleksandër Mateo, Karl, Mateo II, Aleksandër II, Gregor III, Gregor IV, Aleksandër X, dhe Gregor Aleksandër.

I pari Georg Gjika, është themelues i një dinastie dhe ka mbretëruar në Moldavi disa muaj në vitin 1658, pastaj në Valaki nga viti 1658 deri në vitin 1695. I fundit, Gregor Aleksandër Gjika ka mbretëruar në Moldavi që nga viti 1849 deri në vitin 1856.

Shrimtarja Dora D'Istria (1828-1888), e lindur princeshë, Elena Gjika, vajza e princit Mikel Gjika, në veprat e saj kujton me krenari dhe me një naivitet femëror origjinën e saj shqiptare.

Do të përmendim emrat e dy princëve Duka, Georg Duka (1674-1678) dhe birin e tij Kostandin Duka (1678-1683), për të cilët ndonjë autor i huaj mendon se ata janë me origjinë shqiptare.

Por edhe vetë Capo D'Istria, kryetari i parë i Greqisë së pavarur ka qenë një shqiptar me origjinë nga Gjirokastra.

## **Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim**

Megjithëse kishte lindur në Korfuz, ende sot në Gjirokastrë të tregojnë shtëpinë e familjes së tij.

Themeluesi i shtëpisë KHEDIRIALE të Egjiptit, Mehmet Ali Pasha, i quajtur gabimisht nga turqit Kavalali (56), ka qenë një borgjez i vogël lindur në Voskopojë, tetë kilometra në perëndim të Korçës. Biri i tij i adoptuar, strategu i madh Ibrahim Pasha, ka qenë një tjetër shqiptar i lindur nga një ushtar shqiptar, që nëse nuk do të ndërhynte e alarmuar Evropa, do të ishte edhe sot e kësaj dite sulltan i brigjeve të Bosforit.

Në Itali është padyshim familja e madhe Albani (57) që ndriçon më fort emrin shqiptar. Kjo familje ka dhënë papën Klemente XI (1700-1721) dhe një pishtar të talentuar Françesko Albani (1578-1660). Këto emra si dhe ai i Françesko Krispit, kryeministër italian jo shumë kohë më parë, tregojnë se gjaku i shqiptarëve përtej Adriatikut nuk ka mbetur pa dhënë emra dhe personalitete të shquar.

Njerëz si Arsaki, Zapa, Zografos provojnë se shqiptarët janë të aftë edhe për tregti e për operacione të mëdha financiare, ashtu si edhe për shpatë dhe për diplomaci. pa shkuar shumë larg në historinë e lashtë për të kërkuar emra të tjerë me të vërtetë të shquar si Pirro, Teuta, Filip, Spata, Aranit dhe Skënderbej; pa hyrë në disertacionet dhe jetëshkrimet e shumta mbi Aleksandrin e madh dhe perandorët romakë Decius, Claudius, Aurelianus, Probus, Diocletianus, Galerius, Costantin, Licinius, Jovianus, Constantus, Marcianus, Leo dhe Anastasius (që të gjithë me prejardhje nga rajonet e banuara në ato kohëra nga ilirët, si pasojë prej një race nga e cila rrjedhin shqiptarët e sotëm), gjatë pesë shekujve të fundit ne do të gjejmë një numër të madh shqiptarësh që kanë bërë emër të madh në vendet ku kanë shkuar si Manol Blessi, Mërkur Bua, George Basta (58) dhe shumë të tjerë të cilët e kanë vënë talentin e tyre në shërbim të mbretit të Francës,

## Mid'hat Frashëri

---

të Italisë ose të perandorisë Gjermane 59).

Figura të tilla si ato të poetit dhe themeluesit të letërsisë moderne turke Namik Qemal bej, të Sami bej Frashërit, të profesorit Cantos në Athinë dhe të Dora D'Istrias- tregojnë se shpirti i madh i shqiptarëve ka gjetur rrugën e lavdisë edhe në fushën e letrave.

\*  
\*       \*  
\*

Një shkrimtar francez që në orë të veçanta ka qenë padyshim edhe poet, ka shkruar këto rreshta në adresë të shqiptarëve:

“Nëse besimi në këto vende ka mundur të fluturojë nga kristianizmi në muslimanizëm dhe nga katolicizmi në shizmen greke, një gjë ka mbetur e pandryshuar te ky popull: pasioni për pavarësi dhe për lavdi. Është tipari kryesor i karakterit, burimi i heroizms. Në të gjitha kohërat Shqipëria ka qenë vendi klasik i heronjve: atje Homeri gjeti Akilin, Greqia gjeti Aleksandrin e madh, Papa Eugjen IV gjeti Skënderbeun” 60).

Por është edhe një tjetër shkrimtar francez më modern, që shprehet në një mënyrë më pak poetike por shumë më konkrete për shqiptarët:

“Në gadishullin ballkanik gjendet një popull i cili nuk ka jetuar kurrë vetë dhe as për vetveten, por roli i tij gjatë gjithë shekujve ka qenë të furnizojë parreshtur kombet fqinje me lëndë të parë njerëzore.

Shqipëria ka qenë rezervuari ku grekët, rumunët, bizantinët dhe turqit janë ushqyer me radhë. Herë-herë në një formë proto-plazmike të shumëllojshme, do të thoja si një masë e

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

paorganizuar, ajo është ngritur lart dhe është personifikuar nga një njeri i madh si Pirro, Skënderbeu, Mehmet Aliu dhe Ali pashë Tepelena, dora e të cilëve tronditi një pjesë të botës dhe la mbi popujt e nënshtruar vulën e gjenisë së vet.

Jeta e shqiptarëve gjatë këtij shekulli, vepra e tyre në Egjypt ku ato qenë mbretër, në Greqi ku ato qenë nismëtarët e vërtetë të pavarësisë, duhet të na spjegojë qartë epokat e ndryshme të historisë së lashtë.

Dhe kur shiptarët quajnë të vetin Aleksandrin, Akilin...egzagjerimi është vetëm në formë, ndërsa paradoksi përmban një të vërtetë” 61).

Akoma edhe një fjalë lexues i dashur, para se të ndahemi. Nuk kemi dashur aspak të bëjmë me këto faqe një apologji të shqiptarëve. Ky nuk është një lavd ditirambik për ta, por vetëm e vërteta. Është shkruar shumë pak për shqiptarët dhe mund të shkruhet më tepër. Ata vetë e kanë neglizhuar mjaft publicitetin dhe ky ka qenë një gabim i tyre 62).

Është mirë të veprosh, por duhet të bësh të njohura këto vepra. Sepse nëse Bomarshe ka këshilluar shpifjen, Maks Nordo nga ana tjetër jep mendimin e vyer se duhet folur shpesh për vetveten.

E mbyllëm këtë përshkrim të shkurtër me një citim të marrë nga Z.Bernard.

Dhe e bëmë me qëllim. Në të vërtetë shqiptarët kanë jetuar shumë pak për veten e tyre; nga veprimtaria, gjaku dhe talentet e tyre kanë përfituar të tjerët. Ata e kanë dhënë ç’kanë patur më të mirë për të mirën e të tjerëve.

Kështu ka qenë deri tani dhe me të drejtë ata dëshmojnë që sot e tutje të nisë një kohë e re: **QË ATA TË PUNOJNË PËR VETEN E TYRE, PËR SHQIPËRINË E TYRE!**

### SHËNIME

1. Kujtime nga Ballkani, nga Rene Millet, 1891, f.19.

2. If the traveller praises the Turk because he finds his Turkish servant so delightful you will generally find that this Turk is an Albanian...The Mohammedan convert among the Greeks and Slavs becomes a Turk but an Albanian remains true to his nation's hope. "Europe and Turks", by Noel Buxton, London 1907, p.49.

3. Kavass-i nuk është thjesht një shërbëtor, është një njeri i besuar, një roje dhe fjala nganjëherë mund të përkthehet portier (në shtëpinë e një njeriu me rëndësi) ose ndihmës.

4. H.Charles Woods, Turqia dhe fqinjët e saj, Paris, (pa datë), f.84.

5. Shih vepër të tij: Macedoni, itc races and their future, London 1906.

6. Shih më poshtë shënimet në kapitullin: Shqiptarë të shquar, Basta etj.

7. Shih mbi udhëheqësit shqiptarë: Albanie, Bruxelles- Londres 1897-1908. Numrat 1 dhe 2 të Albanie (Loussane 1918). Sathas: Dokumenta të panjohura të historisë së Greqisë në Mesjetë, Paris 1880, vol. IV, Ellenica anecdota (në greqisht), Athinë, 1877. Duhesme: Broshurë historike mbi kombësinë e lehtë, vol.3, Basta si Mihai-Viteazul (rumanisht) nga Prof. N.Jorga, Bucarest, 1899.

8. Nuk ka një popull modern si shqiptarët për të cilët kronikat të japin shembuj aq të qartë burrërie. Në shekullin XV ata kanë patur Skënderbeun, Aleksandrin e tyre të Madh, i cili sigurisht nuk pati për lavdinë e tij një teatër aq të madh sa Maqedoninë, por nuk qe aspak inferior në gjeninë e tij dhe ishte po aq i madh në drejtësinë dhe humanizmin e tij. Ky popull nuk ia kaloi kurrë në trimëri atyre malësorëve suliote, ndër të cilët nuk u gjend asnjë plak, asnjë grua dhe asnjë fëmijë që t'u kërkonte mëshirë masakruesve të dërguar nga Ali pashai. Heroizmi i atyre grave suliote që u hodhën nga shkëmbi, të kapura dorë më dorë,

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

duke kënduar këngën e tyre të vdekjes, do të mbetet përgjithmonë një nga ngjarjet më të habitshme të historisë.

E.Reclus, Gjeografia universale, Paris, 1875, vol.1,f.185.

9. Grekët janë oryatur që t'i quajnë suliotët grekë, ata e kanë gabim dhe sot askush nuk dyshon se këta heronj kanë qenë shqiptarë. Oficeri alzasien Ibrahim Monzour efendi në veprën e tij të titulluar "Kujtime nga Greqia dhe Shqipëria" (Paris 1827 dhe 1828), kapitulli III, thekson në mënyrë të veçantë se suliotët janë shqiptarë dhe jo grekë siç do të dëshironin vetë grekët.

10. Përkthim nga anglishtja i botimit të dytë të Laurent Echard nga Vosgien, rishikuar dhe shtuar nga J.Fr.Bastien, Paris 1795; e njëjta, shtuar dhe ribërë nga Giraud, Lyon, 1810.

11. Rene Pinon, Evropa dhe Turqia e re, Paris, 1913, f.296.

12. Sedra tek shqiptarët merr shpesh të tilla përmasa negative, sa në rast se harikiri do të kishte qenë një zakon i tyre dhe duke qenë se është më e lehtë të vetvritesh sesa të vrasësh një tjetër, atëhere raca shqiptare prej kohësh do të kishte mbetur si një kujtim etnografik.

13. Për të patur një ide se në ç'mënyrë turqit e përkrahnin mjeshtërinë e banditit, mjafton të dimë se me dhjetra oficerë të xhandarmërisë otomane kishin dalë nga akademia e... maleve. Një stazh prej disa vjetësh në një bandë konsiderohej si titulli më i sigurtë për të synuar gradën e kapitenit dhe të majorit.

14. Udhëtim nëpër Greqi, Paris, 1820, në pesë volume, botimi II më 1826 në gjashtë volume: Duke mos e pasur veprën në çastin kur po shkruaj, po e citoj siç e mbaj mend.

15. Banditët shqiptarë nuk kryejnë kurrë krim me gjak të ftohtë dhe i kanë trajtuar gjithmonë mirë pengjet e kapura. Femrat nuk janë sulmuar kurrë dhe prania e tyre garantonte të gjithë karvanin nga sulmet e banditëve ose nga hakmarrja e armikut. Më 1913 kur serbët kryen sistematikisht akte shkatërrimtare në Gollobordë, shqiptarët në vend që të kryenin raprezalje, kanë shpëtuar detashmente ushtarësh duke i shoqëruar ata deri në një vend të sigurtë.

16. Pouqueville. Udhëtim nëpër Greqi, Paris, 1820, vol.II,

## Mid'hat Frashëri

---

f.604-605.

17. G.B.Depping. Greqia ose përshkrimi topografik i Livadhisë, Moresë dhe Gadishullit, Paris, 1823, vol.II, f.96.

18. Po aty, f.108.

19. Dr. Alfred Philipson. Zur Ethnographie des Poloponnes, Patermans, Mitteilungen, Gothe, vol.36,1890, libri 1-2,f.36.

20. Madamë Dora D'Istria. Eskursion nëpër Rumeli dhe Greqi.

21. Kujtime nga Kalabria, Shqiptarët në Itali, nga CH. Didier, Revue des Deux-Mondes, 1840, vol.III,f.93-115.

22. Raport mbi gjendjen e sotme të qytetërimit në Greqi, lexuar në shoqatën e Observatorëve të Njeriut, 6 janr 1806,Paris, f.26-33 mbi hidriotët; f.46-52 mbi suliotët.

23. Letra mbi Morenë dhe ishujt Cerigo, Hydra dhe Zante, nga A.L. Casellan, Paris, 1908, f.93.

24. Lazar Konduriotis of Hydra, one the most patriotic men in Greece and one of the few whose public and private character was alike irreproachable. George Finlay, History of Greece, B.C.146 to A.D. 1864, new edition, London 1877, vol.VII, ph.62.

25. Gjeografia universle, Paris, 1876, vol.I, f.193.

26. Udhëtim nëpër Greqi në vitet 1803-1804, nga J.L.S. Bartholdy, përkthyer nga gjermanishtja nga A.,Paris, 1807, vol. II, f.70.

27. Turqia dhe helenizmi konteporan, paris, 1893, f.98.

28. Pouqueville. Udhëtim nëpër Greqi.

29. La Zedda e la dinastia dei Balsidi, studi storici documentati del prof. Giuseppe Gelcich, Spalato, 1899, ph.334-335.

30. Frederic Gibert në veprë e tij: Vendi i shqiptarëve dhe historia e tyre, Paris 1914. Për të treguar se sa tregtarë të mëdhenj e të zotë janë shqiptarët e Shkodrës, rrëfen anekdotën e mëposhtme:

“Një çifut kishte shkuar në Shkodër për të bërë tregti por meqë kishte mbetur pa një grosh, një i ri shqiptar i këshillon një mënyrë për të fituar ca para. Atëhere biri i Izraelit u largua dhe ia mbathi këmbëve duke thënë se në një vend ku edhe fëmijët kanë shpirt tregtie kaq të zhvilluar, një çifut nuk ka se ç’kërkon”.

31. Dihet se turqit i quajnë shqiptarët arnautë që rrjedh nga fjalët



## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

Arbër dhe Arban, siç e quajnë ata veten e tyre dhe nga ku rrjedhin emrat Arvanitë (në greqisht) dhe Albanezë.

32. Dr.Leopold Gluck. Zur pfsichen Antopologie der Albanesen, Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Hercegovina, band V, Wien 1897, ph.367.

33. Shpesh herë shqiptarët krahasohen me zviceranët, Krahasimi është i drejtë dhe padyshim miklues për shqiptarët.

34. Rene Pinon. Evropa dhe perandoria otomane, Paris, 1913, f.138.

35. Gabriel Louis -Jaray. Shqipëria e panjohur, Paris, 1913, f.199:

36. Francis Delaisi. Revolta shqiptare dhe ekulibri evropian. La Grande Revue, 14e annee, nr.13.Paris, 10 julliet 1910, ph.133.

37. Një ditë bisedonim për këto karakteristika të racës me një damë angleze, e cila e njihte mjaft mirë Shqipërinë dhe kishte botuar shumë vepra mbi këtë vend. Ajo na bëri një krahasim ndërmjet shqiptarëve dhe malazezëve, të cilët po ashtu i njihte mirë: “Këta të fundit, kur kthehen nga Amerika me ca para në xhep, bëjnë një detyrë pothuaj fetare duke e kaluar tërë ditën në kabare derisa i zbrazin tërë xhepat, ndërkohë që në shtëpi në të vetmen dhomë flenë rrasur e plasur pa iu bërë aspak përshtypje: burra, gra, prindër, gomarë, lopë, derra e pula”.

38. Reiseendrucke aus dem Vilajet Kossovo, von Dr. Karl Oestreich, në WAbgandlungen der K.K. Geograph.Gesellschaft”, Wien, vol.1,1899, ph.349.

39. Ribert Vaucher, në “L’Illustration de Paris”, nr.3855, 20 janvier 1917, ph.55.

40. Po aty, nr.3866, 7 avril 1917, ph.325.

41. Një pesonash anglez, aktualisht anëtar i Parlamentit britanik dhe president i Komitetit Shqiptar në Londër, i pyetur se përse tregonte aq interes për çështjen shqiptare, u përgjegj:

“Kam patur një kohë të gjatë një kavass, nga puna e të cilit, nga karakteri dhe inteligjenca e tij kisha mbetur fort i kënaqur; më vonë

## Mid'hat Frashëri

---

mësova se ai ishte shqiptar. Në çastin kur po ndahej nga unë për t'u rikthyer përfundimisht në shtëpinë e vet, unë e pyeta se ç'lloj dhurate i pëlqente më shumë.

“Ju jeni një anglez nga një familje e madhe, m'u përgjigj kavassi, dhe padyshim një ditë do të kini një post të rëndësishëm në vendin tuaj; unë ju lutem që të mendoni për Shqipërinë dhe të punoni për të”.

Qysh atëhere dhe i prekur nga këto fjalë të një kavassi, shton i nderuari Ambrey Herbert -sepse pikërisht për këtë parlamentar anglez është fjala - unë nuk kam rreshtur së qeni mik i shqiptarëve dhe i Shqipërisë”.

42. Popujt e Ballkanit, skicë antropologjike nga Eugene Pittard, Paris, Neuchatel, f.81. Libri nuk ka datë, por ai është i viti 1916.

43. Pouqueville. Udhëtim nëpër Greqi, vol. II, f.581.

44. Ami Boue. Turqia e Evropës, Paris, 1840, vol II, f.70 e 74.

45. “Physically a splendid race of men, the Albanian can claim to be one of the purest and oldest races in Europe”. Turkey in Europe, by James Baker, lieutenant-colonel, third edit., London, 1877, ph.363.

46. Udhëtim nëpër Greqi, shkruar në vitet 1803-1804 nga J.L.S. Bartholdy, përkthyer nga gjermanishtja prej A. du C., vol.II, Paris 1807, f.92.

47. Paul Bourget. Udhëtarët, f.16.

48. Hyacinthe Hecquard, konsull i Francës në Shkodër. Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Veriut ose Gegërisë, f.271. Libri nuk ka datë, por është i vitit 1857.

49. E. Reclus. Gjeografia universale, Paris, 1876, vol. I, f.193.

50. Frederic Gibert. Vendi i shqiptarëve dhe historia e tyre, Paris, 1914, f.1.

51. Le matin, Paris 1901, 15 tetor, nr. 6442, f.1.

52. Albanias illustres, nga Lumo Skëndo në “Pavarësia e Shqipërisë”, nr.18, f.27-29, Bukuresht, 20 prill 1916.

53. Kopështi i Vezirëve nga Osman Zade Naib efendi, e vazhduar nga Dilaver aga Zade Ahmet Xhavit bej dhe Abdyl-fetah Shevkat efendi, shtypur në Kostandinopojë më 1271 (1853).

## Shqiptarët në vendlindje dhe në mërgim

---

54. Si pasojë e një gabimi të madh, prejardhja e Qyprilinjve mendohet të jetë nga një qytet në Vardar, Maqedoni, por në të vërtetë ai është nga fshati Rroshnik pranë Beratit të Shqipërisë dhe mbiemri i tij Qyprili vjen nga një qëndrim i gjatë i tij në Qyprili në Azinë e Vogël ku ka qenë prefekt i këtij qyteti.

55. Unë e di prejardhjen e të famshmit Sinan. Disa e mbajnë për një italian renegat por Abdyrrahim Sheref bej, aktualisht historiograf dhe kronikan i Turqisë dhe president i shoqatës së historisë otomane. në leksionet e tij në shkollën Mulkie të Kostandinopojës përsëriste gjithmonë se arkitekt Sinani ishte shqiptar.

56. Mehmet Ali, që është një figurë me të vërtetë e shquar për aftësitë e tij administrative dhe taktin e tij si politikan, e ka marrë mbiemrin e tij turk nga Kavalali gjatë qëndrimit dhe tregtisë së tij në Kavalla, qytet në detin Egje.

57. Ja se çfarë shkruhet në "Dictionnaire Universal de Larousse", vol I, art. Albani, mbi këtë familje të shquar: "... Familje e shquar e Romës me prejardhje nga Shqipëria, erdhi si refugjate në Itali mbas pushtimit turk në shekullin XVI. Ajo i ka dhënë kishës një numër të madh prelatësh nga të cilët më të famshmit kanë qenë: Jean-Jerome Albani, që për pak sa nuk u zgjodh në papatin, mbas vdekjes së Gregorit XII dhe që vdiq në vitin 1591; Jean-François Albani i zgjedhur papë më 1700 me emrin Klemente XI. Ai la mjaft nipër që u bënë kardinalë dhe luajtën një rol shumë të rëndësishëm. Annibal Albani, peshkop i Urbinit, vdiq më 1751. Aleksandër Albani, i vëllai, bibliotekar i Vatikanit që grumbulloi në shtëpinë e tij të fshatit e njohur si vila Albani, shumë kryevepra të çdo fushe; Jean François, peshkop në Asti, vdekur më 1909. Me qenë se mori pjesë aktive kundër hyrjes së francezëve në Itali, atij i plaçkitën pallatin dhe e detyruan të largohej nga Roma. Një kardianl tjetër nga kjo familje Jozefi vdekur më 1834, në një moshë shumë të thyer, ka qenë komisar apostolik gjatë turbullirave të vitit 1831 dhe u shqua për akte ndëshkimi tepër të ashpra.

58. George Basta, gjeneralisëm në ushtrinë e perandorit të

---

---

Gjermanisë, Rodolphe II në vitet 1599-1605. Ky Georges ishte shqiptar dhe bir i kapitenit të kavalerisë Demetre Basta që kishte shërbyer nën Karlin V. Demetre Basta ka qenë i pari që futi orkestrën dhe marrshet frymore në ushtri. Xhaxhai i tij Nikola Basta ka qenë shquar në luftat kundër vendeve të Ulta dhe Francës.

59. Shih mbi Stradiotët dhe udhëheqësit.

60. Felix Julien, Papët dhe sulltanët, Paris 1879, f.65.

61. Victor Berard. Turqia dhe helenizmi bashkëkohor, Paris 1893.

f.292.

62. Është një grua e mrekullueshme që ka thënë këto fjalë të mbushura me melankoli: “Po çfarë kërkimesh duhet të bëj në Kostandinopojë, në Kajro, në Hidra etj për të hedhur dritë mbi këtë racë guximtare shqiptare? Ky popull vepron shumë, por nuk shkruan asgjë”. Dora D’Istria. Jeta e kleftëve në perandorinë persiane, Kolozsvar 1879, f.26.

---

---

**PËRMBAJTJA E LËNDËS:**

**1. Parathënie:**

**Eugen Shehu,**

**"Shërbestari i kombit", Bernë  
1998, faqe 2-14**

**2. Esse:**

**Mid'hat Frashëri,**

**"POPULLSIA E EPIRIT",  
Sofie, 1915, fq. 15-59**

**3. Esse:**

**Mid'hat Frashëri.**

**"ÇËSHTJA E EPIRIT",  
Gjenevë, 1919, fq. 60-99**

**4. Esse:**

**Mid'hat Frashëri,**

**"Shqiptarët në vendlindje  
dhe në mërgim", Lozanë,  
1919, fq. 100-151**